FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 198

Tiranë – E premte, 13 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 849, datë 4.11.2020	Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin–Bunë.....	13929
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 867, datë 11.11.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar.....	14214

VENDIM
Nr. 849, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR DRIN – BUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin–Bunë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Zbatimi i planit të menaxhimit të basenit ujor Drin–Bunë fillon në vitin 2021.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Projekti i Burimeve Ujore dhe i Ujitjes
Përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin–Bunë dhe Seman
Numri i Kontratës: MEFWA/CS/001

PLANI PËRFUNDIMTAR
I MENAXHIMIT PËR BASENIN UJOR DRIN–BUNË
QERSHOR, 2019

Të dhënat për botimin dhe rishikimin

Rishikimi	Data	Autor	Kontrollues	Miratues	Përshkrimi
A	29.9.2017	Patrick Reynolds Halit Kamberi	Monica Melinte	Wim Verheugt	Lëshuar për klientin
B	22.12.2017	Patrick Reynolds Halit Kamberi	Monica Melinte	Wim Verheugt	Lëshuar për klientin
C	21.3.2018	Patrick Reynolds Halit Kamberi	Monica Melinte	Wim Verheugt	Lëshuar për klientin
Rishikimi final	5.12.2018	Patrick Reynolds Halit Kamberi	Monica Melinte Emiljano Zhuleku	Wim Verheugt	Lëshuar për klientin
Final	7.6.2019	Patrick Reynolds Halit Kamberi	Monica Melinte Emiljano Zhuleku	Wim Verheugt	Lëshuar për klientin

Klasa e informacionit: **Standard**

Ky dokument është hartuar për palën që e ka porositur atë dhe për qëllimet specifike të lidhura vetëm me projektin e sipërpërmendur. Ai nuk duhet të përdoret si bazë mbi të cilin mund të mbështetet ndonjë palë tjetër dhe nuk duhet përdorur për ndonjë qëllim tjetër.

Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për pasojat që mund të ketë ndonjë palë tjetër kur mbështetet në këtë dokument apo kur dokumenti përdoret për qëllime të tjera, dhe as nëse ai përmban ndonjë gabim apo mangësi që vjen si rezultat i gabimit apo mangësisë në të dhënat që ne kemi marrë nga palët e tjera.

Ky dokument përmban informacion konfidencial dhe pronësi intelektuale. Ai nuk duhet t'u tregohet palëve të tjera pa pëlqimin tonë dhe të palës që e ka porositur atë.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive
1 Hyrje
2 Korniza ligjore dhe institucionale për menaxhimin e ujërave
2.1 Legjislacioni primar
2.2 Legjislacioni sekondar (aktet nënligjore)
2.3 Pajtueshmëria rregullatore
2.4 Marrëveshjet ndërkombëtare
2.5 Kuadri institucional
2.5.1 Institucionet e nivelit qendror
2.5.2 Institutet kombëtare të përfshira në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave.
2.5.3 Njësitë e qeverisjes vendore, këshillat e baseneve ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore
3 Karakteristikat e Përgjithshme të Basenit Ujor Drin–Bunë
3.1 Përshkrimi i ujërave sipërfaqësore
3.2 Mbulesa e Tokës dhe Korina
3.3 Efektet klimatike
3.4 Prurja lumore
3.5 Burimet ujore të Basenit Ujor Drin–Bunë
3.5.1 Sistemi i modelimit dhe elementet e tij bazë
3.5.2 Shtrirja e modelit
3.5.3 Përvijimi i nën baseneve
3.5.4 Bilanci i ujit
3.6 Karakterizimi i ujërave nëntokësore
3.6.1 Akuiferi kuaternar i Shkodrës
3.6.2 Akuiferi karbonatik
3.6.3 Akuiferi magmatik
4 Presionet dhe Ndikimet
4.1 Burimet e ndotjes së ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë
4.1.1 Menaxhimi i mbetjeve
4.1.2 Aktiviteti industrial
4.1.3 Erozioni
4.1.4 Hidrocentralet
4.1.5 Ndotja bujqësore
4.1.6 Ndotja e ujërave nëntokësore
4.1.7 Turizmi
4.1.8 Konkluzionet dhe kontradiktat e mundshme
4.2 Ndikimi i kushteve hidrologjike aktuale dhe të ardhshme në Basenin Ujor Drin–Bunë 56
4.2.1 Rezultatet e modelimit
4.2.2 Konkluzionet dhe rekomandimet të skenarëve të modelimit
4.2.3 Përcaktimi i mëtejshëm i regjimit hidrologjik (rrjedhja ekologjike) në lidhje me objektivat mjedisorë
5 Zonat e mbrojtura
5.1 Hyrje
5.2 Zonat e mbrojtura nën DKU
5.3 Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare
5.4 Zonat e përcaktuara për Mbrojtjen e Specieve Ujore Ekonomikisht të rëndësishme
5.5 Trupat Ujorë të Përcaktuar si Ujëra Rekreative dhe të Larjes
5.6 Zonat e ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese, duke përfshirë zonat e përcaktuara si të cenueshme
5.7 Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e habitateve ose specieve
6 Rrjeti i Monitorimit të Cilësisë së Ujit
6.1 Hyrje
6.2 Kërkesat e Monitorimit të Ujërave Sipërfaqësorë në kuadër të DKU-së
6.2.1 Rrjeti i monitorimit të ujit
6.2.2 Monitorimi Mbikëqyrës
6.2.3 Monitorimi Operacional
6.2.4 Monitorimi Investigues
6.2.5 Frekuenca e monitorimit
6.2.6 Përcaktimi i standardeve të cilësisë së mjedisit (SCM) për elementet e cilësisë kimike
6.2.7 Ujërat ndërkufitare
6.2.8 Kushtet e referencës për trupat ujorë sipërfaqësorë
6.2.9 Monitorimi i standardeve/metodave
6.3 Programi i Monitorimit të Ujit Sipërfaqësor në përputhje me DKU-në për Basenin Ujor Drin–Bunë
6.3.1 Përmbledhje e programit të monitorimit
6.3.2 Objektivat e programit monitorues
6.3.3 Hartimi i monitorimit mbikëqyrës të ujërave
6.4 Kërkesat e Monitorimit të Ujërave nëntokësorë për DKU-në
6.4.1 Monitorimi sasior i ujërave nëntokësorë
6.5 Programi i monitorimit të ujërave nëntokësorë në përputhje me DKU-në për Basenin Ujor Drin–Bunë
6.5.1 Monitorimi aktual i ujërave nëntokësorë në Basenin Ujor Drin–Bunë
6.5.2 Mangësitë në monitorimin e ujërave nëntokësorë
6.5.3 Rekomandim për hartimin e programit të monitorimit të ujërave nëntokësorë

6.6 Monitorimi i Zonave të Mbrojtura në Basenin Ujor Drin–Bunë
6.6.1 Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare
6.6.2 Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e llojeve të specieve ujore të konsiderueshme ekonomikisht
6.6.3 Trupat ujorë të përcaktuara si ujëra rekreative dhe të larjes
6.6.4 Zonat me ndjeshmëri ndaj lëndëve ushqyese, duke përfshirë zonat e përcaktuara si zona të cenueshme
6.6.5 Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e habitateve ose specieve
6.6.6 Rekomandime për monitorimin e Zonave të Mbrojtura
7 Statusi i Ujit
7.1 Monitorimi i Cilësisë së Ujit Sipërfaqësor
7.1.1 Përmbledhje e cilësisë së ujit të lumenjve sipërfaqësorë në Basenin Ujor Drin–Bunë në vitin 2015
7.1.2 Trendet e cilësisë së ujit në lumenjtë e Basenit Drin–Bunë
7.1.3 Monitorimi i liqeneve të basenit ujor Drin–Bunë
7.1.4 Monitorimi i ujërave detare
7.2 Vlerësimi i Shpejtë Biologjik (VSHB) në Basenin Ujor Drin–Bunë
7.2.1 Karakterizimi i basenit ujor Drin–Bunë
7.3 Përfundimet në lidhje me statusin e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë në Basenin Ujor Drin–Bunë
7.4 Vlerësimi i cilësisë së ujërave nëntokësorë
7.4.1 Akuiferi kuaternar i Shkodrës
7.4.2 Akuiferi karbonatik
7.4.3 Akuiferi magmatik
8 Infrastruktura e Ujit
8.1 Hyrje
8.2 Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura
8.3 Sektori i ujitjes
8.4 Hidrocentralet
9 Menaxhimi i përmbytjeve
9.1 Hyrje
9.1.1 Raporti fillestar i projektit
9.2 Gjendja historike dhe aktuale
9.2.1 Përmbytjet e mëparshme
9.2.2 Pasqyrë e përmbytjeve të vëzhguara
9.3 Depozitimi i ujit
9.4 Kërkesat ligjore
9.4.1 Direktiva për përmbytjet
9.4.2 Udhëzime për raportimin sipas Direktivës së Përmbytjeve
9.5 Dokumenti burimor për Grupin e Punës për Përmbytjet mbi Menaxhimin e Riskut të Përmbytjeve
9.6 Reagimi ndaj emergjencave
9.7 Analiza e mangësive
9.8 Ndryshimet klimatike
9.9 Masat e rekomanduara në projekte të mëparshme
9.9.1 Masat legjislative dhe institucionale
9.9.2 Korniza efikase organizative
9.9.3 Sistemi i mjaftueshëm i monitorimit
9.9.4 Sistemi i përshtatshëm i paralajmërimit të hershëm
9.9.5 Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet
9.9.6 Hartat e rrezikshmërisë së përmbytjeve
9.9.7 Hartat e rrezikut nga përmbytjet
9.10 Rekomandime specifike për basenin ujor Drin–Bunë
10 Objektivat mjedisorë
11 Analiza ekonomike e përdorimit të ujit
11.1 Qëllimi i karakterizimit fillestar ekonomik
11.2 Përdorimi dhe ndikimi i ujit
11.2.1 Nxjerrjet e ujit
11.2.2 Përdorimi ujit sipërfaqësor
11.3 Vlera e ujit
11.3.1 Përdorimi shtëpiak i ujit
11.3.2 Përdorimi industrial, komercial dhe institucional i ujit
11.3.3 Përdorimi bujqësor i ujit
11.4 Parashikimet e tendencave
11.4.1 Parashikimet demografike
11.4.2 Tendencat e konsumit Shtëpiak dhe IKI
11.4.3 Humbjet e Ujit
11.4.4 Tendencat totale të kërkesës për ujë në basenin ujor
11.5 Rikuperimi i Kostos së Shërbimeve të Ujit
11.5.1 Shërbimet e identifikuara të ujit në qarkun e Basenit Ujor (QBU)
11.5.2 Ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura
11.5.3 Përdoruesit e ujit
11.6 Kostot financiare të shërbimeve të ujit
11.6.1 Kostot e mjedisit dhe burimeve
11.6.2 Mekanizmi i rikuperimit të kostos

11.6.3 Tarifat për shërbimet e ujit
11.6.4 Tarifat për shërbimet e ujërave të ndotura
11.6.5 Shkalla e rikuperimit të kostos
11.6.6 Rikuperimi i kostove financiare
11.6.7 Kthimi i kostove të kostove ekonomike
11.7 Përfundime
12 Programi masave
12.1 Hyrje
12.2 Plan veprimi
13 Përmbledhje e aktiviteteve të konsultimit publik
13.1 Hyrje
13.2 Trajnimet
13.3 Konsultimet e palëve të interesit
13.3.1 Faza 1 dhe faza 2 e konsultimeve (të nivelit të lartë dhe nivelit rajonal)
13.3.2 Konsultimet e fazës 3 dhe fazës 4 (Informatorët kryesorë dhe grupet e fokusit)
13.3.3 Rezultatet dhe çështjet kryesore
13.4 Specifikat e vendit mbi aspektet gjinore
13.4.1 Kuadri ligjor i aspektit gjinor
13.4.2 Të dhënat statistikore gjinore në përputhje me masat legjislative
13.4.3 Barazia gjinore në institucionet në nivel qendror
13.4.4 Barazia gjinore në institucionet në nivel lokal
13.4.5 Niveli i organizimit të shoqërisë civile dhe i OJQ-ve
13.4.6 Aplikimi i gjinisë në menaxhimin e burimeve ujore dhe zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.
13.5 Konkluzione dhe rekomandime
14 Objektiva dhe Rekomandime
Shtojcat
Shtojca 1. Transpozimi i direktivave përkatëse të BE-së
Shtojca 2. Stacionet e propozuara të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe prioritizimi i tyre
Shtojca 3. Metodologjia për vlerësimin e statusit ekologjik/potencialit të ujërave sipërfaqësore
3.1. Hyrje
3.2 Kriteret e përdorura për të përcaktuar metodën e vlerësimit
3.3 Vlerësimi biologjik
3.4 Vlerësim ekologjik i llojeve kryesore të lumenjve
Shtojca 4. Të dhënat ekonomike
Shtojca 5. Plani i veprimit për përfshirjen palëve të interesuara
5.1. Hyrje
5.2 Qëllimi
5.3 Qasja në planin e angazhimit të palëve të interesit
5.4 Identifikimi i palëve të interesit
5.5 Takimet e konsultimit dhe trajnimet
5.6 Organizimi i mbledhjeve
5.7 Grupet e fokusit
5.8 Informatorët kyç
5.9 Grupet e tjera të interesit
5.10 Ndihma e angazhimit të grupeve të interesit
Shtojca 6. Raporti i konsultimit të grupeve të interesit
6.1 Hyrje
6.2 Qasja e përgjithshme
6.3 Mbledhjet rajonale
6.4 Fokus grupet dhe informatorët kyç
6.4.1 Numri i kontakteve
6.4.2 Rezultatet dhe çështjet kryesore
6.4.3 Çështjet kryesore të grupeve specifike
6.5 Angazhimi i OJQ-ve
6.6 Grafikët dhe pyetjet kryesore

Akronimet dhe njësitë

SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve
KBO	Kërkesa biologjike për oksigjen
°C	Gradë Celsius
c	Frymë
Ca	Kalcium
Cd	Kadmium
CEMSA	Konsolidimi i Sistemeve të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri
GRNK	Të dhënat stacionare Grupi i rreziqeve klimatike reshjet – rrezet infra të kuqe
Cl	Klor

Co	Kobalt
CO_3	Karbonat
COM	Komunikimi nga Komisioni për Këshillin, e Parlamentit Evropian, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve
Cr	Krom
NJKK	Njësia e Kërkimit Klimatik
Cu	Bakër
BK	Bordi i Kullimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DHI	Instituti Hidraulik Danez
DP	Direktiva për Përmbytjet
KO	Kërkesa/Nevoja për oksigjen
p.sh.	për shembull
€	Euro
KE	Komisioni Evropian
KEE	Komiteti Ekonomik Evropian
VKE	Vlerat e Kufirit të Emetimeve
OM	Objektiva Mjedisore
OCM	Objektiva e Cilësisë Mjedisore
SCM	Standard i Cilësisë Mjedisore
BE	Bashkimi Evropian
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
DP	Direktiva për Përmbytjet
Fe	Hekur
GIS	Sistemi Gjeografik i Informacionit
GWh	Gigavat në orë
ha	Hektarë
HCO_3	Bikarbonat
HH	Familje (përdorur në figurën 11.2)
HEC	Hidrocentral
EI	Emetim Industrial
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
MIBU	Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore
K	Kalium
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
km	Kilometër
kW	Kilovat
kWh	Kilovat në orë
l	Litër
ITI	Industriale, tregtare dhe Institucionale
IKMM	Instrumente kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
LBU	Ligji për Burimet Ujore
m	Metër
mg	Miligram
mm	Milimetër
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Mn	Mangan
Mg	Magnez
MIKE HYDRO	Programi i Modelimit të Lumit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë

MSH	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Mbrojtjes
MW	Megavat
MWh	Megavat në orë
NAM	Një model i përgjithshëm dhe konceptual i kapjes së reshjeve me llogaritje të vazhdueshme të përmbajtjes së lagështirës në zona e nëntokesore
AKM	Agjencia Kombëtare Mjedisore
OJQ	Organizata joqeveritare
Ni	Nikel
NO_2	Nitrat potasiumi
NO_3	Nitrat
NH_4	Amon
UPF	Uji i pafaturuar
Nr.	Numri
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
SKU	Strategjitë Kombëtare të Ujit
PKSU	Plani Kombëtar për Sektorin e Ujit
PMZM	Plani Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
O_2	Oksigjen
P	Fosfat
ZM	Zonë e Mbrojtur
Pb	Plumb
ETM	Evapotranspiracioni i mundshëm
PO_4	Ortofosfat
PPP	Partneriteti Publik Privat
SP	Stacioni i Pompimit
R	Rural
BU	Basen Ujor
RRBU	Rrethi i Basenit Ujor
ZABU	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor
VSHB	Vlerësimi i Shpejtë Biologjik
KBU	Këshilli i Baseneve Ujore
MBU	Menaxhimi i Basenit Ujor
PMBU	Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor
SEK	Seksioni
SHPP	Hidrocentralet e Vegjël
Sida	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SO_4	Sulfat
RAT	Reforma Administrative Territoriale
TR	Termat e Referencës
SK	Seritë Kohore
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
TVSH	Taksë mbi vlerën e shtuar
VTU	Vlerësimi Trupave Ujorë
TUSHM	Trupa Ujorë Shumë të Modifikuar
TUA	Trupa Ujorë Artificialë
UdE	Uji dhe Ekonomia (Grupi punues i DKU-së)
TUNT	Trupa Ujorë Nëntokësorë
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
OBM	Organizata Botërore Meteorologjike
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

ERRU	Enti Rregullator i Ujit
PBUU	Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
ITUN	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
SHPU	Shoqata e Përdoruesve të Ujit
ITUZ	Impianti i trajtimit të ujërave të zeza
Zn	Zink

Përmbledhje ekzekutive

Informacioni i mëposhtëm detajohet në PMBU-në Drin–Bunë, i përcaktuar sipas kërkesave të shtojcës VII të Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së (2000/60/KE). Këtu përfshihen:

- një përshkrim i akteve ligjore që rregullojnë menaxhimin e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë;

- një përshkrim i karakteristikave të përgjithshme të Basenit Ujor, i cili përfshin një përshkrim të ujërave sipërfaqësorë dhe përcaktimin e ujëmbledhësve duke përdorur modelin Dhi Mike Hydro Basin, shtresën mbuluese të tokës dhe ndikimin e efekteve klimatike në balancën aktuale dhe të ardhshme të ujit në basen;

- një përmbledhje e presioneve kryesore në Basenin Ujor, i cili përfshin ndikimet e ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore nga bujqësia, erozioni, hidrocentralet dhe mbetjet e ngurta. Ky seksion përfshin gjithashtu rezultatet e modelit, të cilat sigurojnë vlerësime të kërkesave aktuale, si dhe ato të ardhshme për ujë nga sektorët kryesorë të përdorimit të tij, duke përfshirë ujitjen dhe vlerësimet e kërkesave të nevojshme të rrjedhjes sidomos në rastin e hidrocentraleve;

- identifikimi i Zonave të Mbrojtura në Basenin Ujor duke saktësuar zonat për nxjerrjen e ujit të caktuar për konsum njerëzor, mbrojtjen e specieve ujore, ujërat rekreative dhe larës dhe mbrojtjen e habitateve ose gjallesave;

- një plan veprimi për monitorimin e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë sipas kërkesave të DKU-së;

- një përmbledhje e statusit të ujërave sipërfaqësorë dhe të ujërave nëntokësorë bazuar në të dhënat e disponueshme;

- gjendjen aktuale të infrastrukturës ujore në basenin ujor në aspektin e trajtimit të ujit dhe ujërave të ndotura, ujitjes dhe hidrocentraleve;

- gjendjen historike dhe aktuale në lidhje me përmbytjet në basen, që ofron një analizë të mangësive dhe nevojave për të pasur një menaxhim efektiv të përmbytjeve së bashku me rekomandimet për të përmbushur kërkesat e Direktivës së Përmbytjeve të BE-së;

- përcaktimin e objektivave mjedisorë kryesorë (OM), së bashku me një listë të veprimeve dhe treguesve të matshëm, të cilat duhet të kryhen për të arritur OM-të;

- një analizë ekonomike e përdorimit të ujit, parashikimeve të trendit, shpenzimeve të shërbimit të ujit dhe ujërave të ndotura dhe rikuperimin aktual të kostos së shërbimeve të ujit në basen;

- një propozim për Programin e Masave (PM) të kërkuara në Basenin Ujor për të përmbushur OM-të. Program i Masave ndahet në masa "bazë" dhe "plotësuese" të cilat, në mungesë të përcaktimit të statusit ekologjik, janë të bazuara në komponentët e Planit Kombëtar të Sektorit të Ujit, të lidhur me Basenin Ujor;

Një përmbledhje e trajnimeve të realizuara për Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor (më parë Agjencia e Basenit Ujor) dhe stafin e Ministrisë të përfshirë në menaxhimin e ujërave dhe gjithashtu identifikon çështjet kryesore përmes konsultimeve me një gamë të gjerë të grupeve dhe të aktorëve në Basenin Ujor. Programi i Masave është zhvilluar tërësisht në linjë me objektivat mjedisorë që pasqyrojnë shtatë kategoritë dalluese të OM-ve, ku secila përfshin masat "bazë" dhe ato "plotësuese":

- për nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, ndarjen e drejtë midis përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike në lidhje me kushtet mjedisore dhe parimet e menaxhimit të qëndrueshëm;

- arritjen dhe mbajtjen e statusit ekologjik dhe kimik minimal "i mirë" për trupat ujorë sipërfaqësorë, që kanë status "mesatar", "i keq" ose "shumë i keq". (lumenjtë, liqenet, ndërkombëtarë/ujërat ndërkufitare, trupa ujorë artificialë dhe tejet të modifikuar);

- parandalimi i ndotjes për të shmangur përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe për të arritur një status "të mirë" kimik në TUT;

- arritjen dhe mbajtjen e statusit minimal "i mirë" të ujërave të larjes (të brendshme, bregdetare dhe ndërkombëtare);

- uljen e rrezikut nga përmbytja dhe humbjet për jetën, mjetet e jetesës, shëndetin, ekonominë, aseset kulturore dhe mjedisore të njerëzve, bizneseve dhe komuniteteve;

- përmirësimin e sigurimit të digave të ujitjes;

- mbajtjen dhe/ose uljen e normës së erozionit të lumenjve.

Është propozuar një plan veprimi, për të zbutur problemet aktuale dhe të ardhshme në Basenin Ujor, në zbatim të Programit të Masave në Basenin Ujor Drin–Bunë në periudhën 2021-2033. Plani i veprimit kërkohet, në mënyrë që institucionet kryesore dhe mbështetëse të bashkëpunojnë dhe t'i koordinojnë burimet, për të arritur në të ardhmen menaxhimin e efektshëm të ujërave në Basenin Ujor Drin–Bunë.

Programi i Masave është zhvilluar duke marrë parasysh integrimin gjinor në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9970/2007 për barazinë gjinore në shoqëri. Për të siguruar një qasje që merr parasysh çështjet gjinore për sa i përket menaxhimit të ujërave në Basenin Ujor Drin–Bunë, përfshihen tregues dhe objektivë kyç për të gjitha masat, me qëllim vlerësimin e shkallës në të cilën gratë dhe burrat marrin pjesë në ekonomi dhe në vendimmarrje në sektorin publik dhe në shoqërinë civile, për sa i përket menaxhimit të ujërave.

Plani i veprimit përmban një përshkrim të aktiviteteve specifike prioritare për t'u ndërmarrë, afatet kohore, kostot dhe detyrimet, dhe/ose përgjegjësitë kombëtare, rajonale ose vendore. Nevojitet treguesi i burimit të financimit, megjithëse emrat konkretë të donatorëve dhe institucioneve financuese nuk mund të bëhen të ditura në këtë fazë.

Vlerësimi paraprak i kostove për secilën masë të planifikuar për infrastrukturën bazohet në vlerësimin e kostove për investimin e përdorur për Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve për Shqipërinë, në Planin e Masave të Qeverisë (dokument draft) dhe në përvojën vendore dhe ndërkombëtare. Nënobjektivat bazohen në objektivat mjedisorë, që janë në përputhje me Planin Kombëtar të Sektorit të Ujërave (PKSU), parashikohen për çdo aktivitet në tri afate kohore (2021, 2024 dhe 2030).

Kostoja totale për zbatimin e masave të propozuara për Basenin Ujor Drin–Bunë është € 512,700,000 me rreth 11% të kostove që iu alokohen masave "plotësuese".

Dokumenti përmbyllet me disa rekomandime për ndërmarrjen e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë nga institucioni përgjegjës gjatë 6 viteve të ardhshme, të cilat janë në linjë me strategjinë kombëtare të ujit dhe me kërkesat e DKU-së të BE-së.

1. Hyrje

Përgatitja e një Plani për Menaxhimin e Baseneve Ujore (PMBU) për Basenin Ujor Drin–Bunë është pjesë e mbështetjes institucionale të komponentit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU) të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Shqipëri (PBUU). PBUU-ja financohet nga Banka Botërore, Agjencia Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Sida) dhe Qeveria Shqiptare, dhe është krijuar për të hedhur themelet për menaxhim më racional dhe më të përgjegjshëm të burimeve ujore.

Në zhvillimin e një Plani Menaxhimi të Baseneve Ujore, është e nevojshme të kuptohet se Shqipëria është një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe se BE-ja ka kërkesa specifike për një plan të tillë. Sidoqoftë, Termat e Referencës së projektit në të vërtetë nuk detajojnë kërkesat specifike të Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së. Është e qartë se zbatimi efektiv i DKU-së, siç kërkohet sipas ligjit evropian, nuk është plotësisht i mundur në asnjë prej 6 Baseneve Ujore në Shqipëri.

Zbatimi efektiv i DKU-së kërkon zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve qendrore dhe rajonale për të përmbushur kërkesat specifike të DKU-së dhe, edhe pse të detajuara në ligjet kombëtare dhe të pasqyruara në strukturën institucionale, e cila barazohet me një qëllim serioz për zbatimin e DKU-së në të ardhmen. Shqipëria aktualisht nuk ka kapacitetin teknik për të kryer kërkesat specifike të DKU-së.

Planifikimi i Basenit Ujor ka përfshirë gjithashtu zhvillimin e një modeli të përshtatshëm të basenit ujor si një mjet për vlerësimin e skenarëve të ndryshëm për zhvillimin e burimeve. Aspektet e cilësisë së ujit kanë marrë vëmendje të madhe në plane, pasi përkeqësimi i cilësisë së ujit është një shqetësim në rritje.

Procesi i planifikimit të Basenit Ujor propozon sqarime rreth efektivitetit të strukturës aktuale të menaxhimit të ujit dhe përshkruan mandatin e ardhshëm të institucioneve të menaxhimit siç kërkohet nga nevojat e menaxhimit të basenit në tërësi.

Është thelbësore të merret parasysh se gratë në zonat rurale në Shqipëri shpesh përjashtohen nga proceset vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin në përgjithësi, edhe pse punojnë dhe menaxhojnë burimet së bashku me burrat. Gjithashtu, të rinjtë priren të përjashtohen nga vendimet, dhe veçanërisht gratë e reja. Kjo kulturë shoqëron gratë dhe burrat së bashku, por që çon në vendimmarrje më pak të diskutuara që nuk marrin parasysh përparësitë e grave, nevojat ose p.sh. idetë e biznesit etj. Përfshirja e grave dhe grupeve të moshave të ndryshme është çelësi për të siguruar një marrëveshje të gjerë dhe zbatimin efikas të planeve që do të zhvillohen në kuadër të këtij projekti. Ishte një kërkesë, që konsulenti të kërkojë, kudo që është e mundur, një përfshirje të gjerë të tyre në proces.

Si pjesë e përgatitjes së PMBU-ve, projekti mbështeti aktivitete trajnuese për të forcuar kapacitetin e stafit të menaxhimit të ujërave në menaxhimin e baseneve ujore, me fokus në konceptet e fundit, tendencat dhe praktikat ndërkombëtare të MIBU-së dhe menaxhimin operacional të baseneve ujore. Trajnimi i grave ishte gjithashtu prioritet si një mjet për t'i sjellë ato në proces.

Seksionet vijuese më poshtë janë detajuar në këtë draftraport final, të cilat janë rregulluar sipas kërkesave të përgjithshme, shtojca VII e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së (2000/60/KE).

Seksioni 2 i këtij raporti ofron një përshkrim të akteve ligjore që rregullojnë menaxhimin e ujërave në Basenin Ujor Drin–Bunë.

Seksioni 3: Karakteristikat e Përgjithshme të Basenit Ujor.

Seksioni 4: Presione të rëndësishme në Basenin Ujor, që përfshin ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, si dhe presione dhe ndikime të tjera.

Seksioni 5: Zonat e mbrojtura.

Seksioni 6: Monitorimi i rrjeteve për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe ujërat bregdetare

Seksioni 7: Statusi i ujit referuar përmbajtjes kimike dhe ekologjisë për lumenjtë, liqenet dhe ujërat bregdetare.

Seksioni 8: Infrastruktura ujore, e cila përfshin nxjerrjen dhe trajtimin e ujit, trajtimin e ujërave të ndotur, hidrocentralet dhe ujitjen.

Seksioni 9: Menaxhimi i përmbytjeve.

Seksioni 10: Objektivat mjedisorë.

Seksioni 11: Analiza ekonomike e përdorimit të ujit.

Seksioni 12: Programi masave.

Seksioni 13: Konsultimi i grupeve të interesit.

Seksioni 14: Objektivat dhe rekomandimet kryesore.

Shtojcat

2. Korniza ligjore dhe institucionale për menaxhimin e ujërave

Ndërsa Shqipëria po ecën drejt anëtarësimit në BE, kuadri ligjor dhe institucional dhe baza e njohurive për adresimin e përgatitjes, planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave janë në zhvillim të vazhdueshëm, me synim përgjegjësi të qarta dhe transparencë në zbatimin e *Acquis*-së së BE-së. Transpozimi i plotë i Direktivave përkatëse të BE-së ende nuk është arritur, një përmbledhje e fazës aktuale të transpozimit, mund të gjendet në Shtojcën 1, të dokumentit aktual. Legjislacioni dhe rregulloret për menaxhimin e ujërave ndahen në katër seksione kryesore: legjislacioni primar, legjislacioni sekondar, legjislacioni ndërsektorial dhe Direktivat e BE-së.

2.1 Legjislacioni primar

Menaxhimi i ujërave në Shqipëri rregullohet me Ligjin nr. 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", data 15.11.2012, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", duke mundësuar:

- Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ujërat sipërfaqësore, të përkohshme ose të përhershme, ujërat detare, ujërat territoriale, zonat ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat ndërkufitare, ujërat nëntokësore dhe statusin e tyre;
- Sigurimin, mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, të nevojshme për jetën dhe për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit;
- Shpërndarjen e barabartë të burimeve ujore, siç parashikohet nga menaxhimi efektiv i tyre;

- Mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, përdorimi i tepruar dhe promovimi i konsumit, duke u bazuar në nevojat aktuale;

- Krijimin e kornizës institucionale, në nivel kombëtar dhe lokal, i nevojshëm për zbatimin e një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në dobi të komuniteteve dhe sipas interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Ligji nr. 111/2012 i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", integron ligje të ndryshme në një paketë të vetme që synon përmirësimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë, zonave të mbrojtura, si dhe të ujërave kurative, minerale dhe gjeotermale. Përveç kësaj, fryma e ligjit bazohet në parimin parandalues; duhet të ndërmerren veprime parandaluese, dëmi mjedisor duhet të adresohet me prioritet në burimin e tij dhe ndotësi duhet të paguajë.

Kapitulli 1 i ligjit nr. 111/2012 ofron përkufizime brenda kontekstit të dhënë me këtë ligj. Si i tillë, ligji përcakton konceptin e Rajonit të Baseneve Ujore dhe parimet e tjera themelore të menaxhimit të integruar të burimeve ujore:

- Respektimi i integritetit të basenit ujëmbledhës bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burimet ujore, mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë së këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për gjeneratat e ardhshme;

- Koordinimi i kontrollit publik mbi burimet ujore nëpërmjet planifikimit të territorit dhe projekteve për zhvillimin socio-ekonomik, në nivel kombëtar dhe lokal;

- Përdorimi racional i burimeve ujore dhe kontrollit të emetimeve;

- Respektimi i parimit të rikuperimit të kostos së shërbimeve të ujit, duke përfshirë kostot mjedisore, në përputhje me parimin "ndotësi paguan";

Parimet e mbrojtjes së mjedisit;

Sigurimi i një furnizimi të mjaftueshëm të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të cilësisë së mirë për përdorim të qëndrueshëm, të balancuar dhe të barabartë të ujit;

- Ndërmarrja e veprimeve parandaluese për të shmangur dëmtimin e burimeve ujore, si një prioritet.

Në kapitullin 2 të ligjit nr. 111/2012 janë përcaktuar organet e administratës kombëtare dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore, së bashku me mandatet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse.

Të gjithë kapitujt e tjerë të ligjit nr. 111/2012, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", ofrojnë sqarimet e nevojshme në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, ndarjen territoriale, dokumentet e planifikimit dhe specifikimet për Strategjinë MIBU. Dispozitat specifike për kontrollin e ndotjes, zonat e mbrojtura, mbrojtjen e zonave të prirura ndaj ndotjes, si dhe masat për mbrojtjen e burimeve ujore e lidhin ligjin me Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së dhe legjislacionin tjetër kombëtar që rregullon sa më sipër.

Kapitujt pasues të ligjit nr. 111/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", detajojnë aspektet e mëposhtme në MIBU:

- Kapitulli 5 trajton përdorimin e burimeve ujore përmes autorizimeve, lejeve dhe kontratave të koncesionit. Gjithashtu përcakton prioritetet, qëllimin dhe rrethanat për përdorimin e burimeve ujore. Mbrojtja e burimeve natyrore, ujërave kuruese, ujërave minerale dhe gjeotermale tani trajtohen dhe rregullohen duke përcaktuar rregullat dhe parimet për të drejtën e pronësisë dhe përdorimin ekonomik në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor të këtyre burimeve të kufizuara.

- Kapitulli 7 detajon procesin e autorizimit, lejimit dhe koncesionit për përdorimin e burimeve ujore në përputhje me ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore, të ndryshuar. Subjekti i ligjit të sipërpërmendur janë zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare. Ligji përcakton zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare, rëndësinë e tyre dhe mënyrën e përcaktimit të kufijve të tyre, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e MBZHR-së.

- Kapitulli 8 adreson zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura, duke dhënë detaje mbi llojet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura dhe mbi përgjegjësinë e disa prej autoriteteve qendrore (Këshilli i Ministrave, ministritë e linjës, Këshillit Kombëtar të Ujit etj.) në përcaktimin, rregulloren dhe menaxhimin e këtyre zonave.

- Kapitulli 10 parashikon organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, me qëllim sigurimin e njerëzve, kafshëve dhe sigurinë e pronës duke marrë masat e duhura në zonat e prekura nga përmbytjet.

- Kapitulli 11 përcakton që aktivitetet e ndërtimit për shfrytëzimin e burimeve ujore ose për parandalimin e efekteve të pafavorshme të ujit, të kryera si shërbime publike, janë subjekt i kontratave të autorizimit, lejimit ose koncesionit.

- Kapitulli 12 ofron kushtet për shkarkimet në trupat ujorë, sistemet e ujërave nëntokësorë dhe të ujërave të ndotur, të cilat kryhen pas marrjes së një lejeje ose autorizimi të lëshuar nga institucionet përkatëse të menaxhimit dhe/ose administrative të burimeve ujore;

- Kapitulli 15 jep detaje mbi ruajtjen e statusit të ujërave detarë, ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë dhe zonave të mbrojtura.

Ligji nr. 111/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", gjithashtu parashikon dhe përcakton përmbajtjen e dokumenteve të politikave ujore, duke përfshirë: objektivin e planifikimit dhe zhvillimit të veprimeve të menaxhimit të ujit sipas zhvillimit ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor dhe historik; masat e zbatimit, planet operacionale dhe krijimin e buxhetit të nevojshëm për zbatim.

2.2 Legjislacioni sekondar (aktet nënligjore)

Ligji nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", duhet të plotësohet me disa akte të mbetura sekondare. Legjislacioni sekondar aktual për menaxhimin e ujërave (aktet nënligjore) përfshin:

- VKM nr. 416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, dokumentacionin shoqërues, periudhën e vlefshmërisë, formularët e aplikimit për autorizimet dhe lejet, procedurat për vendimmarrje dhe llojet e autorizimit dhe lejeve për shfrytëzimin e burimeve ujore";

- VKM nr. 797, datë 29.9.2010, "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes";

- VKM nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura";

- VKM nr. 504, datë 6.7.2016, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve";

- VKM nr. 643, datë 14.9.2011, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza";

- VKM nr. 590, datë 18.10.2017, "Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit";

- VKM nr. 177, datë 26.3.2014, "Për krijimin dhe përbërjen, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit Special për Menaxhimin Ndërkufitar të Ujërave";

- VKM nr. 177, datë 31.3.2005, "Për normat e lejuara për shkarkimet e lëngëta dhe kriteret për ndarjen mjedisore të lumenjve ose ujërave detarë";

- VKM nr. 268, datë 6.4.2016, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit", miratuar pas VKM-së nr. 125, datë 2.3.2006, "Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit dhe VKM-së nr. 1080, datë 18.12.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit";

- VKM nr. 342 datë 4.5.2016, "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë, vendndodhjen e zyrës qendrore dhe përbërjen e këshillit për secilën prej tyre";

- Vendimi parlamentar nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës në kuadër të Autoritetit Rregullator të Ujit";

- Vendimi nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave që lidhen me ujësjellësin, kanalizimet dhe trajtimin e ujërave të zeza";

- Vendimi nr. 28, datë 28.9.2011, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave";

- VKM nr. 230, datë 23.4.2014, "Për përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit";

- VKM nr 6/2018, datë 7.2.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore";

- VKM nr. 379, datë 25.5.2016 Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm", që shfuqizon VKM nr. 145, datë 26.2.1998 për miratimin e rregullores Higjienike - shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm";

- Draftvendimi, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Rajoneve të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet", miratuar aktualisht nga Këshilli Kombëtar i Ujit në 7.2.2015 , por ende për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo VKM është akti më i rëndësishëm nënligjor i ligjit nr. 111/2012. Përcakton përmbajtjen dhe procedurat për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planet për Menaxhimin e Baseneve Ujore dhe Planet për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet. Këto strategji dhe plane i nënshtrohen procedurave strategjike të vlerësimit mjedisor. Shtojcat e VKM-së përmbajnë përshkrime të hollësishme për çështjet e DKU-së së BE-së dhe DP-së së BE-së;

- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, "Për miratimin e planifikimit të përgjithshëm kombëtar të territorit" dhe lidhur me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. VKM nr. 881 merr në konsideratë propozimet e Planifikimit Territorial Kombëtar të Shqipërisë, respektivisht në kapitullin 3, "Sistemet Territoriale", ku shpjegohet organizimi i territorit në Shqipëri dhe propozimet për 5 sistemet territoriale (urbane, natyrore, bujqësore, ujë, infrastrukturë).

2.3 Pajtueshmëria rregullatore

Dispozitat e ligjit nr. 6/2018 dhe ligji 111/2012 janë në përputhje me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të zeza", i ndryshuar, ligji nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" në lidhje me Kodin Detar, neni 5, ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet e tjera nënligjore, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 643, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, "Mbi miratimin e Sektorit Kombëtar të Shërbimit për Furnizim me Ujë dhe Kanalizim".

Ligji 111/2012 dhe ligji 6/2018 janë në përputhje me:

- SEC (2009) 386 - Dokumenti Referencë - Dokumenti Shoqërues për Ujin;

- COM (2009) 147 final - Dokumenti Referencë mbi Kornizën Evropiane të Veprimit;

- Dokumenti i udhëzimit të DKU-së nr. 24 – Menaxhimi i Basenit Ujëmbledhës në Kushtet e Ndryshimeve Klimatike;

- Direktiva 2000/118/KE – Për ujërat nëntokësore;

- SEC (2010) 166 final – Dokumenti i Punës së Stafit si dokument shoqërues i Direktivës për Ujërat Nëntokësore;

- SEC (2010) 1096 final – Raport për Direktivën e Ujërave Nëntokësore;

- Direktiva 91/271/EEC – Për ujërat e ndotura urbane;

- Direktiva 2008/105/KE – Për standardet e cilësisë së mjedisit në fushën e politikës së ujit;

- COM (2004) 472 - Komunikimi për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet, Parandalimin, Mbrojtjen dhe Zbutjen;

- COM (2007) 414 final – Komunikimi për mungesën e ujit dhe thatësirës. Raporti i Planit mbi Thatësirat;

- COM (2007) 354 final – Dokumenti i Gjelbër mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Ligji është pjesërisht në përputhje me:

- Direktiva 2006/118/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, datë 12.12.2006, "Për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe përkeqësimi", lidhur me përkufizimin e "niveleve bazë". Pjesa tjetër e kësaj Direktive është plotësisht e transpozuar;

- Direktiva 2007/60/KE, "Për administrimin e rrezikut nga përmbytjet", në lidhje me përkufizimin e termave "përmbytje" dhe "rrezik nga përmbytjet". Pjesa tjetër e kësaj Direktive është plotësisht e transpozuar;

2.4 Marrëveshjet ndërkombëtare

Një përpjekje e hershme për të kodifikuar ligjin ndërkombëtar të ujit ka qenë dokumenti **"Rregullat e Helsinkit mbi përdorimet e ujërave të lumenjve ndërkombëtarë"** i miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Drejtësisë në vitin 1966, e cila nuk ishte e detyrueshme. Dokumenti u zëvendësua nga "**Rregullat e Berlinit"** i vitit 2004.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e UNECE-së, **"Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtarë",** më 5 janar 1994, dokument primar për lumenjtë ndërkufitarë dhe, me përjashtim të Kosovës, është ratifikuar nga të gjithë vendet fqinje.

Preambula thekson se mbrojtja dhe përdorimi i rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtarë janë detyra të rëndësishme dhe urgjente që mund të zgjidhen vetëm me

bashkëpunimin ndërkombëtar. Gjithashtu thekson rëndësinë e luftimit të ekzistencës dhe kërcënimeve të efekteve të dëmshme në mjedis, ekonomi dhe mirëqenie të vendeve anëtare. Thekson nevojën për masa të forta kombëtare dhe ndërkombëtare për të parandaluar, kontrolluar dhe reduktuar shkarkimin e substancave të rrezikshme në mjedisin ujor dhe për të reduktuar eutrofikimin dhe acidifikimin e ujërave.

Pjesa I e Konventës zbatohet për të gjitha palët. Neni i parë është një përmbledhje përcaktimesh për "Ujërat ndërkufitare".

Paragrafi i parë i dispozitave të përgjithshme, neni 2, thotë se *"Palët do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, kontrolluar dhe zvogëluar çdo ndikim ndërkufitar"*. Gjithashtu thekson nevojën për masa të forta kombëtare dhe ndërkombëtare për të parandaluar, kontrolluar dhe zvogëluar shkarkimin e substancave të rrezikshme në mjedisin ujor dhe për të ulur eutrofikimin dhe acidifikimin. Artikulli gjithashtu i referohet Parimit të Kujdesit (shmangia e rreziqeve të mundshme pa pritur prova të përcaktuara të rrezikut) dhe Parimit "Ndotësi Paguan" (kostot e parandalimit të ndotjes, masat e kontrollit dhe reduktimit do të përballohen nga ndotësi).

Pjesa I gjithashtu përmban një seri artikujsh lidhur me "Parandalimin, kontrollin dhe reduktimin", "Monitorimin", "Hulumtimin dhe zhvillimin", "Shkëmbimin e informacionit, "Përgjegjësinë dhe detyrimin" dhe "Mbrojtjen e informacionit".

Pjesa II ka të bëjë me "Dispozitat në lidhje me vendet ndërkufitare". Në këtë seksion, neni 9 mbulon "Bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh", duke përfshirë krijimin e organeve të përbashkëta. Ajo, gjithashtu, mbulon fushat e bashkëpunimit si kërkimi shkencor i përbashkët, shkëmbimi i informacionit dhe paralajmërimi dhe sistemet e alarmit.

Pjesa e tretë dhe e fundit, ka të bëjë me çështjet institucionale.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar protokollin e UNECE-s, **"Për ujin dhe shëndetin**" më 8 mars 2002. Qëllimi kryesor i Protokollit është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mirëqenies nëpërmjet menaxhimit më të mirë të ujit, duke përfshirë mbrojtjen e ekosistemeve ujore, si dhe nëpërmjet parandalimit, kontrollit dhe reduktimit të sëmundjeve me origjinë nga uji.

Protokolli është marrëveshja e parë ndërkombëtare e këtij lloji e miratuar posaçërisht për të arritur furnizimin e duhur me ujë të pijshëm të sigurt dhe higjienën e duhur për të gjithë, si dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive burimet ujore që përdoren për ujë të pijshëm. Zhvillime të qarta për këtë qëllim mund të shihen duke analizuar raportin e fundit përmbledhës të paraqitur nga shteti në prill 2016:

- përqindja e mostrave që nuk arriti të përmbushë standardin kombëtar për *E. coli* ka rënë nga 1.9% në 2013 në 0.67% në vitin 2015;
- aksesi i popullatës në shërbimet e ujit dhe kanalizimeve u rrit nga vlerat bazë;
- cilësia e ujërave të larjes u rrit nga 45% në 2011 në 68% në 2015.

Konventat e mësipërme të UNECE-së kanë të bëjnë me "cilësinë e ujit" dhe jo "sasinë e ujit". Nga ana tjetër, "Konventa e OKB-së mbi ligjin e përdorimit jolundrues të rrjedhave ndërkombëtare të ujit" të miratuar në vitin 1997, zgjeron fushën e interesit, duke theksuar në preambulën e saj se "një konventë kuadër do të sigurojë shfrytëzimin, zhvillimin, ruajtjen, menaxhimin dhe mbrojtjen e rrjedhave ujore ndërkombëtare dhe promovimin e shfrytëzimit optimal dhe të qëndrueshëm të tyre për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm". "Një nga konceptet kyçe në këtë Konventë është që Shtetet ndërkufitare në territoret e tyre të shfrytëzojnë një rrjedhë ujore ndërkombëtare në një "mënyrë të barabartë dhe të arsyeshme ". Konventa përcakton kriteret për të gjykuar nëse përdorimi është 'i drejtë dhe i arsyeshëm'. Nga vendet fqinje të Shqipërisë, vetëm Greqia dhe Mali i Zi e kanë ratifikuar këtë konventë.

Liqenet ndërkufitare janë: liqeni i Shkodrës që ndahet me Malin e Zi, liqeni i Ohrit që ndahet me Maqedoninë e Veriut, dhe liqeni i Prespës që ndahet me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Baseni ujor Drin–Bunë ndahet me katër shtete fqinje: Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Kosovën. Në vitin 2003 u nënshkrua një marrëveshje me Malin e Zi, e cila vendosi bashkëpunimin dypalësh për sa u përket burimeve ujore që ndahen midis dy vendeve. Nga viti 2008 deri në vitin 2012, u zbatua Projekti "Liqeni i Shkodrës: Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit", i financuar nga GEF dhe Qeveria Shqiptare. Gjithashtu, në vitin 2003 u ratifikua një marrëveshje me Greqinë, edhe pse bashkëpunimi

dypalësh nuk solli rezultatet e pritura. Në vitin 2008 fatkeqësisht u mbajt vetëm një takim, palët janë në kontakte të vazhdueshme.

Në vitin 2010 u nënshkrua një **Memorandum i Mirëkuptimit**, "Për marrjen e masave për rregullimin e regjimit të ujërave në liqenin e Shkodrës, basenin ujor Drin–Bunë" me Malit të Zi. Një marrëveshje me Maqedoninë e Veriut është ende në negociata; gjithsesi ende nuk ka prodhuar rezultatet e dëshiruara edhe pse të dyja shtetet kanë shprehur vullnetin e tyre për ta përmbyllur. Një marrëveshje me Maqedoninë e Veriut u nënshkrua për liqenin e Ohrit, "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe basenit të tij".

Për të përmirësuar gatishmërinë dhe reagimin ndaj përmbytjeve në basenin e Drinit, Shqipëria nënshkroi **"Përfundimet për Zhvillimin dhe thellimin e Bashkëpunimit Rajonal në fushën e Menaxhimit të Krizave"** midis Republikave të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, e cila u nënshkrua në Shkup në maj të vitit 2011. Në nëntor të 2011 u nënshkrua në Tiranë një **Memorandum Mirëkuptimi** për "Lumin e Drinit: Një vizion strategjik i ndarë" ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore në nivel ndërkufitar.

2.5 Kuadri Institucional

Strukturat e administrimit dhe menaxhimit të ujërave janë të disponueshme në nivel kombëtar dhe vendor. Figura 2.1 përshkruan marrëdhënien aktuale ndërmjet ministrive dhe agjencive vendore[1]. Në nivel kombëtar, Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi ekzekutiv qendror. Duke qenë se Shqipëria është një vend kandidat për pranimin në BE, ajo ka nevojë t'i përqaset përputhshmërisë me një numër të konsiderueshëm të direktivave të BE-së që lidhen me menaxhimin e ujërave. Vendi ndahet në gjashtë basene ujore, ku secili ka një Këshill të Basenit Ujor (KBU) dhe një Zyrë të Administrimit të Basenit Ujor. Kjo strukturë është e favorshme në parim për të neutralizuar fragmentimin e menaxhimit të burimeve ujore dhe për të promovuar një administrim efektiv në nivel lokal.

2.5.1 Institucionet e nivelit qendror

Ministria përgjegjëse për ujitjen dhe për kullimin është përgjegjëse për menaxhimin e ujitjes dhe aktiviteteve të kullimit dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- përcakton politikën kombëtare mbi sistemet e ujitjes dhe kullimit;
- mbikëqyr veprimtarinë dhe aktivitetet e organizatave, dhe bordeve e kullimit nga perspektiva ligjore dhe financiare;
- mbikëqyr aspektet teknike të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- propozon ngritjen e Bordeve të Kullimit;
- autorizon transferimin e sistemeve të ujitjes dhe kanaleve kryesore të ujitjes;
- ndërmerr veprime të nevojshme për të siguruar funksionimin e objekteve dhe digave të mbrojtjes nga përmbytjet si pjesë e sistemeve të ujitjes;
- mban bazën e të dhënave të bordeve të kullimit, komunitetin;
- këshillon dhe udhëzon organizatat, komunitetin dhe bordet e kullimit, duke vepruar gjithmonë në kërkesën e këtij të fundit për çështje ligjore, teknike dhe financiare;
- mbikëqyr përzgjedhjen e administratës së bordeve për organizatat dhe komunitetin;
- kryen auditimin financiar të organizatave, dhe Bordeve të kullimit;
- kryen inspektime të gjendjes teknike dhe fizike të sistemeve të ujitjes, kanaleve kryesore, sistemeve kryesore të kullimit dhe punëve të mbrojtjes nga përmbytjet;
- monitoron cilësinë e ujitjes, ujërave të kullimit dhe tokave.

KKU-ja është ngritur në vitin 1996. Ky është organi ekzekutiv qendror për menaxhimin e burimeve ujore duke ofruar një forum të nivelit të lartë për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në një mënyrë të integruar. KKU-ja tani siguron pjesën më të madhe të anëtarëve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin, ngritur me Urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 21,09,2015. Vendimi Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 4, i datës 2 dhjetor 2015, ka ngritur katër nëngrupe tematike (respektivisht, uji për njerëzit, për ushqim, për mjedis dhe për industri). Përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar, për më tepër

[1] Janë përfshirë ndryshimet e fundit të pozicionit në të dyja bordet e kullimit dhe autoritetet e baseneve ujore.

sigurimin e fleksibilitetit të nevojshëm për t'ju përgjigjur situatave komplekse në kohë, për veprime efektive. Në parim, ata duhet të takohen dy herë në muaj ose sipas nevojës.

Ligji 111/2012 për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore", si dhe ligji nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" krijojnë KKU-në si organ të lartë përgjegjës për përcaktimin e linjave kryesore të politikës dhe vendimmarrjes. Kryeministri kryeson KKU-në, dhe në përputhje me nenin 5(2) të LBU-së, përbërja e tij duhet të përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Anëtarët e KKU-së janë si më poshtë:

- Kryeministri (Kryetari); ose në mungesë të tij zëvendëskryeministri;
- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
- Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministri i Mbrojtjes;

Funksionet e KKU-së përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm te:

- përgatitja e propozimeve për draftligjet dhe rregulloret për çdo lloj aktiviteti që lidhet me burimet ujore;
- miratimi i kuadrit ligjor, teknik dhe rregullator për të zbatuar LBU-në, dhe për më tepër draftudhëzimeve, dhe ndërmarrja e masave të tjera të nevojshme për zbatimin e planit kombëtar për burimet ujore;
- miratimi dhe menaxhimi i planeve të Baseneve Ujore;
- lëshimi i lejeve dhe autorizimeve të shkarkimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza kur veprimtaritë përkatëse ndodhin përtej kufijve të një baseni ujor;
- miratimi i rregullave funksionale për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshillat e Baseneve Ujore dhe Zyrat e Administrimit të Basenit Ujor; Miratimi i planeve dhe projekteve ndër-rajonale dhe kombëtare në fushën e bujqësisë, planifikimit urban, zhvillimit industrial dhe territorial me efekte në mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave;
- përcaktimi i kufijve të baseneve ujore dhe krijimi i zyrave për secilin prej tyre, ku do të mbahet Regjistri për Burimet Ujore;
- krijimi i agjencive ose njësive të tjera organizative, nën kontrollin e Këshillit, për të lehtësuar menaxhimin e burimeve ujore dhe zbatimin e ligjit;
- propozimi dhe përshtatja e duhur e masave për zbatimin e marrëveshjeve ose konventave për burimet ujore ku Republika e Shqipërisë është palë nënshkruese; dhe
- miratimi i koncesioneve për burimet ujore sipas dispozitave të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur burimet ujore kanë rëndësi kombëtare, dhënia me koncesion do të hyjë në fuqi vetëm me miratimin e Parlamentit.

KKU-ja mbështetet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, sipas ligjit 6/2018, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Megjithëse fillimisht nën ministrinë përgjegjëse për çështjet mjedisore, funksionet aktuale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore si organi ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit janë nën varësinë e Kryeministrit. Gjithashtu, zëvendëskryeministri është anëtar i KKU-së dhe kryeson takimin në mungesë të Kryeministrit.

Ndër të tjera, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është përgjegjëse për:

- zbatimin e politikave kombëtare të burimeve ujore të miratuara nga KKU;
- zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare për burimet ndërkufitare të ujit në të cilat Shqipëria është palë;
- zhvillimi i një inventari kombëtar të burimeve ujore, duke përfshirë aspektet e sasisë dhe cilësisë;
- aplikimet e shqyrtimit për përdorimin e ujit dhe shkarkimet e ujërave të ndotura dhe autorizimet që do të lëshohen nga KKU;
- promovimi i pjesëmarrjes së përdoruesve të ujit në menaxhimin e burimeve ujore;
- promovimi i studimeve dhe kërkimeve;
- identifikimin e fushave kërkimore dhe burimet përkatëse të financimit, në koordinim me institucionet kërkimore;
- koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së Këshillave të Baseneve dhe Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor;
- monitorimin e zbatimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

Sipas VKM-ve nr. 91 dhe 92, datë 4.2.2015, përgjegjësia e "Drejtorisë së Politikave të Ujërave" kaloi nga ministria përgjegjëse për mjedisin në varësinë e ministrisë përgjegjëse për burimet ujore dhe ujitjen, menaxhimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.



Figura 2.1: Struktura organizative dhe institucionale për menaxhimin e burimeve ujore

Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve përgatit politika dhe strategji për sektorin e furnizimit me ujë dhe për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Këto bazohen mbi programet qeveritare dhe strategjitë sektoriale, planet dhe investimet për ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe impiantet e mbetjeve të ngurta. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve vlerëson nevojat për subvencione dhe ndjek shpërndarjen e tyre nëpërmjet institucioneve të saj vartëse.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) është një institucion që raporton te ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, duke qenë se është e specializuar në furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura. AKUK-ja asiston me ndihmë teknike politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, sipas legjislacionit në fuqi dhe politikave të përcaktuara në strategjitë përkatëse sektoriale, përfshirë politikat e menaxhimit të ujit dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kombëtare në nivel qendror dhe lokal. Brenda strukturës së saj organizative, AKUK-ja përfshin Drejtorinë Teknike, Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë për Projekte të Huaja, Drejtorinë e Monitorimit dhe tri drejtori rajonale.

Ministria përgjegjëse për çështjet e energjisë luan një rol të rëndësishëm në sektorin e ujërave; duke qenë se ajo është përgjegjëse për prodhimin e energjisë hidrike, që përfaqësojnë mbi 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Ministria është përgjegjëse për miratimin e hidrocentraleve të reja. Ministria mund të ndërhyjë në rrjetin e shpërndarjes për të përmirësuar sigurinë e shërbimit dhe për të rritur eksportet e mundshme (BB, 2009a).

Ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit

shëndetësor[2]. Ndër të tjera, ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore harton, propozon për miratim dhe zbaton akte ligjore dhe nënligjore për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëm nëpërmjet institucioneve në varësi të saj, përkatësisht Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (SRSHP), Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) dhe Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile kryen aktivitetet e saj sipas legjislacionit për parandalimin, reduktimin dhe lehtësimin e efekteve negative të emergjencave civile mbi popullsinë, bagëtinë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Ministria ka në përbërje të strukturës së saj Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, që zbaton Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, duke marrë parasysh ekspozimin e Shqipërisë ndaj katastrofave natyrore që përfshijnë përmbytjet dhe katastrofat që lidhen me aktivitetin e njeriut. Ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile nëpërmjet institucionit të Prefektit koordinon aktivitetin e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe funksionet e deleguara me NJQV-të në nivel bashkiak dhe qarku (GoA, 2015b).

Ministria përgjegjëse për financat akordon, bazuar te prioritetet e qeverisë, burime financiare për sektorin e ujërave, duke i dhënë prioritet menaxhimit të duhur të burimeve ujore për përmbushjen e nevojave të shoqërisë. Ministri përgjegjës për financat është anëtar i KKU-së.[3]

2.5.2 Institutet kombëtare të përfshira në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave.

Organizimi i monitorimit të cilësisë së ujërave (burimeve) është i ndërlikuar, me mbi 20 institucione qeveritare të ndryshme të përfshira aktualisht në mbledhjen e të dhënave për një numër të kufizuar parametrash me mbulim gjeografik të pjesshëm.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), nën varësinë e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e mjedisit, është përgjegjëse për monitorimin cilësor dhe sasior të burimeve ujore. Ajo mbikëqyr punën e instituteve përkatëse për monitorimin e aktiviteteve dhe është përfituesja kryesore e të dhënave të siguruara nëpërmjet institucioneve të mëposhtme:

- Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, (ish Instituti Hidrometeorologjik), nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për arsimin, monitoron parametrat hidrometeorologjikë dhe është përgjegjës për kryerjen e monitorimit të sasisë së ujërave sipërfaqësorë për lumenjtë dhe liqenet. Rrjeti meteorologjik i IGJEUM-it përbëhet tashmë nga stacione automatike. Të dhënat dhe alarmet hidrologjike (treguesit për rrezikun nga përmbytjet dhe zjarri në pyje) u janë shpërndarë aktorëve dhe janë publikuar *online*;

- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e energjisë, monitoron cilësinë e ujërave nëntokësorë dhe detarë, vlerëson rrezikun dhe monitorimin e ndotjes së tokës;

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e cila është nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për energjinë, përqendrohet në monitorimin e hidrocentraleve;

- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni, në varësi administrative të ministrisë përgjegjëse për shëndetësisë, ndër të tjera është përgjegjës për sigurimin e ekspertizave dhe pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndetin publik[4]. Mbështet Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik me ekspertizë në monitorimin e jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm, survejancën epidemiologjike dhe trajnimin e vazhdueshëm, si dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) me ekspertizë dhe ekzaminime laboratorike. ISHP, në kontratë me AKM kryen vlerësimin mikrobiologjik të cilësisë së ujërave bregdetare të larjes. Ky vlerësim bëhet në bazë të ngarkesës bakteriale të tyre (*Escherichia coli, Enteroccocus intestinalis*), si dhe inspektimit të

[2] VKM nr. 940, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë përgjegjëse për çështjet shëndetësore".

[3] Sipas nenit 5(2) të LBU-së.

[4] Ligji nr. 10 138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik", i ndryshuar.

mjedisit për vlerësimin e faktorëve të rrezikut që ndikojnë në ndotjen e tyre.

- Enti Rregullator i Ujit është një institucion i pavarur, i krijuar nga Parlamenti. Detyrat kryesore përfshijnë lëshimin e licencave për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime, miratimin e tarifave për ujin e pijshëm.

Në vitin 2009, u miratuan rregullat dhe procedurat për Monitorimin Kombëtar Mjedisor nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (nr. 1189, plotësuar me VKM nr. 267, duke ofruar kuadrin për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë (lumenj, liqene, dhe ujëra detarë të plazheve), nëntokësorë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura VKM nr. 267, datë 7.5.2014 miraton listën e substancave prioritare që monitorohen si pjesë e këtyre përpjekjeve, duke transpozuar direktivën 2008/105/EC mbi standardet e cilësisë së mjedisit.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor është krijuar në vitin 2013, sipas ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", përgjegjësitë e tij kryesore janë:

- Zbatimi i politikave kombëtare për infrastrukturën informative gjeohapësinore;
- Përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Kornizës Gjeodezike;
- Vendime për grumbullimin, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, duke përfshirë sektorin e ujit;
- Vendos standarde dhe rregulla uniforme për krijimin e GIS-it për fusha të ndryshme, duke përfshirë sektorin e ujit dhe për krijimin e GIS kombëtar në përputhje me standardet përkatëse evropiane;
- Përgatit rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, ndarjen, qasjen dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve përkatëse;
- Administron informacionin gjeohapësinor të mbledhur, përpunuar dhe përditësuar nga autoritetet publike në fusha të ndryshme;
- Siguron koordinimin e punës, mbështet iniciativat dhe aktivitetet në lidhje me informatat gjeohapësinore në sektorin publik dhe privat;
- Zhvillon dhe administron Geoportalin Kombëtar dhe garanton qasje publike sipas dispozitave të ligjit 72/2012.

2.5.3 Njësitë e qeverisjes vendore, këshillat e baseneve ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore

Që prej zgjedhjeve vendore të vitit 2 015, organizimi i qeverisjes vendore ka ndryshuar. Përpara hyrjes në fuqi të ligjit për ndarjen e re administrative dhe territoriale (ligji nr. 115/2014), ishte e ndarë në 308 fshatra, 65 bashki dhe 12 qarqe. Reforma administrative dhe territoriale nuk solli ndryshime në nivelin e qarkut duke mos ndryshuar numrin prej 12, por u ndërmorën ndryshime radikale në nivelin e komunave dhe bashkive. Sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale janë krijuar 61 bashki të reja. Bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore, duke përfaqësuar kështu nivelin e parë të qeverisjes. Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) janë të organizuara në njësi administrative përbërëse (ish fshatrat) dhe si nën ndarje administrative të bashkive. Nga pikëpamja e planifikimit të territorit, bashkitë do të vijojnë të organizohen në qytete dhe fshatra.

Ndikimi i zhvillimit social dhe ekonomik në nivel rajonal dhe roli i institucioneve rajonale ka qenë i dobët në të shkuarën si pasojë e mungesës së një modeli të qartë për veprimtarinë rajonale, mungesës së burimeve financiare, aseteve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme institucionale. Organet e decentralizuara në nivel vendor përfaqësohen nga dy institucione, përkatësisht i. Prefekti; dhe ii. drejtoritë/zyrat rajonale/vendore të ministrive të linjës. Menaxhimi i Ujërave është i organizuar në nivelin e Baseneve Ujore nëpërmjet gjashtë Këshillave të Baseneve Ujore (KBU), ndërsa Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore janë 4 (Vjosë, Shkumbin–Seman, Ishëm–Erzen–Mat, Drin–Bunë).

Secili nga Këshillat e Baseneve Ujore (KBU) kryesohet nga një prej prefektëve përgjegjës dhe është i përbërë nga 29 anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme vendore, NJQV-të, bizneset dhe konsumatorët e basenit. (VKM nr. 342, datë 4 Maj 2016:, "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre").

Neni 12 i ligjit nr. 111/2012, si dhe ligji nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit 111/2012 për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore", theksojnë se çdo KBU duhet të sigurojë:

- Mbrojtje, zhvillim dhe veprimtari të arsyeshme me burimet ujore brenda kufijve të basenit të tij;
- Shpërndarje të drejtë brenda kufijve të basenit të tij në përputhje me qëllimin e përdorimit dhe administrimin efikas të tyre;
- Mbrojtje të burimeve ujore nga ndotja, keqpërdorimi dhe mbipërdorimi.

Këshillat e Baseneve Ujore asistohen nga Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore, që funksionojnë si një Agjenci Menaxhimi për KBU-në. Ato janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për Burimet Ujore. Ato ndërmarrin vlerësimin teknik të aplikimeve për përdorimin e ujit (ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë) dhe japin rekomandime për miratim nga KBU-të, mbështesin bashkitë për zgjidhjen e problematikave të lidhura me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për inspektimin e të gjitha veprimtarive që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore kanë autoritet të kufizuar për të zbatuar procedurat ligjore dhe rregullatore.

Pjesëmarrja/përfshirja e përdoruesve përfundimtarë në menaxhimin e burimeve ujore rregullohet nga vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU), datë 21.6.2006, që shprehet se përfaqësuesit e përdoruesve të ujit përbëjnë 30% të anëtarësisë së KKU-së. Për më tepër, takimet e KBU-së mbahen me dyer të hapura. Në praktikë, publiku i gjerë dhe grupet e vogla të përdoruesve mund të marrin pjesë në mënyrë shumë të kufizuar në proceset formale të menaxhimit të burimeve ujore. Furnizimi me Ujë të Pijshëm është përgjegjësi e 57 ndërmarrjeve të ujësjellësit që veprojnë nën Njësitë e Qeverisjes Vendore (VKM nr. 342, datë 4 maj 2016, "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografike të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre").

Në vitin 2010[5], një vendim i Këshillit të Ministrave ka transferuar pronësinë e 305 rezervuarëve të vegjël bujqësorë te NJQV-të, duke i bërë kështu përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Dhënia e lejeve dhe zbatueshmëria e legjislacionit mjedisor është përgjegjësi e dymbëdhjetë Agjencive Rajonale Mjedisore (ARM).

Në vitin 2015, u miratua me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, "Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelit dhe aseteve nga Bordet Rajonale të Kullimit", duke qenë se shërbimet e ujitjes dhe kullimit kishin ende nevojë për përmirësim. Duke i transferuar infrastrukturat e vogla të ujitjes te bashkitë dhe fshatrat, do të përmirësohet vendimmarrja lidhur me sistemet e ujitjes dhe kullimit.

Meqenëse vetëm infrastrukturat kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe digat menaxhohen tashmë nga ministria përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin, bashkitë do të bashkëpunojnë dhe do të bashkërendojnë me strukturat rajonale të kësaj ministrie përgjegjëse dhe BRK-të, aktivitetet planifikuese për kërkesën vjetore për ujë për ujitje, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit[6]. Organizimi i sotëm institucional për ujitjen dhe menaxhimin e kullimit përfshin fshatrat/bashkitë si një lidhje e rëndësishme, që sjell si rezultat tri nivele menaxhimi:

- Qeverisjen qendrore, ministria përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin dhe Bordet e Kullimit kanë kompetencat më të larta të nivelit të administrimit mbi asetet parësore dhe digat;
- Bashkitë si një nivel i ndërmjetëm administrimi për asetet dytësore dhe tretësore; dhe
- Organizatat e përdoruesve të ujit dhe bashkimet e tyre si niveli më i ulët i administrimit.

Lidhja e ndërmjetme midis qeverisë qendrore dhe strukturave të saj vendore nga njëra anë, dhe SHPU-ve/OPU-ve nga ana tjetër, është përmirësuar, gjë e cila mungonte nga reforma e mëparshme bujqësore. Bordet e Kullimit dhe

[5] Nr. 567, datë 14.7.2010, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
[6] Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020.

njësitë e reja të qeverisjes vendore dhe bashkitë do të punojnë në partneritet me SHPU-të për të përmirësuar kapacitetet vendore.

3. Karakteristikat e Përgjithshme të Basenit Ujor Drin–Bunë

3.1 Përshkrimi i ujërave sipërfaqësorë

Baseni Ujor Drin–Bunë është një nga më kompleksët në Evropë; një nga degët kryesore të tij është me dy drejtime dhe ujëmbledhësi i ujërave sipërfaqësore dhe ujëmbledhësi i ujërave nëntokësorë nuk janë në afërsi të njëri-tjetrit. Baseni Drin–Bunë shtrihet edhe jashtë kufirit të vendit. Pjesë të basenit shtrihen në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Kosovë dhe Greqi. Për sa i përket shtrirjes, afërsisht 40% e basenit të përgjithshëm ndodhet brenda Shqipërisë dhe pjesa tjetër jashtë.

Brenda basenit gjenden tri liqene kryesore: Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ohrit dhe Liqeni i Prespës. Për sa i përket sipërfaqes, Liqeni i Shkodrës është më i madhi, që varion nga 370 km^2 deri në 530 km^2. Liqeni është i cekët me një thellësi mesatare prej 5 metrash dhe lartësia e tij varion nga 4.7 në 9.8 metra mbi nivelin e detit. Vëllimi i tij është 1.93×10^9 m^3. Liqeni ushqehet pjesërisht nga prurjet hyrëse të lumenjve përreth dhe pjesërisht nga burimet karstike, të cilat ndodhen në shtratin e liqenit.

Liqeni i Ohrit është një nga liqenet më të thellë dhe më të vjetër të Evropës, duke ruajtur një ekosistem unik ujor që ka rëndësi botërore, me më shumë se 200 specie endemike. Ai ka një sipërfaqe prej 388 km^2, thellësi mesatare prej 155 m dhe një thellësi maksimale prej rreth 300 metra. Sipërfaqja e tij është në lartësinë 693 m. Vëllimi i tij është $55.49x10^9$ m^3.

Liqeni i Prespës shtrihet brenda një baseni endoreik, pra pa rrjedhë lumi që del prej tij. Ai aktualisht përbëhet nga dy liqene: Liqeni i Prespës së Madhe dhe Liqeni i Prespës së Vogël. Sipërfaqja e përgjithshme e tij është 274 km^2 dhe vëllimi i tij është $4.8x10^9$ m^3. Në një lartësi prej 854 m, është liqeni më i lartë në Ballkan. Prurja mesatare hyrëse në liqenin e Prespës është vlerësuar si 2.55 m^3/s. E gjithë kjo kalon nëpërmjet ujërave nëntokësorë në liqenin e Ohrit. Edhe pse ka një disnivel të madh në lartësinë sipërfaqësore mes të Liqenit të Prespës dhe Liqenit të Ohrit, sasia e prurjes nuk ndryshon shumë gjatë vitit.

Lumi Drin është lumi më i madh i Shqipërisë, si dhe më i madhi në bregdetin Adriatik të Gadishullit Ballkanik, si në aspektin e zonës ujëmbledhëse, ashtu edhe në kontributin e vetë basenit. Baseni i lumit Drin ka një natyrë ndërkufitare, që ndodhet në pjesën veriore dhe lindore të territorit të Shqipërisë me një sipërfaqe totale prej 14,173 km^2, nga të cilat 5,973 km^2 shtrihen në territorin e Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër në Greqi, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi.

Lumi Drin në territorin shqiptar karakterizohet nga një reliev malor, me lartësi mesatare prej 971 m mbi nivelin e detit, me rreth 50% të zonës ujëmbledhëse të lumit në territorin e Shqipërisë që ndodhet në një lartësi prej 850 m. Lumi Drin, i cili fillon nga Liqeni i Ohrit në Strugë dhe përfundimisht derdhet në lumin Bunë, ka një gjatësi prej 285 km dhe një rënie prej 685 metra, që korrespondon me një pjerrësi mesatare prej 2.3%. Lumi Drin formohet nga dy degë kryesore: Drini Zi dhe i Bardhë. Gjatësia e Drinit të Zi nga liqeni i Ohrit në Kukës është 149 km dhe sipërfaqja e basenit është 5,885 km^2, ndërsa Drini i Bardhë nga burimi (Kosovë) deri te bashkimi me lumin Drin i Zi ka një gjatësi prej 136 km dhe sipërfaqe baseni prej 4,964 km^2. Deri në vitin 1956 (kur filloi zbatimi i hidrocentralit Vau i Dejës), Lumi Drin pas Vaut të Dejës ndahej në dy degë, Bahçallëk, i cili shkarkohej në Bunë dhe në degën e Lezhës, e cila pas marrjes së ujërave të Gjadrit shkarkohej në det pranë Qytetit të Lezhës.

Lumi Bunë buron nga Liqeni i Shkodrës. Sipërfaqja e ujëmbledhësit të lumit Bunë është 5,179 km^2, nga të cilat 1,025 km^2 gjenden brenda territorit të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër gjendet në Mal të Zi. Lumi Bunë, nga pika e fillimit në fshatin Samerisht deri në shkarkimi i tij në Detin Adriatik ka një gjatësi prej 44 km, duke ndarë kufirin shtetëror midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Lumi Bunë mbledh ujërat e lumit Drin dhe ujë nga Liqeni i Shkodrës. Lumi Bunë ka një deltë klasike, të përbërë nga disa ishuj aluvialë, të vendosur në grykëderdhjen e tij.

Degët kryesore dhe zonat e tyre përkatëse në Basenin Ujor Drin–Bunë tregohen në Tabelën 3.1.

Tabela 3.1: Karakteristikat e degëve kryesore të lumit Drin [7]

Lumi	Degët kryesore	Gjatësia (km)	Sipërfaqja e Basenit (km^2)	Mesatarja e lartësisë mbi nivelin e detit (m)	Prurja mesatare ($m^3 \cdot s^{-1}$)
Drin	Drini i Bardhë	134	4,964	862	68.2
Drin	Drini i Zi	149	3,504	1,132	118
Drin	Drini dega kryesore	285	11,756	971	352
Bunë	Buna dega kryesore	1.5	5,187		320
Drin + Bunë	Bashkimi	32.5	19,582	770	680

Në lumin Drin gjenden tri hidrocentrale të mëdhenj operativë me një kapacitet total të instaluar prej 1,350 mw, HEC "Vau i Dejës", (HEC) "Fierza" dhe HEC "Koman"., si dhe një kontratë koncesioni për hidrocentralin "Ashta" në lumin Drin, me një kapacitet të instaluar prej 48.2 mw. Sipas informacionit të siguruar nga AKBN-ja, në tremujorin e parë të 2018, kishte 29 HEC-e në funksionim. Baseni Ujor Drin–Bunë karakterizohet nga tri lloje kryesore akuiferësh: i. Kuaternar (Shkodër, Zadrimë-Nënshkodër dhe akuiferët e Peshkopisë) me cilësi "të mirë" të ujit; ii. karbonatik, në anën veriperëndimore dhe në pjesën jugore të basenit qendror, dhe iii) magmatik, shfrytëzuar në masivin Korrabi. Të dyja akuiferet karbonatik dhe magmatik klasifikohen me cilësi "shumë të mirë" të ujit.

Në Basenin Ujor Drin–Bunë ekzistojnë 110 rezervuarë të ujitjes. Sidoqoftë, për shkak të erozionit në basen dhe sedimentimit, vëllimi aktual i ujit në dispozicion për ujitje është vetëm rreth 50% e kapacitetit të projektimit të rezervuarëve me një mesatare totale prej rreth 0.03 km^3 të ujit të përdorur për ujitje.

Një Hartë Hidrografike e Basenit Ujor Drin–Bunë është dhënë në figurën 3.1. Një pasqyrë e burimeve ujore dhe përdorimit të ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë është paraqitur në tabelën 3.2.

[7] Burimi: Konsolidimi i Sistemit të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri "KSMMSH".



Figura 3.1: Harta hidrografike e Basenit Ujor Drin–Bunë

Tabela 3.2: Përmbledhje e burimeve ujore dhe përdorimit të ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë[8]

Sipërfaqja	
Sipërfaqja totale e basenit të Drinit në Shqipëri Sipërfaqja totale e basenit të Bunës në Shqipëri Sipërfaqja totale e Basenit Ujor Drin–Bunë në Shqipëri Sipërfaqja totale e Basenit Ujor ndërkufitar Drin–Bunë	5,973 km^2 1,025 km^2 6,998 km^2 19,582 km^2
Burimet e Ujit	
Numri i lumenjve kryesorë	2
Numri i degëve	5
Gjatësia e lumit kryesor (km)	285
Prurjet mesatare vjetore (m^3/s)	680
Cilësia e ujërave sipërfaqësore	Shumë e mirë, e mirë
Numri i liqeneve të mëdhenj	3
Numri i akuiferëve kryesorë të përdorur (Banka Botërore, 2012)[9]	3
	Përdorimi i Ujit
Numri i rezervuarëve bujqësorë	Përdorim i lartë (110 Diga)
Numri i hidrocentraleve të mëdha (48–500 mw)	4
Koncesionet e HEC-ve	47 për një total prej 121[10] HEC-e të vogla
Uji i pijshëm	I lartë
Përdorimi sipas industrive	Përdorim i lartë
Potencial për *hotspot*-et e ndotjes	I lartë
Numri i Zonave të Mbrojtura	10
Rëndësia e mbulesës pyjore	Shumë e rëndësishme
Përdorime të tjera	Transport lumor/peshkim
Rrezik nga thatësira	I ulët
Rrezik nga përmbytjet	I lartë
Demografia	
Numri i banorëve (Regj. i popullsisë 2011)	461,721

3.2 "Corine" dhe Mbulesa e Tokës

"Corine" që do të thotë "koordinimi i informacionit mbi mjedisin" është një inventar i mbulimit të tokës ndarë në 44 klasa dhe paraqitet si një produkt kartografik, në një shkallë prej 1:100 000. Kjo bazë të dhënash është operacionale në shumicën e zonave të Evropës dhe përdoret nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

Informacioni mbi Corine, përdoret për të vendosur bazën e klasave të mbulesës së tokës, e cila ndihmon për të minimizuar ndikimet ndaj aktivitetit ekonomik për shkak të zbatimit të planit pa rënë ndesh me objektivat e DKU-së. Ky informacion gjithashtu ofron një bazë për vlerësimin e dëmit potencial të peizazheve të përcaktuara si rezultat i zbatimit të Planit, domethënë i rëndësishëm për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Programit të Masave të PMBU. Mbulesa tokësore Korinë për Basenin Ujor Drin–Bunë është paraqitur në Figurën 3.2.

[8] Strategjia MIBU (draft) për Shqipërinë. Nëntor 2016.
[9] Banka Botërore, 2012. Inventari i burimeve të ujërave nëntokësore.
[10] Tremujori i parë i 2018-ës, informacion i siguruar nga AKBN-ja.



Figura 3.2: Mbulesa e Tokës në Basenin Ujor Drin–Bunë[11]

3.3 Efektet klimatike

Me bregdetin e saj përballë deteve Adriatik dhe Jon, malësitë e vendosura në territoret e larta Ballkanike të shtrirë në gjerësi në të gjithë vendin, duke bërë që t'i nënshtrohet një sërë modelesh të motit gjatë stinëve të dimrit dhe të verës, Shqipëria ka një numër të madh rajonesh klimatike për një zonë kaq të vogël gjeografike. Ultësira bregdetare ka një mot tipik mesdhetar; zonat malore kanë një klimë mesdhetare kontinentale. Në të dyja zonat e ulëta dhe të brendshme, moti ndryshon dukshëm nga veriu në jug. Ekzistojnë dy faktorë kryesorë që krijojnë ndryshueshmërinë në klimë: lartësia mbi nivelin e detit dhe distanca nga deti.

Në përgjithësi, reshjet zvogëlohen nga perëndimi në lindje. Vlerat më të larta gjenden pranë Mesdheut në perëndim, më të ulëtat në male. Dëbora është e zakonshme në male, më pak në pjesët më të ulëta të vendit. Hartat në Figurën 3.3 tregojnë reshjet mesatare vjetore. Zona më e lagësht në ujëmbledhësin Drin–Bunë është mbi liqenin e Shkodrës me reshje vjetore mbi 1600 mm në vit. Pjesët më të thata të basenit janë në verilindje dhe në lindje.

Harta në të djathtë në Figurën 3.3 tregon temperaturën mesatare vjetore. Në këtë rast zonat më të nxehta janë rreth Liqenit të Shkodrës dhe zonat bregdetare në jug.

[11] http://land.copernicus.eu/



Reshjet mesatare vjetore (mm/vit) **Temperatura mesatare vjetore (°C)**

Figura 3.3: Profilet e reshjeve dhe temperaturës në Basenin Ujor Drin–Bunë[12]

Figura 3.4 tregon reshjet mesatare mujore në Kukës në basenin e Drinit. Kjo shifër tregon natyrën sezonale të reshjeve me Qershorin, Korrikun dhe Gushtin si muajt më të thatë; që është dhe periudha më e rëndësishme për rritjen e kulturave bujqësore. Gjithashtu tregon se katër muajt më të lagësht janë nga Tetori deri në Janar. Në lartësi më të mëdha, shumica e reshjeve në muajt e dimrit është në formën e borës që shkrihet vetëm kur rritet temperatura në pranverë.

Evapotranspimi potencial (PET) në Basenin Ujor Drin–Bunë është treguar në Figurën 3.5. Shkalla potenciale e avullimit përfaqëson sasinë e avullimit, e cila mund të ndodhë nëse toka do të ishte e lagur gjatë gjithë vitit. Në realitet, reshjet e ulëta në verë do të thotë që tokat bëhen shumë të thata për avullim dhe normat aktuale të avullimit janë më pak. Në këtë rast shkalla më e lartë e evapotranspirimit është në bregdet dhe normat më të ulëta në verilindje. Harta në të djathtë të Figurës 3.5 tregon kërkesën e ujitjes të shprehur në mm në vit. Kjo është shuma PET (nevoja për ujë) minus reshjet për muajt kur PET është më e lartë se reshjet. Kjo tregon se në zonat bregdetare, ku reshjet dhe PET kanë vlera të ngjashme, kërkesa për ujitje është në një nivel të lartë prej 600 mm në vit. Kjo është për shkak të faktit se shumica e reshjeve është në dimër kur PET është i ulët.

[12] Përgatitur nga *Mott MacDonald.*



Figura 3.4: Reshjet mesatare mujore në Kukës në Basenin Ujor Drin–Bunë[13]





Evapotranspirimi potencial mesatar vjetor (mm/vit) **Kërkesa mesatare vjetore për ujitje (mm/vit)**

Figura 3.5: Evapotranspirimi potencial mesatar vjetor dhe kërkesa mesatare vjetore për ujitje në Basenin Ujor Drin–Bunë[14]

[13] Përgatitur nga *Mott MacDonald.*

3.4 Prurja lumore

Pellgu hidrografik i Drinit ka një sipërfaqe totale prej 19,582 km^2 nga të cilat 14,173 km^2 i takojnë Drinit dhe 5,187 km^2 lumit Bunë. Drini formohet nga dy degët kryesore: Drini i Zi, me një sipërfaqe ujëmbledhësi prej 5,885 km^2, që rrjedh nga Maqedonia dhe Drini i Bardhë, nga Kosova.

Lumi Bunë rrjedh nga Liqeni i Shkodrës, i cili ushqehet nga lumenj me origjinë nga Mali i Zi dhe Shqipëria; dega më e madhe e tij është lumi Moraça. Në kohë të niveleve të ulëta në Liqenin e Shkodrës rrjedha e lumit Bunë mund të kthehet në drejtimin e kundërt.

Në të kaluarën, daljet e lumenjve Bunë dhe Drin kanë qenë të ndara. Aktualisht shtrati i vjetër i Drinit, që drejtohet në jug të qytetit të Lezhës, mbart vetëm një pjesë të vogël të shkarkimit; pjesa tjetër takon Bunën pranë Shkodrës dhe ndjek shtratin e saj përgjatë kufirit me Malin e Zi.

Lumi Drin për periudhën 1951–1985 ka një prurje shkarkuese mesatare vjetore prej 680 m^3/s, nga të cilat 360 m^3/s vijnë nga vetë Drini dhe 320 m^3/s nga Buna. Norma e rrjedhës sipërfaqësore rezulton të jetë rreth 35 l/s.km^2 dhe koeficienti i shkarkimit 0.74. Këto vlera të larta janë kryesisht për shkak të rendimentit shumë të lartë të Bunës, të cilat nuk mund të shfrytëzohen shumë përveç lundrimit. Duke pasur parasysh përdorimin e ujit në Shqipëri, lumi më i rëndësishëm është Drini.

Figura 3.6 tregon prurjen mujore të lumit Drin në rrjedhën e sipërme të bashkimit me Bunën. Një tipar interesant i modelit të prurjes është se flukset në Prill dhe Maj janë më të larta se ato të Janarit dhe Shkurtit, ndërsa me reshjet është e kundërta. Arsyeja për këtë është se pjesa më e madhe e reshjeve në dimër në male bie si borë dhe bëhet prurje vetëm në fund të pranverës. Dëbora e malit është, në fakt, një rezervuar, i cili kontribuon me ujë në fillim të sezonit të ujitjes. Ka të ngjarë që me ndryshimet klimatike dhe temperaturat më të larta, do të ketë më pak borë në dimër dhe modeli sezonal i prurjes së lumit do të ketë më shumë ngjashmëri me modelin e reshjeve.



Figura 3.6: Prurja mesatare mujore në lumin e Drinit në rrjedhën e sipërme të bashkimit me lumin Bunë[15]

[14] Përgatitur nga *Mott MacDonald.*
[15] Përgatitur nga *Mott MacDonald.*

3.5 Burimet ujore të Basenit Ujor Drin–Bunë

Ky seksion përmbledh rezultatet e një modeli të kalibruar të burimeve ujore të Basenit Drin–Bunë.

Modeli është zhvilluar në softuerin e modelimit të Baseneve Ujore Mike Hydro, i cili simulon një ekuilibër të ujit të basenit duke përdorur një rrjet nyjash lidhëse. Inputet e prurjeve në basen (duke përfshirë shkrirjen e borës) janë përllogaritur si funksion i reshjeve, avullimit dhe temperaturës duke përdorur modelin prurje-reshje NAM. Elementet e nyjave në Basenin Mike Hydro përfshijnë rezervuarët dhe liqenet, ku ruhen ujërat, hidrocentralet dhe elementet e përdorimit të tij, të cilat përfaqësojnë vendet ku uji nxirret për përdorim ujitje, familjar ose industrial. Reagimet ndërmjet ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë simulohen duke përdorur modelin e thjeshtuar linear me dy shtresa të ujërave nëntokësorë. Bazuar në elementet e nyjave, baseni është përvijuar i ndarë në nën basene, të cilat janë njësitë e thjeshtuara për simulimin e proceseve të reshje-prurje dhe prurjeve të ujërave nëntokësorë.

Të dhënat e modelit përfshijnë të dhënat meteorologjike, si dhe të dhënat e kalibrimit. Të gjitha inputet meteorologjike janë marrë nga grupet e të dhënave globale. Të dhënat e kalibrimit, të cilat janë marrë nga një përzierje e grupeve të të dhënave vendore dhe globale, përfshijnë seri kohore të shkarkimit të lumenjve, nivelet e rezervuarëve dhe informacionin për prodhimin e hidrocentraleve.

Aktivitetet antropogjene që ndikojnë në balancën e ujërave të basenit përfshijnë ujitjen, prodhimin hidroenergjitik, përdorimet familjare dhe industriale. Aktivitetet e ujitjes përfshijnë ruajtjen e prurjeve sezonale në rezervuarët e vegjël të ujitjes, si dhe devijimin e rrjedhave të lumenjve për ujitje. Rezervuarët e ujitjes dhe përdorimi i ujit për ujitje janë trajtuar në nivelin e nënbasenit për të zvogëluar kompleksitetin e modelit. Prodhimi hidroenergjitik ndodh në tre rezervuarët kryesorë të kaskadës së Drinit. Përdorimet familjare dhe industriale supozohet të jenë të barabarta me prodhimin e ujit të raportuar nga ndërmarrjet e furnizimit me ujë.

Modeli është kalibruar duke përshtatur parametrat e modelit reshje-prurje, rregullat e operimit të rezervuarëve dhe parametrat e ujërave nëntokësorë. Kalibrimi i prurjeve hyrëse në kaskadën e Drinit, siç matet në Rezervuarin e Fierzës, është i arsyeshëm. Megjithatë, kalibrimi i hyrjeve të simuluara lokale në rezervuarët e Komanit dhe Vaut të Dejës duhet të rishqyrtohet nëse ka më shumë të dhëna në dispozicion, si për sa u përket sasisë dhe cilësisë së të dhënave ashtu dhe për kalibrimin.

3.5.1 Sistemi i modelimit dhe elementet e tij bazë

Modeli i Basenit Mike Hydro për basenin Drin–Bunë është përgatitur për të vlerësuar balancën midis furnizimit me ujë dhe kërkesës në kushtet e tashme dhe të ardhshme. Për shkak se kushtet e ardhshme mund të përfshijnë ndikimet e ndryshimeve klimatike, është zhvilluar gjithashtu një model i reshjeve-prurjeve duke përdorur softuerin simulues NAM. Modeli reshje-prurje NAM përdoret për të vlerësuar se si ndryshimet në reshje dhe evapotranspiracioni mund të ndikojnë në furnizimin me ujë dhe kërkesën për ujë.

Modeli i Basenit Mike Hydro përbëhet nga elemente që përdoren për të karakterizuar basenet, lumenjtë, vendet e përdorimit të ujit, rrjetin e transportit, rezervuarët dhe objektet e hidrocentraleve. Në ujëmbledhësit ku impaktet njerëzore në rrjedhat ujore nëntokësore mund të jenë të rëndësishme, modeli përfshin gjithashtu një model të thjeshtuar të ujërave nëntokësorë që vlerëson ndikimin e aktiviteteve të përdorimit të ujit në rrjedhat bazë të ujërave nëntokësorë në sistemin e lumenjve.

3.5.1.1 Pellgjet ujorë/basenet

Ujëmbledhësit paraqiten në Basenin Mike Hydro si elemente të poligoneve hapësinore. Ujëmbledhësit janë njësitë që prodhojnë rrjedha dhe gjithashtu përfaqësojnë shtrirjen hapësinore të trupave ujorë nëntokësorë në pellgjet ujëmbledhëse ku modeli i ujërave nëntokësorë Mike Hydro është aktiv.

Prurja e gjeneruar në çdo ujëmbledhës simulohet duke përdorur modelin reshje-prurje NAM. Modeli simulon prurjen hyrëse në sistemin e lumenjve në formën e prurjeve sipërfaqësore nga shiu dhe shkrirja e borës, si dhe kontributet e prurjes bazë nga shkarkimi i ujërave nëntokësorë. Modeli parametrohet në bazë të grumbullimit të basenit, me përjashtim të modulit të shkrirjes së borës.

Nëse modeli i ujërave nëntokësorë i Basenit Mike Hydro përdoret në një pellg ujëmbledhës,

sistemi i ujërave nëntokësorë përfaqësohet duke përdorur një model rezervuari linear me dy shtresa. Modeli me dy shtresa përbëhet nga një shtresë e cekët dhe një shtresë e thellë. Konstantet e kohës përdoren për të kontrolluar shkarkimet e rrjedhës bazë nga të dyja shtresat në sistemin e lumenjve, si nga shtresa e cekët në shtresën e thellë. Rimbushja e ujërave nëntokësorë gjithashtu vlerësohet nga modeli NAM. Sistemi i ujitjes dhe humbjet në funksionimin e tij janë gjithashtu të përfshira në modelin e ujërave nëntokësorë.

3.5.1.2 Lumenjtë dhe kanalet transportuese

Sistemi i lumenjve paraqitet si një rrjet kanalesh që marrin prurje nga basenet e tyre, si dhe rrjedhat që kthehen nga vendet e përdorimit të ujit. Prurjet kalojnë përmes rrjetit të lumenjve duke përdorur parametrat e vonesës që përafrojnë kohën e udhëtimit nëpër basen. Në zonat ujëmbledhëse ku sistemet ujore nëntokësore aluviale janë të rëndësishme, shkarkimet e fluksit bazë të ujërave nëntokësore gjithashtu japin një kontribut të rëndësishëm në prurjet e lumenjve.

Rrjeti i lumenjve është i lidhur me vendndodhjen e përdorimit të ujit duke përdorur kanalet e komunikimit, të cilat përcjellin ujërat sipërfaqësore në vendet e përdorimit të ujit dhe gjithashtu përcjellin rrjedhat e kthimit nga vendet e përdorimit të ujit përsëri në sistemin e lumenjve.

Rezervuarët dhe liqenet paraqiten si nyja magazinimi ku rrjedhat e lumenjve mund të ruhen ose të devijohen. Për të përcaktuar lëshimet e ujit të rezervuarit në funksion të ruajtjes përdoren rregullat e funksionimit.

Kërkesat minimale të rrjedhës (rrjedha ekologjike) gjithashtu paraqiten si nyja në rrjetin e lumenjve ku duhet të ruhen prurjet minimale. Këto kërkesa kanë përparësi mbi ruajtjen dhe përdorimin e ujit.

3.5.1.3 Rregullimi i prurjeve dhe përdorimi i ujit

Vendet e përdorimit të ujit përfaqësohen në model si nyja ku uji është nxjerrë nga kanalet e lumenjve ose ujërat nëntokësore. Një pjesë e ujit të tërhequr kthehet në sistemin e lumit si prurje kthimi.

Nyjat e përdorimit të ujit përdoren për të përfaqësuar përdorimet në sektorët e mëposhtëm: furnizimi shtëpiak (përfshirë industrinë), ujitja dhe hidroenergjia. Përdorimi i ujit brenda çdo sektori përfaqësohet si vijon:

- Përdorimi i ujit shtëpiak/industrial përfaqësohet duke përdorur seri kohore të kërkesës mujore. Ne supozojmë një vend ndodhje ujore për çdo kompani shërbimi të furnizimit me ujë. Përdoruesit e ujit shtëpiak/industrial përdorin ujëra të nxjerra nga ujërat nëntokësore, sistemi i lumenjve, ose një kombinim i të dyjave. Ne supozojmë se një pjesë konstante e ujit të shpërndarë në zonat e banuara/industriale kthehet në sistemin e lumenjve si prurje kthimi. Ne, gjithashtu, supozojmë se një pjesë e ujit të nxjerrë humbet për shkak të humbjeve të sistemit të shpërndarjes.

- Përdorimi i ujit të ujitjes paraqitet gjithashtu duke përdorur seri kohore të kërkesës mujore. Ne supozojmë një përdorues të ujit për ujitje në secilin ujëmbledhës, ku secili përfaqëson kërkesën e integruar për ujitje brenda atij baseni. Përdoruesit e ujit për ujitje përdorin vetëm ujëra të nxjerra nga sistemi i lumenjve. Ne supozojmë se një pjesë konstante e ujit të dhënë/përdorur në vendet e ujitjes kthehet në sistemin e lumenjve si prurje kthimi. Ne, gjithashtu, supozojmë se një pjesë e ujit të nxjerrë nga sistemi i lumit humbet për shkak të transportit dhe humbjeve të filtrimeve.

- Të tria hidrocentralet e mëdha në kaskadën e Drinit janë të përfaqësuar në model. Nuk janë të përfaqësuara hidrocentrale të vegjël.

Për shkak se nuk ka informacion mbi përdorimin e ujit për pjesët e basenit jashtë Shqipërisë, modelimi i këtyre pjesëve të basenit është i kufizuar në modelimin e reshjeve-prurjeve.

3.5.2 Shtrirja e modelit

Pellgjet ujëmbledhëse dhe lumenjtë në basenin Drin–Bunë janë përvijuar duke përdorur një Modeli Digjital të Ngritjes (DEM) me një rezolucion hapësinor prej 90m x 90m. DEM është marrë nga NASA Shuttle Radar Topography Mission (SRTM).

Zona bregdetare pranë grykës së lumit drenohet artificialisht dhe furnizohet me ujë të devijuar nga lumi Drin, dhe këtu zgjidhja e modelit të aplikuar SRTM nuk mjafton për përvijimin e tij. Për të përfshirë këto zona në model, kufiri i modelit është shtrirë në jug dhe përfshin rrafshinat bregdetare deri në derdhjen e kanalit më jugor të devijimit nga Drini, i cili derdhet në det pranë Lezhës.

Baseni Drin–Bunë merr prurje hyrëse nga dy basene fqinje. Përgjatë kufirit verior, një hidrocentral pranë Nikshiqit në Mal të Zi zhvendos

ujë në basenin e Bunës. Në ujëmbledhësin më jugor Liqeni i Ohrit raportohet të marrë shkarkimin nëntokësor nga Liqeni i Prespës. Devijimi në Mal të Zi nuk është përfshirë në model për shkak të mungesës së informacionit sasior mbi këto flukse. Edhe pse informacioni sasior nuk është i disponueshëm për shkarkimin nga Liqeni i Prespës, është bërë një supozim për këtë prurje, për shkak të rëndësisë së saj në bilancin e ujit në basen.

3.5.3 Përvijimi i nën baseneve

Bazuar në modelin Mike Hydro, baseni Drin–Bunë është ndarë në 13 nën pellgje ujëmbledhëse. Dhjetë ndodhen në zonat malore që shkarkojnë në rezervuarët e kaskadës së Rezervuarit të Drinit, dy pellgje ujëmbledhëse ndodhen në basenin e Bunës në rrjedhën e sipërme të Liqenit të Shkodrës dhe pjesa tjetër e nen baseneve mbulon pjesën më të ulët të basenit në Shqipëri në rrjedhën e poshtme të Rezervuarit të Vaut të Dejës dhe Liqenit të Shkodrës.

Vendndodhjet e shkarkimeve të nën baseneve të përdorura për përvijimin janë përzgjedhur në bazë të kritereve të mëposhtme:

- Vlerësimi i furnizimit me ujë në vendndodhje të veçanta.
- Disponueshmëria e të dhënave të fluksit të prurjeve për kalibrimin e modelit.
- Ndarjen e ujëmbledhësve më të mëdhenj në ato më të vogla për të përmirësuar përfaqësimin e variacioneve hapësinore - veçanërisht për reshjet.

Përvijimi i nën basenit balancon disponueshmërinë e të dhënave hidrologjike për kalibrimin me një analizim të duhur të balancave ujore të pjesëve të ndryshme të basenit. Harta e ujëmbledhësve është paraqitur në figurën 3.7. Arsyetimi i qartë për përcaktimin e secilit prej ujëmbledhësve jepet në tabelën 3.3.



Figura 3.7: Ujëmbledhësit e Basenit Ujor Drin–Bunë

Tabela 3.3: Përshkrimi i nënbaseneve në Basenin Ujor Drin–Bunë

Nën baseni Nr.[16]	Arsyeja për Përvijim
1	Përfaqësimi i Liqenit të Ohrit me kufizimet e diktuara nga DEM
2	Zona e digave, marrje për hidrocentralin
3	Nënndarja e basenit më të madh
4	Nënndarja e ujëmbledhësit më të madh dhe të dhënat e prurjes në stacionin e Drinit të Zi tek Ura e Dodës
5	Nënndarja e stacionit të prurjeve në Klinë, Kosovë
6	Nënndarja e pellgut më të madh
7	Prurja hyrëse nga Kosova, Stacioni i prurjeve Vermice
8	Derdhja e rezervuarit të Fierzës
9	Derdhja e rezervuarit të Komanit
10	Pellgu në rrjedhën e poshtme të Liqenit të Shkodrës dhe rezervuarit të Vaut të Dejës qe marrin ujë nga Drini, Buna dhe degë më të vogla.
12	Derdhja e rezervuarit të Vaut të Dejës
17	Nënndarja e pellgut më të madh. Kanali i prurjes kryesore në Liqenin e Shkodrës (Lumi Moraca)
20	Derdhja e liqenit të Shkodrës

13 zonat ujëmbledhëse arrijnë një ekuilibër të arsyeshëm midis disponueshmërisë së të dhënave, kufizimeve të burimeve të projektit dhe nivelit të detajimit, për vlerësimin e ekuilibrit të arsyeshëm të ujit në pjesë të ndryshme të basenit.

3.5.4 Bilanci i Ujit

Përcaktimi i bilancit të ujit është një hap i parë i rëndësishëm drejt zhvillimit të një strategjie të integruar të menaxhimit të burimeve ujore. Në thelb, bilanci i ujit përcakton burimet ujore në dispozicion, përdorimin e ujit dhe atë që mbetet në dispozicion për përdorime alternative. Llogaritja e bilancit të ujit bazohet në dokumentin[17] "Dokumenti udhëzues për zbatimin e bilancit të ujit për mbështetjen e zbatimit të DKU-së" (Raporti Teknik: 2015-090). Ky është udhëzimi zyrtar mbi Bilancin e Ujërave i përcaktuar nga Komisioni Evropian.

Burimet ujore në dispozicion janë ato nga uji sipërfaqësor (lumenjtë) dhe akuiferet (ujërat nëntokësore). Në rastin e Basenit Ujor Drin–Bunë burimet e ujërave sipërfaqësorë nga rrjedha brenda vendit rritet me prurjet hyrëse nga vendet fqinje.

Tre përdorimet kryesore të ujit klasifikohen si bujqësia, industria dhe uji i pijshëm. Në rastin e bujqësisë, përdorimi kryesor është për ujitje. Natyrisht ka edhe përdorime të tjera bujqësore, të tilla si uji i pijshëm për kafshët dhe akuakultura, por këto janë shumë të vogla në krahasim me ujitjen. Një situatë e ngjashme ekziston në lidhje me industrinë. Përdorimi industrial i ujit është shumë i ulët në Basenin Ujor Drin–Bunë dhe klasifikohet si "ujë me shishe" etj.[18] Ka gjithashtu disa përdorime për industrinë nga ujërat nëntokësore. Nxjerrja e klasifikuar si 'ujë i pijshëm' përfshin të gjitha nxjerrjet për qëllim pirje urbane/rurale. Përdorimi i katërt i ujit, prurjet e mjedisit, nuk është plotësisht i kuantifikuar dhe nuk është përfshirë në Tabelën 3.4. Kjo është vendosur sipas Ligjit që përfaqëson prurjen që natyrshëm do të ndodhte në 355 ditë të vitit. Rëndësia e saj, sidomos kur kërkesat rriten dhe burimet zvogëlohen nga ndryshimet klimatike tashmë njihet.

Edhe pse duket e drejtpërdrejtë, është e rëndësishme që bilanci i ujit të njohë karakteristikat specifike të llojeve të ndryshme të përdorimit të tij. Një shembull shumë i qartë për këtë është krahasimi i ujitjes dhe hidroenergjisë. Kur uji përdoret për ujitje pjesa më e madhe e tij avullon dhe shumë pak kthehet në lumenj ose ujëra nëntokësorë për përdorim të mëtejshëm. Megjithëse dihet se jo të gjithë ujërat që devijohen për ujitje mbërrijnë në fusha. Kur uji përdoret për hidroenergji pothuajse i gjithë uji që hyn në një rezervuar kalon përmes turbinave për të gjeneruar energji elektrike. Për këtë arsye dokumenti i

[16] Numrat e ujëmbledhwsve jepen sipas modelit DHI Mike Hydro, që përdoret në stërvitjet e trajnimit të palëve të interesit.
[17] "Dokumenti udhëzues për zbatimin e bilanceve të ujit për mbështetjen e zbatimit të UF (Raporti Teknik - 2015 - 090).
[18] Regjistri Kombëtar për Lejen e Përdorimit të Burimeve Ujore, Ministria e Mjedisit, 2014.

udhëzimit të BE-së për bilancin e ujit tregon qartë se hidrocentralet nuk janë të përfshira në llogaritjen e bilancit të ujit, pra "nxjerrja e ujit për prodhimin e hidroenergjisë (përdorimi në vend) duhet të përjashtohet nga përfshirja në ekuacionin e bilancit të ujit". Për hidroenergjinë, përdorimi bruto është i lartë, por përdorimi neto është i vogël; për ujitjen, vlen e kundërta. Konsiderata të ngjashme zbatohen për ujin e pijshëm publik, ku një pjesë nga uji i nxjerrë kthehet nëpërmjet rrjedhjes në ujërat nëntokësore ose pas trajtimit në një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura në një lumë. Aktualisht, ekziston një humbje e madhe në sistemin e shpërndarjes ose nga rrjedhjet ose lidhjet pa matës; në të ardhmen, këto humbje do të kontrollohen dhe prodhimi për ujë të pijshëm do të reduktohet edhe pse sasia e furnizuar do të rritet.

Përveç sa më sipër, ekziston edhe një ndryshim në rëndësinë e llojeve të ndryshme të burimeve ujore. Për shembull, shumica e ujit të pijshëm vjen nga burimet e ujërave nëntokësorë.

Tabela 3.4: Bilanci i Ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë

Reshjet (mm/vit)				1,205[19]
Baseni hidrografik në Shqipëri (km²)				6,887
Baseni hidrografik total (km²)				19,582[20]
Burimet Ujore (10^9 m³/vit)		**Aktuale**		**2027[21]**
Shkarkimet brenda Shqipërisë		7.12		6.72
Shkarkimet nga jashtë Shqipërisë		7.92		7.17
Uji total sipërfaqësor		**15.04**		**13.89**
Nga i cili nëntokësor		6.11		5.70
Burimet totale të ujit të ripërtëritshme		**15.04**		**13.89**
Kërkesa për ujë (10^9 m³/vit)		**Aktuale**		**2027**
	Bruto	%[22]	Bruto	%
Uji i përdorur për bujqësi (përfshirë ujitjen)	0.07	46	0.34	2.44
Uji i përdorur në industri	0.00	0.0	0.00	0.0
Uji i përdorur për ujë të pijshëm	0.02	0.14	0.006	0.43
Kërkesa totale	**0.09**	**0.60**	**0.40**	**2.87**
Bilanci i ujit		**14.95**		**13.49**

[19] http://www.cru.uea.ac.uk/data.
[20] http://www.cru.uea.ac.uk/data.
Rrjedha e poshtme e lumit Kir është një lumë i përkohshëm gëlqeror me një shtrat lumi të ndryshueshëm dhe nënshtresë zhavorri/zalli (migrimi i kanaleve të lumenjve). Ky tip lumi është specifik për Shqipërinë dhe ka nevojë për përpjekje të veçanta për identifikimin e kushteve të referencës biologjike, si dhe për kalibrimin e metodave të vlerësimit biologjik. Rrjedha e poshtme e lumit Kir është një lumë gjarpërues dhe i gërshetuar me një rrezik serioz nga përmbytjet.

Më shumë të dhëna në terren janë të nevojshme për të vërtetuar rezultatin e VSHB për shkak të mungesës së kampionimit përfaqësues të makroinvertebrorëve. Kushtet e mundshme biologjike janë afër kushteve të referencës, pra pa presion ndotjeje. Komunitetet bentike makroinvertebrore zakonisht dëmtohen nga rrjedha vjetore e kanaleve të lumenjve, thatësirat dhe proceset e sedimentimit/erozionit. Indeksi VSHB tregon një status shumë të mirë (të dhëna shtesë janë të nevojshme për validimin e këtij statusi) dhe ndoshta është afër kushteve të referencës në këtë rast specifik.

Figura 7.5: Marrja e mostrave në një degë të lumit Kir

7.2.1.6 Lumi Drin (Lezhë)

Rrjedha e poshtme e lumit Drin (para grykëderdhjes) është një lum tipik 'i madh fushor' me nënshtresa të imta (baltë, llucë, rërë). Kushtet e veçanta të standardeve janë paraqitur për status të moderuar me disa ndikime toksike. Shpejtësia është shumë e ngadaltë në këtë shtrirje të shtratit lumor. Ky është krahu më i gjatë (dhe më i vogël) i Drinit (pas bashkimit në ultësirën e Shkodrës).

Vlera e Indeksit të VSHB është 55%, e cila barazohet me cilësinë e moderuar me ndikim potencial toksik në sediment.

Figura 7.6: Lumi Drin në Lezhë (5.5 km para grykëderdhjes në detin Adriatik)

7.2.1.7 Lumi Bunë (në rrjedhën e poshtme të Liqenit të Shkodrës, Pranë Urës së Vjetër)

Lumi Bunë (pas Liqenit të Shkodrës) është një rast specifik i një 'lumi të madh fushor'. Vlera VSHB mund të rritet nëse marrja e mostrave është më e mirë (niveli më i ulët i ujit), por nevojiten më shumë të dhëna në terren. Vlera e indeksit VSHB është 55%, e cila paraqet një status të moderuar.

Figura 7.7: Lumi Bunë pranë liqenit të Shkodrës

7.2.1.8 Lumi Bunë (seksioni i poshtëm)

Ky lum fushor (specifik për lumin Bunë), identifikohet si lumë me nënshtresa zhavorri dhe ranore. Vlera e VSHB mund të rritet nëse marrja e mostrave kryhet gjatë një niveli më të ulët të ujit. Më shumë të dhëna në terren janë të nevojshme për të vërtetuar rezultatin e VSHB. Indeksi VSHB tregon një status të moderuar (50%).

Figura 7.8: Rrjedha e poshtme e lumit Bunë

7.2.1.9 Liqeni i Shkodrës (në Shirokë, në afërsi të derdhjes së liqenit)

Vlerësimi biologjik mund të identifikohet si status i mirë ekologjik për këtë ekosistem specifik të liqenit sipas një qasjeje të gjykimit të ekspertëve. Vlerësimi VSHB nuk është përshtatur ende me kushtet e liqenit dhe prandaj nuk është i aplikueshëm. Është një liqen shumë i madh fushor (lloj specifik për Liqenin e Shkodrës). Një sistem i veçantë VSHB për liqenet duhet të përshtatet për kushtet e liqenit të Shkodrës në të ardhmen.

7.3 Përfundimet në lidhje me statusin e cilësisë së ujit sipërfaqësor në Basenin Ujor Drin–Bunë

Rezultatet e përgjithshme të monitorimit NEPA dhe analizimi në terren i kryer në kuadër të Projektit tregojnë si në vijim:

- Cilësia e përgjithshme e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë tregon se ka një tendencë në rritje për shkarkimin e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe inputeve bujqësore në sistemin e lumenjve, duke përfshirë liqenet.

- Ndikimi më i lartë i ndotjes vërehet në degëzimin Drini-Lezhë, në seksionin e Drinit në Shkodër, dhe gjithashtu në Topojan, të cilat janë zonat më të populluara. Drini-Lezha mbetet pjesa më e ndotur e Basenit Ujor Drin–Bunë.

- Ndikimi i ndotjes është gjithashtu i lartë në liqenin e Prespës, Ohrit dhe Liqenin e Shkodrës, por ky ndikim mbetet sezonal. Muajt e verës ku numri i turistëve arriti kulmin në të tria liqenet rezulton në rritje të shtimit të algave, që është një tregues i mbingarkesës së lëndëve ushqyese në liqen për shkak të shkarkimit të ujërave të ndotura.

7.4 Vlerësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore

Baseni Ujor Drin–Bunë karakterizohet nga tri lloje kryesore të akuifereve: Kuaternar, Karbonatik dhe Magmatik. Një hartë e hollësishme e akuiferëve kryesorë në Basenin Ujor Drin–Bunë tregohet në Seksionin 3.6, Figura 3.8. Një vlerësim sasior i ujërave nëntokësore është dhënë gjithashtu në Seksionin 3.6.

7.4.1 Akuiferi kuaternar i Shkodrës

Akuiferi Kuaternar i Shkodrës monitorohet në Dobraç, Grudë-Fushë, Shtoj Vjetër dhe Kishën e Madhe (Shkodër) (Tabela 7.6).

Tabela 7.6: Stacionet/puset e monitorimit të ujërave nëntokësorë në akuiferin kuaternar të Basenit Ujor Drin–Bunë[136]

Nr.	Stacioni/puset e monitorimit të ujërave nëntokësore
1	Shkodër - Dobraç
2	Grudë, Fushë
3	Shtoj i Vjetër
4	Kisha e Madhe, Shkodër

Stacionet monitorojnë parametra të ndryshëm që përfshijnë nivelin dhe prurjen e ujit, pH-in, temperaturën, ashpërsinë totale, Na, lëndën e thatë, Ca, Mg, Fe, NH_4, Cl, SO_4, NO_3, NO_2 dhe O_2. Mikroelementet (nikel, magnez, mangan, zink, plumb, bakër, kobalt, krom dhe kadmium) monitorohen vetëm në Dobraç në Pusin 1. Çdo stacion monitorohet dy herë në vit (maj dhe tetor).

Cilësia e ujit të nxjerrë nga akuiferi kuaternar mund të përmblidhet si vijon:

- pH i ujërave nëntokësore është dobësisht alkalin, varion nga 7.28–8.03.
- Mineralizimi total në akuifer varion nga 140-326 mg/l. Ujërat mund të klasifikohen si ujëra të ëmbla. Në Dobraç, i cili furnizon Shkodrën, vlerat për mineralizimin total variojnë nga 296-360 mg/l. Mineralizimi i përgjithshëm në të gjithë monitorimin e rrjetit është brenda normës standarde të Shqipërisë.
- Për sa i përket ashpërsisë së përgjithshme, ky akuifer klasifikohet me ashpërsi mesatare për ujërat me ashpërsi të butë. Ashpërsia totale varion nga 4.42 - 11.42 Fp.°gj.
- Përmbajtja e hekurit varion në vlerë prej 0.01–0.17 mg/l. Përmbajtja gjatë viteve nuk ka tendencë të rritet ndjeshëm.
- Përmbajtja e NH_4 e akuiferit varion nga 0.01–0.11 mg/l. Përmbajtja e amoniakut në shumicën e analizave nuk është e pranishme.
- Përmbajtja mesatare e NO_3 varion nga 0.72–8.33 mg/l.
- Përqindja mesatare e NO_2 ndryshon 0.002–3.6 mg/l. Përmbajtja e nitrit ndryshon në mënyrë sporadike rreth vlerave 0.05 mg/l dhe shpesh mbi standardet e rekomanduara.
- Cilësia e ujit të akuiferit mund të klasifikohet si "e mirë".

Tabela 7.7: Parametrat e monitoruar në ujërat nëntokësore

Nr.	Parametrat e monitoruar në ujërat nëntokësore (mg/l përveç nëse thuhet ndryshe)	Parametrat e legjislacionit shqiptar	Parametrat e legjislacionit të BE-së[137]
1	Matja e prurjeve (l/s)		
2	Ion hidrogjen (njësi pH)	6.5-9.5	6.5-8.5
3	Temperatura (^{O}C)	8-20	12-25
4	Ashpërsia totale (Fp.° gj)	10-25	>60
5	Mineralizimi	1,200	

[136] Burimi: AKM, 2015; Përgatitur nga: Mott MacDonald.

[137] Standardi i Cilësisë për Ujin e Pijshëm është vendosur me VKM-në nr. 379, datë 25.5.2016. Ky vendim transpozon Direktivën 98/83/EC.

6	Natrium (Na)	20-200	20-150
7	Kalium (K)	10-12.0	
8	Kalcium (Ca)	75-200	100
9	Magnez (Mg)	20-50	30-50
10	Hekur (Fe)	0.2-0.3	0.05-0.2
11	Amon (NH_4)	0.05-0.5	0.05-0.5
12	Klor (Cl)		25
13	Sulfat (SO_4)		25-250
14	Nitrat (NO_3)	25-50	25-50
15	Nitrit (NO_2)	0.5	<0.1
16	Niveli i oksigjenit (O_2)		
17	Metale të rënda (Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd)		
18	Mbetje të thata	500-1000	1500

Akuiferi i Shkodrës u monitorua edhe për metalet e rënda në Dobraç në vitin 2015, siç tregohet në Tabelën 7.8. Rezultatet tregojnë praninë e Zn dhe Pb në akuifer në nivele që tejkalojnë SCM për ujë të pijshëm, duke treguar infiltrimin e mundshëm të ujërave industriale në akuifer ose mbithithjen nga puset e ligjshme dhe ilegale, të cilat gjithashtu mund të çojnë në ndotje. Në fakt, studimet e fundit kanë treguar se akuiferi është i ndjeshëm ndaj ndotjes nga inputet bujqësore të përdorura në zonat aty pranë për shkak të shtresës së hollë të mbrojtjes ndërmjet sipërfaqes dhe akuiferit, veçanërisht në Dobraç. Ndotja e akuiferit gjithashtu mund të shkaktohet nga tërheqja intensive e ujit nga qyteti ose për përdorime të tjera.

Tabela 7.8: Akuiferi i Shkodrës: rezultatet e monitorimit të metaleve të rënda në Dobraç, 2015[138]

Parametri	Përqendrimet e vëzhguara (µ/l)	SCM (µ/l)
Ni	6	20
Mn	13	50
Zn	5	3
Pb	11	10
Cu	2	50
Co	8	2
Cr	1	50
Cd	1	5

[138] Burimi: AKM, 2015; Përgatitur nga: Mott MacDonald.

7.4.2 Akuiferi karbonatik

Cilësia e ujit të nxjerrë nga akuiferi karbonatik mund të përmblidhet si vijon:

- Mineralizimi total në ujësjellës varion nga 142-280 mg/l. Ujërat e këtij akuiferi janë ujëra të ëmbla.
- Ashpërsia totale varion nga 4.42-10.01 Fp. ° gj në Gurra e Kolesjanit, Kukës, Tushemit, Lin Pogradec, Syri i Sheganit, burimet e Shkodrës. Ashpërsia është brenda standardit shqiptar.
- pH i ujërave nëntokësore është dobësisht alkalin, me një gamë prej 7.4-7.69.
- Përmbajtja e Ca, Na, K, Mg, Cl, SO_4 dhe solidet e tretura plotësisht janë të gjitha brenda standardeve shqiptare dhe të BE-së.
- Nivelet e NH_4, NO_3 dhe NO_2 janë brenda standardeve të kërkuara për ujë të pijshëm.
- Cilësia e ujit të akuiferit karbonatik klasifikohet si "shumë i mirë".

7.4.3 Akuiferi magmatik

Për këtë akuifer, e vetmja zonë me interes për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore shtrihet në masivin e Krrabit ku ka burime me një shkarkesë prej 5-25 l/s.

- Ujërat klasifikohen si ujëra të ëmbla me një mineralizim prej 250-350 mg/l.
- Uji i këtij akuiferi klasifikohet si ujë i butë me një gamë të ashpërsisë totale që varion nga 8-10 Fp ° gj. Ashpërsia është brenda standardit shqiptar.
- pH i ujërave nëntokësore është dobësisht alkalin, me një gamë prej 7.5-8.0.
- Ujërat nuk përmbajnë NH_4, NO_3 ose NO_2.
- Cilësia e ujit të akuiferit magmatik klasifikohet si "shumë i mirë".

8. Infrastruktura e ujit

8.1 Hyrje

Një çështje kyçe në DKU është futja e një sistemi të planifikimit të menaxhimit të basenit ujor. Ky do të jetë mekanizmi kyç për sigurimin e menaxhimit të integruar të lumenjve, kanaleve, ujërave nëntokësore, trupave ujorë të modifikuar, liqeneve, rezervuarëve, si dhe ujërave tranzitore dhe bregdetare.

Ky seksion jep informacion mbi statusin dhe planifikimin e menaxhimit të ujit dhe infrastrukturës në Basenin Ujor Drin–Bunë, i cili përfshin furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të ndotura, digat e ujitjes dhe hidrocentralet.

8.2 Furnizimi me Ujë dhe Trajtimi i Ujërave të Ndotura

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të qarta drejt menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Sektori i shërbimeve të furnizimit me ujë, mbledhja e mbetjeve, deponimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura është një nga sektorët me rëndësi dhe ndjeshmëri të veçantë, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve.

Në vitin 2014, Qeveria Shqiptare filloi të zbatojë një nga reformat më të rëndësishme në administratën lokale për të përmirësuar qeverisjen lokale dhe për të rritur efikasitetin (ligji nr. 115/2014, "Për territorin e ri administrativ të autoriteteve vendore në Republikën e Shqipërisë"). Reforma administrative riorganizoi 373 njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) në 61 NJQV (Bashki). Qëllimi kryesor i reformës është rritja e llogaridhënies duke transferuar detyrimet dhe të drejtat e shërbimit te niveli i qeverisjes vendore. Bashkimi i NJQV-ve ishte i nevojshëm për të arritur një shkallë të mjaftueshme organizimi, të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Qeveria ka propozuar ofrimin e shërbimit të sektorit aktual të ujit nga NJQV-të e sapokrijuara në mënyrë të tillë që një NJQV të ketë vetëm një ndërmarrje Ujësjellës dhe Kanalizime, e cila është përgjegjëse për shërbimet e ujit dhe kanalizimit në të gjithë territorin e NJQV-së. Kjo kërkon:

- Një rritje të lehtë në numrin e shërbimeve nga 58 të licencuara (që mbulonin 80% të territorit me shërbimin e furnizimit me ujë dhe 45% me shërbimin e kanalizimeve) në 61 në nivel kombëtar (përgjegjës për mbulimin e të gjithë territorit me të dyja shërbimet).
- Rishikimi i zonave të shërbimeve do të përputhë atë me kufijtë administrative të NJQV-ve të krijuara rishtazi. Pra, shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime të çdo qyteti mund të ketë më shumë se një rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimeve nga organizimi i mëparshme, duke ofruar shërbime në zona të ndryshme të qytetit.

Në përgjithësi, ofrimi i mëparshëm i shërbimit të menaxhimit ishte një shërbim i dobët me një kosto të ulët. Në këtë basen vetëm Ndërmarrja e Pogradecit ofron furnizim me ujë afër 24 orë në ditë. Jashtë zonave të mëparshme të shërbimit ekzistuese në të ashtuquajturat " zona jashtë juridiksionit", shërbimi është siguruar nga sistemet komunale dhe ka informacion të kufizuar në

dispozicion për cilësinë dhe sasinë e ujit në përdorim. Si pjesë e reformës së qeverisjes vendore këto "zona jashtë juridiksionit" do të bëhen përgjegjësi e Shërbimeve të reja të Njësive të Qeverisjes Vendore.

Figura 8.1 tregon përqindjen e popullsisë së shërbyer me ujësjellës për secilën pjesë të Bashkisë së Basenit Ujor. Një tabelë përmbledhëse e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime për secilën bashki është dhënë në Ekonominë e Përdorimit të Ujit - Seksioni 11.5, Figura 11.12.



Figura 8.1: Popullsia e shërbyer me furnizim me ujë për çdo qytet në Basenin Ujor Drin–Bunë[139]

[139] Masterplani i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për Shqipërinë, financuar nga KfW; iC, igr – Janar 2013..

- Shkalla e popullsisë së mbuluar me shërbime varion nga 35% për Bashkinë Pukë në 100% për Peshkopinë dhe Kukësin. Por edhe pse shërbimi mund të mbulojë të gjitha zonat, koha ditore e shërbimeve është në shumicën e rasteve më pak se 24 orë. Arsyeja e shërbimeve të kufizuara është e ndryshme nga një qytet në tjetrin, por keqmenaxhimi dhe humbjet e ujit janë faktorët kryesor.

- Me zbatimin së fundmi të Vendimit 342 nga maji i vitit 2016 i Këshillit të Ministrave[140], lidhur me kufijtë e bashkive dhe inventarizimin e infrastrukturës, vendndodhjet e objekteve infrastrukturore në secilin basen ujëmbledhës do të përditësohen në përputhje me to për shpërndarjen e aseteve në secilën bashki. Ky proces duhej të përfundohej më 31 dhjetor 2016. Procesi i transferimit të aseteve tek administrata e re e pushtetit lokal të shërbimeve të licencuara, të cilat do të jetë përgjegjëse për të gjithë territorin e NJQV-së, është ende në vazhdim.

- Në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", çdo NJQV e sapo formuar duhet të udhëheqë procesin e vlerësimit dhe regjistrimit të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e tyre. Pas vlerësimit dhe regjistrimit, NJQV-ve u kërkohet të transferojnë asetet dhe procesin e administrimit dhe përgjegjësinë për të ofruar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në ndërmarrjet e tyre përkatëse. Pas përfundimit të këtij procesi, ndërmarrja do të duhet të aplikojë për licencë të re në mënyrë që të përfshijë të gjithë zonën e shërbimit të zgjeruar. Shërbimet komunale gjithashtu duhet të përgatisin një plan biznesi me qëllim që të harmonizojnë në kohën e duhur standardet e shërbimit dhe tarifat e shërbimeve.

- Sipas informacioneve të marra nga Enti Rregullator i Ujit për vitin 2016, vetëm 8 ndërmarrje kanë marrë licencat e tyre për shërbime, siç tregohet dhe pjesa tjetër janë në proces të plotësimit të kërkesave ligjore.

Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën është përgjegjëse për sektorin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në planifikimin e fondeve të investimeve nga buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Për planifikimin e investimeve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, u hartua një Masterplan Kombëtar (financuar nga KfW) dheu miratua në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Ujit (Dhjetor 2015). Në kuadër të reformave të sektorit të ujit, kryetari i Bashkisë (ose Kryetarët në qoftë se ndërmarrja është në pronësi dhe që i shërben më shumë se një Bashkie) do të ketë autoritet më të madh mbikëqyrës për menaxhimin e ndërmarrjes.

Plani i tranzicionit për sektorin e shërbimeve të furnizimit me ujë, grumbullimin, deponimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura planifikohet të përparojë si vijon:

- Ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të përafrohet përgjatë vijave administrative territoriale bazuar në Reformën Administrative të Territorit (RAT).

- Të gjitha shërbimet do të sigurohen nga ndërmarrjet e formuara si shoqëri aksionare në pronësi publike, të cilat ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

- Drejtori i Përgjithshëm i ndërmarrjes punëson Drejtorin Teknik dhe Drejtorin Tregtar të Ndërmarrjes.

- Kryetari shërben si asamble e aksionarëve dhe është Kryetari i Asamblesë.

Në vitin 2016, me VKM-në nr. 504, datë 6.7.2016, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve është ngritur Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK). Ky institucion është një organ shtetëror i specializuar në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ajo vepron duke i mbështetur teknikisht politikat e Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën përgjegjëse për infrastrukturën ujore, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe politikat përkatëse për menaxhimin e ujit dhe mbrojtjen mjedisore të cilësisë së ujit.

AKUK-ja përmbush objektivat e saj si pjesë e organizimit të saj brenda strukturës përmes Drejtorisë Teknike, Departamentit të Tregtisë, Departamentit të Projekteve të Huaja, Drejtorisë

[140] VKM nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimie e ujërave të ndotura".

së Monitorimit dhe tri departamenteve rajonale. Brenda autoritetit të saj ligjor dhe teknik, AKUK-ja koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale, duke ofruar shërbime për furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal.

Në Basenin Ujor Drin–Bunë historikisht ka pasur 43 shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Megjithatë, pas reformës vetëm 12 shërbime ujësjellës-kanalizime do të licencohen, d.m.th.: Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Peshkopi, Bulqizë (pjesërisht), Librazhd (pjesërisht) dhe Pogradec (pjesërisht).

Figura 8.2 tregon kapacitetin e burimit ujor dhe ujit të prodhuar në çdo qytet. Jashtë zonave të mëparshme të shërbimit ekzistues në të ashtuquajturat " zona jashtë juridiksionit", shërbimi është siguruar nga sistemet komunale dhe ka informacion të kufizuar në dispozicion për cilësinë dhe sasitë e ujit të përdorur.



Figura 8.2: Kapaciteti i ujit dhe përdorimi i tij në çdo bashki të Basenit Ujor Drin–Bunë[141]

Kërkesa për uji është llogaritur për popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të kompanive të ujërave bazuar në normën ditore të kërkesës për frymë prej 150 litrash, me një reduktim prej 20% të humbjeve të ujit. Kjo është një konsideratë mesatare edhe pse ekzistojnë dallime mes ndërmarrjeve. Është e rëndësishme të theksohet se aktualisht humbjet e ujit janë shumë të larta në shumicën e ndërmarrjeve.

Përveç masave të sigurisë të zbatuara në burimet ujore, të gjitha ndërmarrjet e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë përdorin trajtimin e klorinimit për të eliminuar kontaminimin nga mikroorganizmat. Siguria e furnizimit, sipas kërkesave të VKM-së nr. 379, datë 25.5.2016, duhet të monitorohet nga një kontroll i brendshëm nga ujësjellësi, dhe kontroll të jashtëm nga ana e strukturave rajonale të shëndetit publik. Ministri përgjegjës për shëndetin përcakton mjetet e domosdoshme dhe frekuencën e kontrolleve nga strukturat rajonale të shëndetit publik dhe gjithashtu metodologjinë e nevojshme dhe frekuencën e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Shumica e testeve bëhen për mbetjet e klorit në pika të ndryshme të përdorimit dhe për bakteret fekale koliforme. Zbatimi i kërkesave ligjore të kësaj rregulloreje kontrollohet nëpërmjet kujdesit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Burimi i ujit për qëllim të ujit të pijshëm merret kryesisht nga ujërat nëntokësore.

[141] Burimi: Strategjia e Financimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit në Shqipëri (COWI).

Në vitin 2015, përqindja e ujit të ofruar për qytetet në Basenin Ujor duke përdorur stacionin e pompimit dhe gravitetin ishte përkatësisht 56% dhe 44%, siç tregohet në Figurën 8.3. Të dhënat tregojnë se ka 6 qytete që përdorin më shumë se 90% ujë të pijshëm nga stacioni i pompimit, pra një tarifë më e lartë e ujit në raport me qytetet e tjera ku përqindja e përdorimit të ujit të pijshëm me gravitet është më e lartë.



Figura 8.3: Përqindja e furnizimit me ujë të siguruar nga stacionet e pompimit dhe graviteti në çdo qytet të Basenit Ujor Drin–Bunë[142]

Përqindja e lartë e familjeve që përdorin stacionin e pompimit për prodhimin e ujit të pijshëm ndikon drejtpërsëdrejti në kostot e shërbimit të furnizimit me ujë për qytetet përkatëse, duke krijuar vështirësi për të arritur përqindje të arsyeshme në mbledhjen e të ardhurave dhe në të njëjtën kohë kosto shtesë dhe vështirësi në mirëmbajtjen e pajisjeve dhe vetë sistemit.

Vendndodhja e pikave kryesore të furnizimit me ujë në Basenin Ujor Drin–Bunë është dhënë në figurën 8.4. Një inventar i burimeve është paraqitur në figurën 8.5.

[142] Burimi: Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit.



Figura 8.4: Vendndodhja e pikave kryesore të furnizimit me ujë në Basenin Ujor Drin–Bunë



Figura 8.5: Vendndodhja e burimeve të njohura në Basenin Ujor Drin–Bunë

Në qytetet Has, Bulqizë, Tropojë dhe Vau i Dejës, rrjeti i ujërave të ndotura mungon plotësisht. Qytetet e tjera janë kryesisht të mbuluara nga rrjeti i kanalizimit, por ende zonat periferike nuk janë mbuluar me këtë shërbim. Në këtë gjendje, përdorimi i gropave septike është zgjidhja më e zakonshme. Figura 8.6 tregon numrin e lidhjeve me rrjetin e ujërave të ndotura në Basenin Ujor Drin–Bunë. Tabela 8.1 tregon statusin e infrastrukturës së ujërave të ndotura për Bashkitë kryesore në Basen.



Figura 8.6: Lidhjet me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura për qytetet në Basenin Ujor Drin–Bunë[143]

Tabela 8.1: Statusi i infrastrukturës së ujërave të ndotura për bashkitë kryesore në Basenin Ujor Drin–Bunë[144]

Qyteti	Popullsia me rrjet të ujërave të ndotura në %	Statusi i ITUN	Popullsia me ITUN në %
Pogradec	81%	Ekzistues	50,000 banorë në zonën e Bashkisë
Bulqizë	74%	Nuk ekziston	-
Peshkopi	93%	Nuk ekziston	-
Kukës	Vetëm bashkia		
Tropojë	95%		
Fushë-Arrëz	45%	Nuk ekziston	-
Has	80%		
Pukë	60% (6% fshat)		
Malësi e Madhe	66%	Nuk ekziston	-
Shkodër	100%	Propozuar	-
Lezhë	49%	Ekzistues	-
Vau i Dejës	44%		

Për sa u përket impianteve të trajtimit të ujit (ITU) në Basenin Ujor Drin–Bunë, me mbështetjen e donatorëve, janë ndërtuar katër impiante të trajtimit të ujërave të ndotura në Lezhë (Shëngjin), Pogradec, Velipojë dhe Shirokë pranë Liqenit të Shkodrës, me një kapacitet për të mbuluar popullsinë urbane ekzistuese të qytetit. Aktualisht, asnjë nga impiantet nuk është në kapacitet të plotë operimi. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se kostoja e tyre operacionale tejkalon kapacitetin aktual financiar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat ishin duke u përballur me një situatë sfiduese financiare, që para ndërtimit të ITU-ve. Këto ITU janë të pajisura me njësi trajtimi paraprake, primare dhe sekondare. Në qytetin e Shkodrës ekziston aktualisht një studim i fizibilitetit që po

[143] Burimi: Masterplani per Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet për Shqiperinë, financuar nga KfW; iC, igr – janar 2013.
[144] Burimi: Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit.

ndërmerret në lidhje me ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujit të pijshëm dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura për qytetin e Shkodrës, me një kosto kapitale të vlerësuar prej 25 mln euro[145].

Pajtueshmëria me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (TUNU) do të jetë komponenti më i kushtueshëm i PM-it, i cili përfshin masa për të trajtuar ndotjen organike dhe të lëndëve ushqyese, si dhe substancat e rrezikshme.

Zbatimi i direktivës TUNU do të kërkojë ndërtimin e objekteve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Basenin Ujor për të gjitha aglomerimet mbi 2,000 PE.

Qeveria ka vënë parimet e legjislacionit evropian të ujit si rikuperimi i kostos, menaxhimi i duhur i ujërave të ndotura dhe përdorimi efikas i burimeve natyrore, në thelb të Strategjisë, e cila synon zhvillimin e politikave të duhura dhe angazhimin e burimeve të mjaftueshme për të përmirësuar furnizimin me shërbime uji dhe kanalizimesh në Shqipëri, dhe lëvizjen vazhdimisht drejt pajtueshmërisë me standardet e BE-së. Një Masterplan kombëtar u përgatit me mbështetjen e KfW gjermane, i cili parashtroi dhe i dha përparësi nevojave për investime kapitale deri në vitin 2040 për sektorin që lidhet ngushtë me nivelin e tarifave, faturimin e ujit dhe ekzekutimin e faturave.

Tabela 8.2 më poshtë tregon nivelin e tarifave të ujit, të cilat janë shumë poshtë një niveli efikas dhe të qëndrueshëm. Për të korrigjuar këtë situatë, veprimet e ardhshme përfshijnë një program ambicioz të përmirësimeve të efikasitetit që përbëhen nga efikasiteti i zgjeruar në lidhje me përdorimin e energjisë, stafin dhe efikasitete të tjera operative, efikasitetin e grumbullimit dhe uljen e ujit të pafaturuar. Megjithatë, rekomandohet fuqishëm që tarifat të rriten në atë që është e përballueshme për familjen mesatare. Megjithëse, për të pranuar një rritje të çmimit të një shërbimi, konsumatorët dëshirojnë të përjetojnë një shërbim të përmirësuar, duke pranuar gjithashtu që shërbimi në fjalë të paguhet.

Në një nivel të tillë të tarifave, mund të financohet rreth gjysma e investimeve të nevojshme gjatë periudhës 25-vjeçare deri në 2040[146]. 50 përqindëshi i mbetur duhet të financohet me mbështetje në formën e huave dhe granteve për investime kapitale[147].

Aktualisht, ka shumë pak fonde komerciale në dispozicion për sektorin. Përvoja ndërkombëtare tregon se edhe me një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe institucional, financimi komercial i sektorit UK në Shqipëri (qoftë në formë të huave, koncesioneve apo PPP-ve të tjera) do të jetë i mundur vetëm nëse futen rritje të konsiderueshme të tarifave për të gjeneruar para për të mbështetur pagesat e borxheve.

Tabela 8.2: Tarifat e çmimit të ujit për çdo ujësjellës-kanalizime në Basenin Ujor Drin–Bunë[148]

Ndërmarrja	Uji i pijshëm lek/m³			Tarifa fikse lek/klienti/muaji			Për ujërat e ndotura		
	Familjare	Shtetërore	Private	Familjare	Shtetërore	Private	Familjare	Shtetërore	Private
Bulqizë	17	55	75	100	100	100			
Has	25	60	80						
Kukës	25	60	80				7	15	20
Lezhë	58	135	145	200	200	200	18	22	27
Pogradec	22/62	37/111	37/111	100/200	400/100	400/150	11/33	12/36	12/36
Peshkopi	27	65	85				10	15	15
Pukë	35	130	140	100	100	100	8	16	16
Shkodër	40	110	110	100	100	100	15	20	20
Tropojë	19	60	80						

[145] Burimi: Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë.
[146] Burimi: Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë.
[147] Për planifikimin e investimeve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, COWI 2016.
[148] Burimi: (ERRU) Report 2016.

Objektivat në strategjinë kombëtare vazhdojnë të jenë objektiva zyrtarë për sektorin dhe kanë formuar pikënisjen për përfituesit në formulimin e objektivave për një strategji financimi për sektorin e UK. Masterplani Kombëtar u përgatit me mbështetjen e KfW-së me supozimin se kërkesat e BE-së duhet të përmbushen në lidhje me Direktivën TUNU. Masterplani përcaktoi dhe prioritizoi investimet kapitale deri në vitin 2040 për sektorin, duke supozuar një lëvizje të qëndrueshme drejt përmbushjes së standardeve të BE-së.

Projektet u prioritizuan nga KfW duke përdorur një model vendimesh me shumë kritere: i. Teknike; ii. financiare/ekonomike; iii. Mjedisore; iv. Socioekonomike; dhe v. kriteret institucionale. Bazuar në prioritetet, u përcaktua një renditje në investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata (plani i investimeve)[149].

Qeveria e Shqipërisë mbështet një politikë të "ujit për të gjithë". Direktivat e BE-së kërkojnë që mjedisi të jetë plotësisht i mbrojtur nga ndotja nga ujërat e ndotura dhe, në veçanti, që ujërat e ndotura nga aglomerate me më shumë se 2.000 ekuivalentë të popullsisë (PE) të mblidhen dhe trajtohen.

Masterplani i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është i bazuar në një qasje nga poshtë-lart, ku shërbimet janë kërkuar për nevojat e tyre. Shërbimet komunale kanë llogaritur nevojat e tyre bazuar në supozimin se janë në gjendje të furnizojnë me ujë 24 orë në ditë për klientët e tyre dhe të jenë në gjendje të trajtojnë ujërat e ndotura në përputhje me rregulloret e BE-së.

Gjatë viteve të fundit, investimet në sektorin e ujit janë bazuar kryesisht në investimet e donatorëve. Figura 8.7 tregon nivelin aktual të fondeve të ndara për qytetet në Basenin Ujor Drin–Bunë ndërmjet 2012 dhe 2017. Investimet afatshkurtra për tetë projekte të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura në qytetet kryesore të Basenit Ujor Drin–Bunë, bazuar në masterplanin për Shqipërinë 2013, tregohen respektivisht në figurat 8.8 dhe 8.9.



Figura 8.7: Fondet e ndara në sektorin e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë ndërmjet 2012 dhe 2017[150]

[149] IC Consultant, 2013.

[150] Burimi: Mbështetje për ZKM-në në krijimin e një qasjeje të integruar dhe mekanizmave efektiv të SWG për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave në Raportin e sektorit të ujërave, (MOG).



Figura 8.8: Projektet e investimit për furnizimin me ujë në Basenin Ujor Drin–Bunë[151]



Figura 8.9: Projektet e ujërave të ndotura në Basenin Ujor Drin–Bunë[152]

8.3 Sektori i ujitjes

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore në Shqipëri është 695,000 ha, e cila mbulon 24% të vendit, 80% e të cilave është nën pronësi private dhe 20% është nën pronësi shtetërore[153]. Madhësia e fermës është mesatarisht 1.26 ha e ndarë në rreth 4 parcela bujqësore, që do të thotë se madhësia mesatare e fermës familjare është vetëm 0.27 ha. Kulturat kryesore janë perimet, pemët frutore dhe vreshtat, drithërat dhe ullishtet.

Bujqësia në Shqipëri kërkon ujë shtesë për ujitje në verë duke qenë se reshjet gjatë këtij sezoni janë vetëm rreth 20% e reshjeve totale vjetore. Deficitet e ujit ndërmjet Qershorit dhe Gushtit ndryshojnë

[151] Burimi: Master Plani per Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet per Shqiperine, financuar nga KfW; iC, igr – Janar 2013.
[152] Burimi: Masterplani per Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet per Shqipërinë, financuar nga KfW; iC, igr – Janar 2013.
[153] INSTAT, 2013. Tregu Shqiptar i Punës, Tiranë.

ndërmjet 400 dhe 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efektiv të bimëve. Nga ana tjetër, kullimi është i rëndësishëm në dimër, për të lehtësuar përmbytjet, erozionin etj.

Sistemi i konsiderueshëm i ujitjes dhe kullimit është shpërbërë për shkak të mungesës së investimeve së bashku me buxhetin e pamjaftueshëm për funksionimin dhe mirëmbajtjen. Për më tepër, privatizimi i tokës rezultoi në nivel kombëtar në krijimin e më shumë se 400,000 fermave të vogla (ndërmjet 0,5 dhe 3,0 ha). Këto ferma të vogla private e kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bujqësisë dhe kanë komplikuar shërbimet bujqësore duke përfshirë procesin e ujitjes. Kjo situatë reflektohet në mënyrë të ngjashme në basenin e lumit Drin–Bunë. Në përgjigje të kësaj, Qeveria Shqiptare miratoi një politikë për transferimin e përgjegjësive operacionale të kanaleve dytësore të ujitjes te përdoruesit e ujit, nëpërmjet krijimit të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (SHPU-ve). Operimi dhe mirëmbajtja e kanaleve primare dhe rezervuarëve të ujitjes mbetet përgjegjësi e ndërmarrjeve shtetërore të Ujit.

Përpjekjet për rehabilitimin dhe rindërtimin e sistemeve të ujitjes kanë vazhduar që nga mesi i viteve nëntëdhjetë. Megjithatë, SHPU-të nuk funksiononin siç pritej, pasi kapaciteti i tyre për ofrimin e shërbimeve të ujitjes ishte i pamjaftueshëm dhe SHPU-të nuk ishin në gjendje të mbulonin kostot e operimit dhe mirëmbajtjes. Me ristrukturimin e Ndërmarrjes së Ujit janë krijuar 13 Borde Kullimi.

Duke qenë se shërbimet e ujitjes dhe kullimit ndjenin ende nevojën për përmirësim, ishte e nevojshme përfshirja e Autoritetit Vendor (Bashkive dhe Komunave) në rolin thelbësor të vendimmarrjes lidhur me sistemet e ujitjes dhe kullimit, d.m.th. VKM-ja nr. 1108, datë 30.12.2015, "Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelit dhe aseteve nga Bordet Rajonale të Kullimit. Si e tillë, infrastruktura dytësore e ujitjes u transferua nga Bordet e Kullimit në Bashkitë. U krijuan katër borde të reja dhe të ristrukturuara rajonale të kullimit nga 13 të mëparshme në nivel kombëtar, të cilët, së bashku me MBZHR, administrojnë vetëm infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit, përfshirë digat e ujitjes. Baseni Ujor Drin–Bunë mbulohet kryesisht nga Bordi i Kullimit të Lezhës.

Kapaciteti i projektuar i rezervuarëve të ujitjes pas më shumë 40 viteve të jetës së tyre është zvogëluar rreth 50%, sipas të dhënave të marra nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Ka 115 diga ujitjeje në basenin ujor Drin–Bunë (Figura 8.10). Vendndodhja e digave të ujitjes paraqitet në Figurën 8.11. Megjithatë, për shkak të sedimentimit sasia totale e ujit për ujitje është përafërsisht 27.2 milionë m^3, me vëllimin përkatës të disponueshëm të ujit për ujitje siç tregohet në figurën 8.12.



Figura 8.10: Diga për ujitje për secilën bashki në Basenin Ujor Drin–Bunë[154]

[154] Burimi: Ministria përgjegjëse për vaditjen dhe kullimin.



Figura 8.11: Vendndodhja e digave kryesore të ujitjes në basenin e ujit Drin–Bunë



Figura 8.12: Sasia e ujit për ujitje (milion m^3) nga digat për secilën bashki në Basenin Ujor Drin–Bunë[155]

Në shkallën e basenit ujor, rreth 35% e tokës bujqësore është tokë e ujitur. Figura 8.13 më poshtë tregon situatën për secilën bashki në basenin ujor Drin–Bunë.



Figura 8.13: Tokë e ujitur dhe totali i tokës së punueshme për secilën bashki në basenin ujor Drin–Bunë[156]

[155] Burimi: Ministria përgjegjëse për vaditjen dhe kullimin.
[156] Burimi: Ministria përgjegjëse për vaditjen dhe kullimin.

Për shkak të zhvillimit të shpejtë të infrastrukturës gjatë dekadës së fundit, aktualisht vetëm një pjesë e tokës së punueshme tani mund të ujitet ose përdoret për prodhim bujqësor. Figura 8.13 se përqindja e tokës se ujitur varionte nga 10% –75% në basenin e ujit Drini-Bunë.

Burimet ujore të ujitjes janë rezervuarët e ujitjes, lumenjtë ose ujërat nëntokësore duke përdorur stacionet e pompimit, siç tregohet në figurën 8.14 më poshtë. Lloji i ujitjes është ose nga graviteti ose nga stacionet e pompimit, ose ndonjëherë kombinimi i të dyjave. Metoda kryesore e ujitjes në vend dhe në basenin ujor Drin–Bunë është vaditja me kanale të hapura ose ujitje me brazdë, e cila shpërndan ujë përmes një rrjeti dytësor dhe tretësor.



Figura 8.14: Burimi dhe tipi i ujitjes në secilën bashki në basenin ujor Drin–Bunë[157]

Përveç qyteteve të Bulqizës dhe Pukës, të cilat ujiten nga lumenjtë, qytetet e tjera përdorin diga të ujitjes për qëllime bujqësore. Është e nevojshme të theksohet fakti se në të dyja rastet mund të nevojitet përdorimi i stacionit të pompimit, kjo konsiderohet si metodë e kombinuar ose e përzier e ujitjes.

Bazuar në VKM Nr. 1108, më date 30.12.2015, "Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelit dhe aseteve nga Bordet Rajonale të Kullimit", rrjeti kryesor i ujitjes dhe kullimit, përfshirë digat e ujitjes, janë nën administrimin e Bordeve Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit. Pjesa më e madhe e territorit të Drin–Bunë është pjesë e BRK-së së Lezhës, e cila përfshin edhe një pjesë të zonave jashtë basenit Ujor Drin–Bunë.

Stacionet e Pompimit të Kullimit (hidrovoret) përdoren për qëllime drenazhimi, edhe pse shumë prej tyre janë aktualisht jashtë funksionit për shkak të dëmtimit, kostos së lartë të energjisë elektrike dhe mirëmbajtjes së dobët. Është vlerësuar se kanalet dytësore janë të mbushura me baltë dhe për pastrimin e tyre kërkohet mbështetje e konsiderueshme financiare. Kjo situatë krijon mbingopje të parcelave bujqësore dhe mundësi për përmbytje në kushtet atmosferike me reshje. Stacionet e pompimit të kullimit janë të shpërndarë në zonën bregdetare, dhe një pjesë e tyre tashmë janë në fund të jetëgjatësisë së tyre[158]. Në basenin ujor Drin–Bunë ka 9 stacione kulluese-pompimi, të shpërndara siç tregohet në figurën 8.15.

Një faktor kritik që shkakton problem në sektorin e bujqësisë është teprica e ujit nga përmbytjet, siç është rasti i basenit ujor Drin–Bunë, ku mangësitë në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit ndikojnë në prodhimin bujqësor duke kufizuar rritjen e kulturave apo shkatërrimin e bimëve.

[157] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
[158] MBZHR (2015), Draftstrategjia për ujitjen, kullimin, sigurinë e digave dhe mbrojtja nga përmbytjet në Shqipëri.

Shërbimi i kullimit mbulon pjesën më të madhe të tokës bujqësore, e ndërtuar kryesisht para viteve 1990. Në basenin ujor Drin–Bunë ka rreth 1.400 km kanale kryesore kulluese dhe rreth 60.000 ha me sistemin e rrjetit të kullimit, siç tregohet në figurën 8.16 dhe 8.17.



Figura 8.15: Numri i stacioneve të pompimit të kullimit (hidrovor) për qytetet e basenit ujor Drin–Bunë[159]



Figura 8.16: Gjatësia e përgjithshme dhe kanalet kryesore të ujitjes dhe kullimit në basenin ujor Drin–Bunë[160]

[159] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
[160] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.



Figura 8.17: Zona e rrjetit të kullimit në qytetet kryesore të Basenit Ujor Drin–Bunë[161]

Bazuar në burimet e ujit dhe gjendjen e ujit të llogaritur për basenin ujor Drin–Bunë (shihni më sipër seksionin 3.5.4, Tabela 3.4), është llogaritur se disponueshmëria e ujit në basenin ujor Drin–Bunë do të jetë më se e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e ujit për bujqësinë deri në vitin 2027.

Edhe pse disponueshmëria e ujit për prodhimin e ushqimit pritet të mbetet e mjaftueshme, masa duhet të merren në basenin ujor Drin–Bunë për të ulur vulnerabilitetin dhe për të rritur fleksibilitetin e bujqësisë. Këto masa kanë të bëjnë kryesisht me modernizimin e bujqësisë (miratimin e praktikave më të mira), përmirësimin e ujitjes dhe infrastrukturës së kullimit dhe futjen e metodave të reja të ujitjes (shihedhës/ujitje me pika).

Tabela 8.3 më poshtë tregon vendndodhjen dhe parametrat kryesorë të hidrovoreve në basenin ujor Drin–Bunë. Në total, ekzistojnë 8 hidrovore, shtatë prej të cilave janë në zonën bregdetare. Duke qenë në pjesën e poshtme të basenit dhe pas hidrocentralit Vau i Dejës, hidrovoret e Lezhës dhe Shkodrës luajnë rol të rëndësishëm në heqjen e ujërave sipërfaqësore, sidomos gjatë shirave intensivë ose pas shkarkimeve të HEC-it Vau i Dejës.

Tabela 8.3: Përmbledhje e të dhënave bazë të hidrovoreve në basenin ujor Drin–Bunë[162]

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit	Vendndodhja e Hidrovoreve	Zona e kullimit (ha)	Numri i pompave	Kapaciteti total i projektimit të kullimit PS (m^3/sec)	Energjia elektrike e Instaluar(kW)
Shkodër	Velipoj	1,800	5	14.05	860
	Ças	1,600	5	14.05	860
Nëntotal		3,400	10	28.10	1,720
Lezhë	Balldren	2,680	5	25.50	1,480
	Tale	4,777	7	22.35	1,555
	Ishull Shëngjin	640	4	3.60	320

[161]Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
[162] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit	Vendndodhja e Hidrovoreve	Zona e kullimit (ha)	Numri i pompave	Kapaciteti total i projektimit të kullimit PS (m^3/sec)	Energjia elektrike e Instaluar(kW)
	Grykë Zezë	550	4	3.90	420
	Gocaj	220	2	1.30	110
Nëntotal		8,867	22	56.65	3,885
Korçë (Pogradec)	Tushemisht	300	4	2.40	350
Total		12,567	26	87.15	5,955

Siç përmendet më lart, autoritetet lokale do të administrojnë rrjetin sekondar dhe tercial të sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe Bordet Rajonale mbeten përgjegjës për digat e ujitjes dhe rrjetin kryesor të ujitjes dhe kullimit. Figura 8.18 më poshtë tregon investimet në rrjetin e ujitjes dhe kullimit në basenin ujor Drin–Bunë gjatë 4 viteve të fundit.



Figura 8.18: Investimet e fundit në rrjetin e ujitjes dhe kullimit në basenin ujor Drin–Bunë[163]

Siç u tha më lart, zona e ulët e lumit Drin–Bunë është nën rrezikun e përmbytjeve. Tabela 8.4 më poshtë tregon statusin aktual të argjinaturave në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës dhe gjatësinë e argjinaturës në secilën prej tyre, të cilat kërkojnë rehabilitim për mbrojtjen e komunave dhe tokës bujqësore sidomos gjatë situatës së shiut të rëndë.

Tabela 8.4: Argjinaturat për mbrojtjen nga përmbytjet në basenin ujor Drin–Bunë[164]

Argjinaturë	Gjatësia e Argjinaturës (km)	Gjatësia e Argjinaturës që ka nevojë për rehabilitim (km)
Shkodër	48	4.3
Lezhë	112	50
Totali	**160**	**54.3**

[163] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
[164] Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

8.4 Hidrocentralet

Hidrocentralet janë burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ato ndodhen në të gjitha basenet ujore dhe përbëjnë 97% të prodhimit aktual të energjisë elektrike të vendit. Prodhimi i hidrocentraleve publike përfaqëson 72.1% të prodhimit të përgjithshëm vendas, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike në vitin 2014 ishte 27.9%. KESH sh.a., një kompani shtetërore, kontrollon prodhimin publik të hidrocentraleve. Aktualisht, prodhimi ndryshon ndërmjet afërsisht 2,900 gwh në vitet shumë të thata deri në gati 6,000 gwh në vitet me shumë rreshje[165].

Si pjesë e një përpjekjeje për të reformuar sektorin shqiptar të energjisë, ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, privatizoi katër hidrocentrale dhe i ka ndarë sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, ka futur një model të ri të tregut dhe ka dhënë koncesione për zhvillimin e hidrocentraleve të reja[166].

Në lumin Drin janë tri hidrocentrale të mëdha funksionale me një kapacitet total të instaluar prej 1350 mw, HEC "Vau i Dejës", HEC "Fierza" dhe HEC "Koman". Ndërkohë është nënshkruar një kontratë koncesionare për hidrocentralin "Ashta" në lumin Drin midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kompanisë austriake "Österreichische Elektrizitätsëirtschafts - Aktiengesellschaft", me një kapacitet të instaluar prej 48.2 MW (Tabela 8.5).

Tabela 8.5: Hidrocentralet më të mëdhenj në basenin ujor Drin–Bunë[167]

HEC	Kapaciteti (mw)	Prodhimi Vjetor (mwh)
"KESH" sha HEC "Fierze"	500	1,636,522
"KESH" sha HEC "Koman"	600	1,882,721
"KESH" sha HEC "V. i Dejës"	250	932,732
"Energji Ashta" sh.p.k. HEC "Ashta"	48.2	235,604
Totali	**1,398.2**	**4,687,579**

Sipas AKBN-së, në përfundim të tre-mujorit të parë të 2018, ekzistojnë 47 kontrata koncesioni për ndërtimin e 121 Hidrocentraleve të Vegjël (SHPP) në basenin ujor Drin–Bunë me një kapacitet të vlerësuar të instaluar prej përafërsisht 620 mw. 29 SHPP janë në funksionim.

Një hartë e hidrocentraleve aktualë operativë (> 1 mw) dhe hidrocentraleve të mëdha (> 250 mw) në basenin ujor Drin–Bunë jepet në figurën 8.19.

[165] Banka Botërore, 2009, Shkresë e diskutimeve të Bordit të Sektorit të Ujit Nr. 12: "Vlerësimi Mjedisor Strategjik: Përmirësimi iBurimeve Ujor, Qeverisja dhe Vendimmarrja, Washington.
[166] KFN, 2013, Historiku i Partneriteteve Private-Publike në Shqipëri Privatizimi i hidrocentraleve
[167] Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore – AKBN.



Figura 8.19: Vendndodhja e hidrocentraleve të vegjël më të rëndësishëm (> 1 mw) dhe të mëdhenj (> 250 mw) në basenin ujor Drin–Bunë

Mbështetja pothuajse ekskluzive në hidrocentrale për furnizimin me energji elektrike e bën vendin shumë të varur nga ndryshueshmëria hidrologjike vjetore. Gjatë sezoneve të thata hidroelektriciteti mund të bjerë me 40% nën mesataren afatgjatë të prodhimit (siç është përjetuar në vitin 2007) ose të rritet 60% mbi mesataren në një periudhë veçanërisht të lagësht (p.sh., 2010). Periudhat e thata kërkojnë import të energjisë elektrike nga vendet fqinje me kosto të lartë për të plotësuar ngarkesën e kërkesës së brendshme. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të kapaciteteve të shpërndarjes së energjisë elektrike, importet e energjisë elektrike nuk mund të plotësojnë plotësisht prodhimin vendor dhe operatori i sistemit është i detyruar të përdorë derdhjen e ngarkesës gjatë periudhave të kërkesës maksimale. Përkundrazi, viti jashtëzakonisht i lagësht i 2010 e shndërroi Shqipërinë në një eksportues të energjisë elektrike për herë të parë që nga viti 1997. Ndërlidhjet me sistemet fqinje të energjisë elektrike janë të një rëndësie të veçantë për sigurinë e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë për balancimin e ngarkesës ditore dhe asaj sezonale.

Statusi i HEC-ve në operim, në ndërtim ose kur ndërtimi ende nuk ka filluar është paraqitur në figurën 8.20.



Figura 8.20: Statusi i hidrocentraleve të vegjël me koncesion në Basenin Ujor Drin–Bunë në përfundim të tremujorit të parë të vitit 2018[168]

Sipas AKBN-së, në fund të tremujorit të parë të vitit 2018, 26 HEC-et të cilat nuk janë objekt koncesioni nuk ishin akoma në gjendje pune.

9. Menaxhimi i Përmbytjeve

9.1 Hyrje

Përmbytja e tokës është një dukuri e rregullt në Shqipëri. Ekzistojnë dy faktorë kryesorë, të cilët përcaktojnë llojin e përmbytjeve. E para është natyra sezonale e reshjeve. Dimrat kanë reshje të rënda, të cilat në male bien kryesisht si dëborë dhe verat janë shumë të thata. Rreth 80 deri 85% e reshjeve bien në muajt e dimrit. Ndonjëherë ndodhin përmbytje të cilat janë një kombinim i reshjeve të borës dhe shiut intensiv. Tipari i dytë është topografia e vendit. Malet në lindje çojnë në reshje të larta në këtë pjesë të vendit, lumenjtë janë kryesisht të shkurtër, dhe në perëndim pranë bregdetit territori është i sheshtë. Në pjesët e sipërme të baseneve ujore përmbytja është shumë e shpejtë dhe ndodh në një kohë shumë të shkurtër. Në të kundërt, në zonat e sheshta pranë bregut përmbytja mund të zgjasë për disa

[168] Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

javë. Rreth gjysma e popullsisë së Shqipërisë vlerësohet të jetojë në zona, të cilat janë të rrezikuara nga përmbytjet.

Në basenin ujor Drin–Bunë, janë tri diga të mëdha të ndërtuara kryesisht për hidrocentrale, të cilat kanë ndikim te përmbytjet. Ka gjithashtu 115 diga të vogla në basenin ujor, të ndërtuara për ujitje dhe kontroll të përmbytjeve, megjithatë shumë prej tyre kanë pasur pak mirëmbajtje në vitet e fundit dhe kapaciteti i tyre është zvogëluar nga vlerat e tyre fillestare.

Në basenin ujor Drin–Bunë është vlerësuar se në një përmbytje 1 herë në 100 vjet, do të prekeshin rreth 20,000 ndërtesa dhe 170,000 banorë.

Disa aktivitete njerëzore e kanë rritur rrezikun e përmbytjeve. Kjo përfshin nxjerrjen e zhavorrit nga lumenjtë dhe shpyllëzimin në zonat malore. Megjithëse të dyja këto aktivitete janë reduktuar vitet e fundit, ato ende kanë ndikim në përmbytjet.

9.1.1 Raporti fillestar i projektit

Pjesa e parë e seksionit të Raportit fillestar që ka të bëjë me përmbytjet është në thelb një përmbledhje e përmbajtjes së Direktivës për Përmbytjet të Bashkimit Evropian. Një përmbledhje më e gjerë e kësaj Direktive jepet në një pjesë të mëvonshme të këtij raporti. Marrëdhënia midis Direktivës për Përmbytjet dhe basenit ujor Drin–Bunë jepet në tabelën e riprodhuar më poshtë.

Tabela 9.1 Përmbajtja e pritshme e shpërndarjes siç parashikohet në Raportin Fillestar të Projektit

Komponenti i planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet	PMBU Drin–Bunë	Dokumente të konsultentit
(1) Vlerësimi i Parakohshëm i Rrezikut nga Përmbytjet		
PMBU do të përmbajë një përshkrim të përmbytjeve historike: lokacionet dhe frekuencën. Lidhja midis shkarkimeve të lumenjve bazuar në modelimin e të dy lumenjve me përmbytjet historike.	✓	Modeli i basenit Mike Hydro, të dhënat historike, gjykimi i ekspertëve
PMBU (zhvillimet e pritura lidhur me ndryshimet klimatike). Parashikimi i përgjithshëm i rritjes së frekuencës së përmbytjeve, bazuar në modelimin e shkarkimeve të lumenjve duke marrë parasysh ndryshimin e klimës.	✓	Modelimi i ndryshimeve klimatike, gjykimi i ekspertëve
(2) Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe Hartat e rrezikshmërisë së përmbytjeve		
"shpesh karakterizohet nga shpate të pjerrëta me vegjetacion të ulët, herë pas here me shtretër të ngushtë të lumenjve dhe basene relativisht të mëdhenj. Brezi jugor i bregut të Adriatikut (zakonisht në Shqipëri) përbëhet nga ultësira fluviale. Sipërfaqet e mëdha dhe variacionet ekstreme në terren dhe në rrjetin e lumit, nënkuptojnë që zona të mëdha në rajon, në një shkallë të ndryshme, janë të prirura për përmbytje."

Referuar historikut Organizativ, ato deklarojnë:

"Historiku Organizativ i menaxhimit të përmbytjeve në Shqipëri dhe struktura pasqyron kërkesat e DKU-së dhe DP-së. Megjithatë, funksionimi i organizatës është problematik për shkak të disa mbivendosjeve në përgjegjësitë. Për shembull, planifikimi i përdorimit të tokës është shqetësim i ministrive: Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Ministria e Mjedisit (MM) Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Brendshme (MB), si dhe prefekturat dhe komunat (nën MB). Instituti Hidrometeorologjik është i lidhur me Ministrinë e Arsimit dhe funksionimi i digave është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë. Fragmentimi i përgjegjësive çon në përdorim joefikas të burimeve dhe rënien e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit të menaxhimit të përmbytjeve."

Raporti përcaktoi një plan udhërrëfyes për zbatimin e DKU-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Pesë hapat e tij janë:

- Vendet duhet të zhvillojnë dhe miratojnë planin dhe programin e zbatimit të DP-së.
- Vendet duhet të përshpejtojnë transpozimin e legjislacionit të BE-së Përveç transpozimit të plotë të DP dhe DKU, duhet të zhvillohen akte nënligjore dhe dekrete të detajuara, aneksuar me planifikim të rinovuar, standarde të projektimit dhe ndërtimit. Këto duhet të jenë në përputhje me parametrat institucionalë specifikë për vendin dhe kuadrin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe duhet të marrin në konsideratë ndikimet e parashikueshme të ndryshimeve klimatike.
- Vendet duhet të ndërmarrin hapa për të përfshirë çështjet e menaxhimit të përmbytjeve në të gjitha procedurat e tjera sektoriale, siç janë urbanizimi, strehimi urban dhe rural, bujqësia ose menaxhimi i digave. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të tokës në zonat e përmbytjeve, menaxhimit të ujërave të ndotura dhe mbeturinave, si dhe ndryshimeve klimatike. Forcimi i zbatimit të legjislacionit është një çështje kyçe në përgjithësi, por edhe sa i përket përdorimit të tokës dhe çështjeve pronësore.
- Direktiva e përmbytjeve është një direktivë e butë dhe për këtë arsye është e domosdoshme që aktivitetet institucionale dhe të planifikimit të jenë në vend para zbatimit të saj. Zbatimi i Direktivës duhet të përshpejtohet dhe strukturat organizative duhet të rehabilitohen dhe të rafinohen dhe organizatat ekzistuese të menaxhimit duhet të përgatiten për zbatimin e Direktivës. Forcimi i strukturave organizative duhet të kryhet sa më shpejtë jetë e mundur.
- Përgatitja e vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet, vlerësimi i rrezikut nga përmbytjet

[186] Parandalimi i përmbytjes dhe analiza e mangësive të menaxhimit dhe vlerësimi i nevojave në kontekst të zbatimit të Direktivës së Përmbytjeve të BE-së. Shtator 2015. Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), Projekti i Infrastrukturës 4 (IPF 4).

dhe planet e menaxhimit të përmbytjeve janë pikat kryesore të DP.

Raporti veçon një numër projektesh të lidhura me përmbytjet për Shqipërinë. Këto përfshijnë mbrojtjen nga përmbytjet në basenin ujor Drin–Bunë në zonën e Shkodrës, që llogaritet të kushtojë €63,000,000.

Sa i përket strategjisë dhe institucioneve që kanë të bëjnë me menaxhimin e përmbytjeve, vlerësimi i tyre i përgjithshëm është që kërkesat themelore janë përmbushur por nevojitet detajimi i mëtejshëm i detyrave. Ata komentojnë se është ngritur kuadri institucional, me një bashkërendim të fuqishëm qendror nën zyrën e Kryeministrit. Ekziston një strategji kombëtare për menaxhimin e ujërave me kapitujt për menaxhimin e përmbytjeve.

Në kohën e shkrimit të raportit ata vlerësuan se kalimi në kuadrin ligjor në përputhje me Direktivën e Përmbytjeve zbatohet ose është në përgatitje e sipër. Ligji për Ujin ka kapituj mbi Menaxhimin e Përmbytjeve, por legjislacioni tjetër lidhur me përmbytjet është më pak i zhvilluar. Tabela e mëposhtme përmbledh statusin e zbatimit.

Tabela 9.8: Statusi i zbatimit të historikut institucional në lidhje me Direktivën e Përmbytjeve në Shqipëri

Hapat kryesorë në procesin e zbatimit	Në progres	Të zhvillohen
Kuadri ligjor	+	
Kuadri organizativ i efektshëm	+	
Sistemi i mjaftueshëm paralajmërues i hershëm		+
Sistemi i mjaftueshëm i monitorimit		+
Vlerësimi i Parakohshëm i Rrezikut nga përmbytjet		+
Hartat e Rrezikshmërisë nga Përmbytjet		+
Hartat e Rrezikut nga Përmbytjet		+
Planet e Menaxhimit të Përmbytjeve		+

Studimi më i fundit i publikuar i Statusit të Direktivës së Përmbytjeve ishte ai i referuar më lart. Ndërsa, në mënyrë specifike një analizë e mangësive tregoi se situata siç përshkruhet në raportet e mëparshme nuk ka përparuar dukshëm.

9.8 Ndryshimet klimatike

Ekzistojnë dy organe kryesore ndërkombëtare të lidhura me ndryshimet klimatike. Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC); ky organ u krijua në vitin 1992 në kuadër të Kombeve të Bashkuara. Organi i dytë është Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK), i themeluar në vitin 1988 nga dy Organizata të Kombeve të Bashkuara, Organizata Botërore Meteorologjike dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin. Funksioni i tij është të vlerësojë "informacionin shkencor, teknik dhe socio-ekonomik të rëndësishëm për të kuptuar rrezikun e ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njeriu.

Shkurtimisht, UNFCCC është organi që koordinon veprimet në nivel qeveritar për të luftuar ndikimin e ndryshimeve klimatike. Roli i PNNK-së është të vlerësojë informacionin shkencor, teknik dhe socio-ekonomik të rëndësishëm për të kuptuar rrezikun e ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njeriu dhe efektivitetin e masave për të luftuar rrezikun.

Brenda kontekstit të UNFCCC-së, vendet duhet të dorëzojnë Komunikatat Kombëtare. Këto përshkruajnë kontributin e vendit në ndryshimet klimatike dhe përgjigjen e tyre ndaj sfidave që paraqiten.

Një projekt dokument i UNDP lidhur me Komunikatën e Tretë Kombëtare përmbledh progresin në raportimin e ndryshimeve klimatike[187]. Shqipëria e paraqiti Komunikatën e saj Kombëtare Fillestare në vitin 2002. Kjo përfshinte një inventar të gazit serë dhe një përmbledhje të shtatë sektorëve kryesor ë të emetimit të gazrave serë: energjia, proceset industriale, bujqësia dhe blegtoria, ndryshimi i përdorimit të

[187] UNDP, Shteti: Shqipëria, Kontributi i tretë kombëtar në UNFCCC. Project Document. albania_tnc_prodoc_signed_and_dated-2.pdf

tokës dhe pylltaria, mbetjet, tretësit dhe përdorimi ndërkombëtar nga anijet dhe avionët. Komunikata e dytë Kombëtare u paraqit në 2009. Komunikata e tretë, dhe e fundit, kombëtare u paraqit në vitin 2016.

Komunikata e tretë kombëtare (KTK)[188] paraqet një inventar të përditësuar për gazrat serrë, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, si dhe burimet kryesore. Klima e Shqipërisë është e ndarë në katër zona: Zona fushore mesdhetare, zona kodrinore mesdhetare, zona mesdhetare para malore dhe zona malore mesdhetare. Studimi për KTK u përqendrua në zonën fushore të Mesdheut, e cila përfshin kryeqytetin, Tiranën dhe zonën bregdetare. Raporti arsyetoi zgjedhjen e zonës bregdetare, pasi një studim më i hershëm i UNDP-GEF për Drin–Bunën[189] e identifikoi deltën e këtij sistemi lumor si "kritikisht të pambrojtur".

Analiza e temperaturave të vërejtura sugjeroi se temperatura mesatare kishte rënë në periudhën 1971-2000 dhe pas kësaj ishte rritur. Në periudhën e mëvonshme, numri i ditëve me temperaturë më të lartë se 35°C ishte rritur gjithashtu. Ka dëshmi të rritjes së reshjeve si vjetore ashtu edhe të përditshme në vitet e fundit, por trendi është raportuar si më pak i qartë se sa për temperaturën. Raporti thekson se përmbytja është një formë e madhe e fatkeqësive natyrore e përjetuar në Shqipëri.

Skenarët e ndryshimeve klimatike të paraqitura bazohen në Raportin Special mbi Skenarët e Emetimeve (RSSE) siç paraqitet në Raportin e Katërt të Vlerësimit të PKKN-së të vitit 2007.

Tabela 9.9 tregon rritjen e parashikuar të temperaturës.

Tabela 9.9: Projeksionet e ndryshimit të temperaturës (° C) për horizonte të ndryshme kohore lidhur me vitin 1990 (modeli mesatar)

Vite	2030	2050	2080	2100
Vjetore	1.0 (0.7 deri 1.2)	1.7 (13 deri 2.2)	2.8 (2.0 deri 3.5)	3.2 (2.4 deri 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 deri 0.9)	1.2 (1.0 deri 1.4)	2.8 (1.7 deri 2.3)	2.4 (1.9 deri 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 deri 1.12)	1.5 (1.3 deri 1.8)	2.6 (2.2 deri 3.0)	3.1 (2.6 deri 3.6)
Verë	1.6 (0.5 deri 1.8)	2.5 (2.1 deri 2.8)	4.3 (3.8 deri 4.9)	5.3 (4.6 deri 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 deri 1.1)	1.6 (1.5 deri 1.8)	2.8 (2.7 deri 3.0)	3.5 (3.2 deri 3.7)

Ajo që është e rëndësishme është se rritjet më të mëdha priten gjatë verës. Një pasojë e kësaj do të jetë kërkesa për ujë për ujitje. Një pasojë e dytë do të jetë rritja e frekuencës dhe intensitetit të stuhive të verës. Rritja e temperaturës në pranverë do të ketë një ndikim në përmbytjet, pasi shumë vërshime janë kombinim i reshjeve dhe i borës.

Tabela 9.10 tregon ndryshimin e parashikuar të reshjeve, i cili zbulon në përgjithësi se reshjet pritet të ulen në të gjitha stinët gjatë shekullit të ardhshëm.

Tabela 9.10: Parashikimet e ndryshimeve të reshjeve (%) për horizonte të ndryshme kohore lidhur me vitin 1990

Vite	2030	2050	2080	2100
Vjetore	3.84 (-35.4 deri 27.7)	-8.46 (-56.0 deri 47.4)	-14.37 (-78.6 deri 81.1)	-18.13 (-89.7 deri 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 deri 4.0)	-10 (-27.9 deri 7.7)	-14.3 (-44.6 deri 16.1)	-18.1 (-55.8 deri 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 deri 7.0)	-7.26 (-25.3 deri 10.75)	-14.26 (-45.1 deri 16.6	-17.7 (-55.3 deri 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 deri -7.9)	-19.7 (-24.1 deri -15.3)	-41.9 (-49.2 deri -34.5)	-50.4 (-59.4 deri -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 deri 11.1)	-2.5 (-21.3 deri 16.3)	-6.9 (-38.1 deri 25.2)	-9.5 (-48.1 deri 29.1)

[188] Komunikata e tretë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, 2016.

[189] Përshtatja me Ndryshimet Klimatike në Deltën e lumit Drini Mati dhe më tej. Dokument i Politikës. MBZHR, 2013.

Të dhënat kombëtare gjithashtu paraqesin reshjet 24-orëshe për periudha të ndryshme të kthimit, por nuk e paraqesin këtë si një ndryshim në lidhje me kushtet aktuale. Megjithatë, theksojnë se "edhe pse numri i ngjarjeve ekstreme të reshjeve mund të pritet të rritet në aspektin e madhësisë dhe frekuencës, në përgjithësi nivelet e reduktuara të reshjeve do të çojnë gjithashtu në një rritje të numrit të ditëve të njëpasnjëshme pa reshje (thatësi)".

Një kufizim i Kontributit Kombëtar është që bazohet kryesisht në parashikimet e paraqitura në Raportin e Vlerësimit të vitit 2007. Raporti më i fundit i vlerësimit i PKKN-së u publikua në vitin 2013 dhe zëvendësoi skenarët e SRES me Shtigje Përqendrimi Përfaqësuese (RCP). Këto janë përmendur shkurtimisht në një shtojcë të Kontributit të Tretë Kombëtar.

Një analizë e kryer në kuadër të këtij projekti identifikoi katër modele klimatike si përfaqësues të rajonit të Ballkanit. Këto ishin:

- CNRM-CM5. Qendra Kombëtare për Hulumtime Meteorologjike, Francë
- EC-EARTH. Qendra Evropiane për Parashikimin e Motit të Mesëm
- HadGEM2-ES, Zyra Meteorologjike, Mbretëria e Bashkuar.
- MPI-ESM-MR, Max-Planck-Institut für Meteorologie, Gjermani.

Parashikimet e reshjeve u shkarkuan për të katër modelet. Analiza të mëtejshme të prodhimit të modeluar u përqendrua në reshjet dhe arriti në përfundimin se modeli CNRM e përfaqësonte më mirë atë, edhe pse jo dukshëm më i saktë se modelet e tjera.

Si pjesë e ushtrimit të përgjithshëm me përdorimin e modeleve klimatike të koordinuara nga PKKN, u krijua një studim i veçantë i Ekipit të Ekspertëve për Zbulimin dhe Indeksin e Ndryshimeve Klimatike (ETCCDI). Ky ekip nxori parashikime mbi ngjarjet ekstreme të motit nga modelet klimatike, prodhimi i të cilëve u përdor për të informuar raportin e vlerësimit të PKKN-së për vitin 2013. Ndër parametrat që ata analizuan ishin sasitë maksimale të reshjeve në çdo vit deri në 2100. Nga të katër modelet e përmendura më lart një prej tyre, EC-EARTH, nuk kontribuoi në këtë studim suplementar. Të dhënat për këtë parametër për tri modelet e mbetura u shkarkuan nga faqja e internetit Climate Explorer e Shërbimit Meteorologjik të Holandës.

Grafiku i mëposhtëm bazohet në qelizat e modelit, të cilat përafrohen me sipërfaqen e basenit ujor Drin–Bunë. Megjithatë, duke pasur parasysh se qelizat model zakonisht mbulojnë një sipërfaqe prej 100 * 50 atëherë ato përfaqësojnë një zonë që shpesh shtrihet përtej basenit.

Kolona e parë tregon ndryshimin e përqindjes në reshjet maksimale mesatare vjetore 2020 deri 2100 në krahasim me periudhën 1990-2020. Kolona e dytë tregon rritjen e reshjeve 1 në 25-vjeçare për periudhën. Kjo merr parasysh devijimin mesatar dhe standard.

Tabela 9.11: Modelimi i reshjeve në basenin ujor Drin–Bunë

Modeli	Baseni Ujor Drin–Bunë	
	Ndryshimi në reshjet maksimale mesatare ditore (%)	Ndryshimi në reshjet 1 në 25-vjeçare (%)
CNRM	3.9	21.3
HadGem	1.2	-7.0
MPI	6.6	9.2

Konkluzioni i parë është se përmbytja mesatare do të rritet paksa. Megjithatë, reshjet e furishme do

të jenë më të ndryshueshme dhe si pasojë disa vite do të kenë përmbytje më të vogla nga e kaluara, por të tjerët do të kenë përmbytje më të mëdha.

Duhet të theksohet se këto parashikime marrin parasysh vetëm ndikimin e ndryshimeve klimatike. Faktorë të tjerë, si për shembull shpyllëzimi ose urbanizimi në rritje do të kenë gjithashtu ndikim.

9.9 Masat e rekomanduara në Projekte të Mëparshme

9.9.1 Masat legjislative dhe institucionale

Analiza e ndryshimit e cila krahason situatën legjislative në lidhje me përmbytjet[132] në Shqipëri me kërkesat e Direktivës së Përmbytjeve të BE-së tregon se është bërë përparim i mirë. Megjithatë ka mangësi në lidhje me kuadrin institucional të kërkuar sipas Direktivës së Përmbytjeve.

9.9.2 Korniza efikase organizative

Struktura organizative e themeluar korrespondon me kërkesat e Direktivave. Megjithatë, ekziston ende nevoja për të forcuar organizatat e krijuara për të mundësuar që të përmbushin detyrimet e tyre. Kjo situatë nuk është një situatë që lidhet specifikisht vetëm me përmbytjet, por zbatohet në Direktivën e Ujit dhe direktivave të tjera që lidhen me menaxhimin e ujit. Përderisa struktura e propozuar përputhet me kërkesat e Direktivës së Ujit, mund të konsiderohet se ka shpërfillur disa aspekte specifike të hidrogjeologjisë dhe të hidrogeologjisë së Shqipërisë. Për shembull, një krahasim i gjashtë rajoneve të basenit të lumejve të propozuara në Shqipëri tregon se ato do të ishin të krahasueshme me rajonet më të vogla të baseneve në Bashkimin Evropian dhe një përdorim më i mirë i burimeve të pakta mund të kërkojë që shumë detyra të kryen në nivel kombëtar.

9.9.3 Sistemi i mjaftueshëm i monitorimit

Në raportet e analizuara për këtë pjesë të përmbytjeve nuk ka pothuajse asnjë informacion sasior mbi nivelet e ujit ose rrjedhjet e lumenjve në lidhje me përmbytjet e fundit. (Megjithëse një informacion i tillë është i disponueshëm për përmbytjet e viteve 1962 – 1963). Pa matje të tilla, është e vështirë të lidhen përshkrimet e përmbytjeve në raportet e mediave me një analizë sasiore të frekuencës së përmbytjeve. Kjo nga ana tjetër do të thotë që një analizë ekonomike e masave për të zvogëluar ndikimin e përmbytjeve nuk mund të përfundojë në një nivel saktësie të pranueshëm. Si prioritet, stacionet e matjes së nivelit të ujit duhet të instalohen në pikat kritike të sistemit të lumenjve kryesorë brenda Shqipërisë. Vendndodhja e përshtatshme do të përfshinte: në rrjedhën e sipërme të zonave të ulëta ose zonat e ujitjes, në degët kryesore, degët e zgjedhura dhe në rrjedhat e disa lumenjve. Një rrjet i tillë ka vepruar në të kaluarën dhe vendet e stacioneve të reja duhet të korrespondojnë, aty ku është e mundur, me vendet e stacioneve të mëparshme; Kjo do të mundësonte një analizë të ndikimit të ndryshimeve klimaterike ose të aktiviteteve njerëzore në basenet e ujore.

Stacionet e nivelit të ujit duhet të kalibrohen në mënyrë që ato gjithashtu të sigurojnë matje të rrjedhjes së lumit.

Aktualisht rrjeti meteorologjik është në varësi të Ministrisë së Arsimit. Pa marrë parasysh se cila ministri bëhet përgjegjëse për matjen e rrjedhjes, ajo duhet të punojë ngushtë me ata që veprojnë në rrjetin meteorologjik.

Derisa të krijohet një rrjet i përshtatshëm matës, nuk mund të vazhdojnë aktivitetet e tjera si parashikimi i përmbytjeve, planifikimi i burimeve ujore dhe vendosja e kritereve për cilësinë e ujit.

9.9.4 Sistemi i përshtatshëm i paralajmërimit të hershëm

Aktualisht paralajmërimi i përmbytjeve bazohet kryesisht në parashikimet e motit. Me përjashtim të sistemit Drin–Bunë, lumenjtë në Shqipëri janë rreth 100 km nga burimi deri në det dhe për shumicën e gjatësisë së tyre janë të pjerrëta. Kjo do të thotë se koha e plotë (koha mes fillimit të stuhisë deri në kulmin e një përmbytjeje) është në rendin prej 5–10 orësh. Si pasojë, një sistem i paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve do të kërkonte një rrjet të stacioneve klimaterike dhe të reshjeve, për llogaritjen paraprake të rrezikut potencial të përmbytjes në fillim të një stuhie dhe një rrjeti stacionesh monitorimi të nivelit të ujit, për të rritur saktësinë e parashikimit duke qenë se stuhia dhe përmbytjet përparojnë. Rrjeti do të kërkonte transmetim të shpejtë të të dhënave dhe një model matematikor për të prodhuar parashikime të niveleve. E gjithë kjo do të kërkonte një organizim institucional i cili do të kishte mjetet dhe autoritetin për të evakuuar njerëzit në rrezik ose të mbyllë rrugët e rrezikuara nga përmbytjet.

9.9.5 Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet

Raportet e përmbytjeve të kaluara në Shqipëri merren kryesisht nga burimet e mediave dhe japin pak detaje të kushteve meteorologjike që çojnë në përmbytje, shkallën e ngritjes së lumenjve dhe si përmbytja zhvendoset jashtë brigjeve të lumenjve në zonën e dëmtuar. Megjithatë, informacioni ekzistues i shoqëruar me anketat në terren të zonave të cilat njihen se preken, do të siguronte një bazë të vlefshme për një vlerësim fillestar të rrezikut të përmbytjeve. Kur njerëzit kanë hasur raste përmbytjeje, ata shpesh janë në gjendje të identifikojnë pikat specifike që ka arritur përmbytja.

9.9.6 Hartat e rrezikshmërisë së përmbytjeve

Hartat që tregojnë rrezikshmërinë e përmbytjeve janë përcaktuar si "harta për të treguar zonën gjeografike që mund të përmbytet" sipas skenarëve të ndryshëm' (Direktiva e Ujit, neni 6.3). Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet do të identifikonte zonat që janë përmbytur në të kaluarën. Ky informacion i shoqëruar me sondazhe topografike mund të mundësojë hartëzimin e hartave të përmbytjeve të kaluara.

Hartëzimi duhet të marrë parasysh karakteristikat specifike për çdo ujëmbledhës. Për shembull, digat e mëdha dhe modeli i tyre i mbushjes dhe çlirimit të ujit mund të ndryshojnë frekuencën dhe ashpërsinë e përmbytjeve. Disa prej digave të ujitjes njihen të jenë në kushte të këqija; Duhet të vlerësohet rreziku që i shkaktohet popullsisë nga dëmtimi i digës dhe pasojat e një thyerje të digës në zonat e rrjedhës.

Shumë zona rezidenciale dhe industriale kanë argjinaturë për mbrojtjen nga përmbytjet. Gjendja aktuale e këtyre strukturave duhet të analizohet.

Një vlerësim që mbulon pikat e sipërpërmendura do të ishte ende shumë paraprak. Sipas Direktivës, hartografia duhet të lidhë shkallën e përmbytjeve me frekuencat e njohura të përhapjes; pa të dhëna afatgjata të niveleve të ujit kjo nuk është e mundur.

9.9.7 Hartat e rrezikut nga përmbytjet

Hartat e rrezikut nga përmbytjet duhet të tregojnë "pasojat e mundshme negative të skenarëve të përmbytjeve të identifikuar në hartat e rrezikut nga përmbytjet" (Direktiva e Ujit, Neni 6.5). Sikurse me hartëzimin e rrezikut nga përmbytjet, një vlerësim fillestar mund të zhvillohet bazuar në përshkrimet e përmbytjeve të së kaluarës. Ky hartograf duhet të identifikojë vendndodhjet me vulnerabilitet të lartë, si spitalet, shkollat, rrugët kryesore, komplekset industriale etj. Për një hartë më të plotë do të nevojiten të dhëna hidrologjike dhe meteorologjike shtesë.

Një tjetër kufizim i mundshëm në përdorimin e të dhënave të përmbytjeve gjatë dekadave të fundit si një udhëzues është se nuk mund të merren parasysh ndryshimet në basenet e lumenjve. Për shembull, zonat e ndërtuara rishtazi, mund të çojnë në situate më të ndërlikuara, ose ndërtimi i një rruge të re mund të ndryshojë shtigjet e rrjedhës në rrafshin e përmbytjes. Kur të dhënat e rrjedhës kanë qenë të disponueshme për disa vite, atëherë, në të ardhmen, do të jetë e nevojshme të kalibrohet një model i detajuar hidraulik i lumit dhe zonave përreth të cilat janë përmbytur ose mund të përmbyten. Një model i tillë mund të përdorë si pikënisje modelin hidrologjik të Drin–Bunës dhe lumenjve të Drin–Bunës të zhvilluara si një komponent i këtij projekti.

9.10 Rekomandime specifike për basenin ujor Drin–Bunë

Një studim i madh i përmbytjeve në basenin e poshtëm të Drinit dhe Bunës u përfundua në vitin 2012[190]. Deri më sot, ky është studimi më i plotë, 224 faqe, i përmbytjeve në atë basen. Studimi e konsideron zonën si rrjedhë e poshtme e liqenit të Shkodrës në Bunë dhe në rrjedhën e poshtme të rezervuarit të Vau i Dejës në det. Ai përfshin zona me ujitje intensive dhe kanale të ndërlidhura.

Studimi është iniciuar pas përmbytjeve të mëdha të vitit 2010. Mjeti kryesor i përdorur ishte një model hidraulik i sistemit të lumenjve të kalibruar për të përfaqësuar zonat e përmbytura në vitin 2010. Është zhvilluar një model digjital i terrenit duke përdorur të dhëna nga batimetria e lumenjve, 1: 10.000 skedarë të konturuar skanuar të dhënat e hartave, të misionit të topografisë, të radarëve dhe sondazhe të tjera të argjinaturave, rrugëve dhe urave. Regjistrimi i rrjedhës së Drinit janë bazuar në shkarkimet nga rezervuari i Vau i Dejës. Shkarkimet nga liqeni i Shkodrës u bazuan në

[190] Një përmbytje gjithëpërfshirëse pas katastrofës: Studimi i vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit. Raporti Final - Plani për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për Basenin e Ulët të Drinit dhe Bunës, korrik 2012. Mott MacDonald, ish-Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile).

nivelet në dy matës: Bunë Shkodër dhe Bunë Fabrika Çimentos.

Masat e propozuara për reduktimin e përmbytjeve u grupuan si masa afatmesme, masa afatgjata dhe masa jostrukturore. Tetë masat afatmesme ishin:

- Përmirësime në digat ekzistuese përgjatë lumit Bunë në përputhje me digat përkatëse ekzistuese në anën e lumit të Malit të Zi.

- Rritja e kapacitetit të kanaleve të kullimit. Kjo duhet të arrihet me një kombinim të pastrimit të vegjetacionit të tepërt dhe gërmimit të një kanali të gjerë kullimi.

- Bllokimi përgjatë anës perëndimore të rrugës për të parandaluar që ujërat e plotave të arrijnë tokën e fshatrave në lindje të rrugës.

- Formalizimi i përdorimit të argjinaturës së kanalit për të funksionuar si strukturë e përmbytjes.

- Përdorimi i një zone si një zonë pa përmbytje nga ndërtimi i një ure të gjatë. Kjo do të përfshinte edhe përmirësime në digat e tjera të Drinit.

- Zgjerimi i një pjese të kanalit të lumit Bunë. Ky opsion mund të përfshijë edhe pastrimin e lumit.

- Rritja e kapacitetit të një ure rruge, zgjerimi dhe rritja e hapësirës. Heqjen e një urë të vjetër në rrjedhën e sipërme.

Këto përbërës individualë janë pjesë e katër zgjidhjeve alternative për zbutjen e përmbytjeve. Të gjitha këto përfshijnë pastrimin dhe kanë për qëllim rritjen e kapacitetit të rrjedhës së lumit nga 1500 m^3/s në 2200 m^3/s. [191] Dy nga katër opsionet u vlerësuan të kenë një raport përfitim/kosto më të madhe se 1.0.

Raporti gjithashtu paraqiti dy masa afatgjata.

- Vendimet ndërkufitare duhet të bëhen midis Shqipërisë dhe Malit të Zi për sa u përket niveleve të ujit në Liqenin e Shkodrës. Kjo do të kërkonte një strukturë të përbashkët kontrolli, e cila lejon rregullimin e niveleve të Liqenit gjatë sezonit të thatë dhe rrjedhjeve të kontrolluara të shkarkimit dhe ruajtjes gjatë sezonit të lagësht.

- Menaxhimi i kaskadës së Drinit aktualisht bazohet në shqetësimet rreth stabilitetit të digave në prodhimin e energjisë, por nuk merr parasysh mbrojtjen nga përmbytjet. Menaxhimi i shkarkimeve të digave dhe Liqenit të Shkodrës mund të ketë një ndikim pozitiv në përmbytjet në drejtim të rrymës.[192]

- Është propozuar edhe një masë tjetër afatgjatë nga AKZM-ja. – Prioritet duhet të jetë masa biologjike për mbjelljen e bimësisë përreth ujëmbledhësit të shpyllëzuar si një ndërhyrje për eliminimin e shkaqeve dhe jo të pasojave.

U prezantuan edhe dy masa jostrukturore.

- Sigurimi i një shërbimi të parashikimit dhe paralajmërimit të përmbytjeve për të minimizuar ndikimin e ngjarjeve të përmbytjeve duke lejuar autoritetet dhe popullatën e përgjithshme të ndërmarrin veprime lehtësuese.

- Planifikimi i kontrolleve për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm në fusha të tilla si toka e ulët mes Drinit dhe Bunës në bashkimin e tyre

10. Objektivat mjedisorë

DKU-ja kërkon që Shtetet Anëtare të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e statusit të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe përmbushjen e objektivave të mëposhtme mjedisore:

- Statusi i mirë ekologjik/kimik i trupave ujorë sipërfaqësorë

- Potenciali i mirë ekologjik dhe statusi kimik i trupave ujorë tepër të modifikuar (TUTM) dhe i Trupave ujorë artificialë (TUA)"

- Statusi i mirë kimik/sasior i trupave ujorë nëntokësorë

Bazuar në monitorimin e mëparshëm kombëtar, PMBU Drin–Bunë ofron një pasqyrë të gjendjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë (Seksioni 7). Megjithatë, monitorimi i mëparshëm nuk është në përputhje me kërkesat e DKU-së. Në mungesë të metodologjive në përputhje me DKU, është zbatuar një procedurë e shpejtë për vlerësimin ekologjik me qëllim sigurimin e informacionit, megjithëse të kufizuar, mbi cilësinë ekologjike të ujërave sipërfaqësorë.

Përkundër mungesës së kapaciteteve (burimeve njerëzore dhe aftësive teknike) në basenin ujor

[191] Normalisht, zgjidhjet që përfshijnë pastrimin përfshijnë, gjithashtu, një pagesë për pastrimin e mëtejshëm në të ardhmen. Kjo është për shkak të faktit se kur kapaciteti i një lumi rritet, shpejtësitë janë më të ulëta dhe prandaj më shumë materiali në pezullim bie dhe lumi me kalimin e kohës do të kthehet në profilin e tij origjinal. Analiza ekonomike përfshin "mirëmbajtjen", por nuk duket se ka lejuar për pastrimin e përsëritur në të ardhmen.

[192] Kjo duket të jetë në kundërshtim me informacionet e dhëna projektit nga ana e operatorit të digave (KESH) i cili paraqiti detajet e procedurave operative të dizajnuara për të minimizuar përmbytjet.

Drin–Bunë (dhe në nivel kombëtar) për të ndërmarrë kërkesat e monitorimit të DKU-së, mund të përcaktohet një qasje plotësuese në nivel të basenit, e përdorshme për planifikimin kombëtar dhe zbatimin, vizionet dhe objektivat specifikë të menaxhimit për Basenin Ujor, bazuar në Planin Kombëtar për Sektorin e Ujit (PKSU). Kjo qasje do të ofrojë udhëzime për drejtimin në lidhje me arritjen e qëllimeve të miratuara dhe gjithashtu të ndihmojnë në arritjen e objektivave të përgjithshëm mjedisorë të DKU-së. Vizionet bazohen në vlera të përbashkëta dhe përshkruajnë objektivat parësorë për Basenin Ujor Drin–Bunë. Objektivat përkatës të menaxhimit përshkruajnë hapat e parë drejt objektivave mjedisore në Basenin Ujor Drin–Bunë në një mënyrë të qartë

PKSU-ja përcakton perspektivën për vizionin, qëllimet dhe objektivat e sektorit në vitin 2030, në përputhje me Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (Agjenda 2030) dhe ciklin e hartimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore, të referuara në Direktivën Kuadër të Ujërave.

Nga pikëpamja e ndarjes hierarkike, ekzistojnë katër nivele kryesore të ndarjes së roleve dhe përgjegjësive në sektorin publik, të cilat janë; drejtues, menaxhues dhe operacional. Institucionet kryesore janë Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Ujit, Komiteti i Planifikimit Strategjik; Në nivel qeveritar janë ministritë e linjës lidhur me çështjet e ujit; Në nivel drejtues janë Agjencitë Kombëtare, Bordet Rajonale të Kullimit, këta të fundit kryejnë gjithashtu detyra operacionale; në varësi të ministrive të linjës dhe në nivel operacional, autoritetet lokale të cilat janë përgjegjëse për probleme të ndryshme sektoriale (ndërtimi, mirëmbajtja, rehabilitimi etj.).

Qasja, bazuar në PKSU-në, në basenin ujor është ngritur një sistem i integruar me qëllim sigurimin e ndërveprimit ndërinstitucional për të arritur me sukses objektivat e paraparë mjedisore, duke siguruar gjithashtu qëndrueshmërinë e sistemit. Objektivat mjedisorë, veprimet e propozuara dhe treguesit për suksesin paraqiten në tabelën 10.1

Për arritjen e objektivave për sektorin e ujit, për periudhën 2021–2033 dhe më gjerë, janë propozuar një numër masash të nevojshme në seksionin 12.

Tabela 10.1: Objektivat mjedisorë, veprimet dhe indikatorët mjedisorë për Basenin Ujor Drin–Bunë.[193]

Objektivat mjedisorë/veprimet	Njësitë e matjes	Objektiva		
		2021[194]	2024	2030
1. Për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e tyre të drejtë ndërmjet përdoruesve, maksimizimin e përfitimeve ekonomike në lidhje me kushtet e mjedisit dhe parimet e menaxhimit të qëndrueshëm				
Përmirësim i vazhdueshëm në furnizimin me ujë	*% e popullsisë së shërbyer në zonat urbane*	84	89	94
	% e popullsisë së shërbyer në zonat rurale	35	40	58
	Furnizimi mesatar me ujë (orë/ditë)	9	12	17
Përmirësimi i grumbullimit të ujërave të ndotura	*% e popullsisë së shërbyer në zonat urbane*	64	65	70
	% e popullsisë së shërbyer në zonat rurale	18	24	30
Uji për ujitje për tokën bujqësore	*Toka bujqësore e ujitur (ha)*	28.000	35.000	45.000
Përmirësimi i rrjetit të kullimit për tokën bujqësore të ujitur	*Zonë me rrjet kullues (ha)*	40.000	50.000	60.000
Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës në zona të caktuara	*% e ekonomisë aktive në zonën e specifikuar*	10	30	60
Maksimizimi i përdorimit të potencialit të energjisë hidrike	*% në krahasim me kapacitetin maksimal të vendit*	70	80	95
Plotësimi i kërkesave të ujit industrial	*% në krahasim me kërkesën*	90	100	100

[193] Objektivat e mjedisit janë në përputhje me PKSU-në.
[194] 2017 konsiderohet si "viti bazë".

Objektivat mjedisorë/veprimet	Njësitë e matjes	Objektiva		
		2021[194]	2024	2030
2. Ruajtja dhe arritja e statusit minimal "të mirë" ekologjik dhe kimik për trupat ujorë sipërfaqësorë që kanë status "më pak se të mirë", "të keq" ose "shumë të keq". (lumenjtë, liqenet, ujërat kalimtare/kalimtare, bregdetare, ujërat artificiale dhe trupat ujorë tepër të modifikuar)				
Përmirësimi i monitorimit për të gjithë trupat ujorë	*% e stacioneve të monitorimit në vendet e dakorduara që ofrojnë të dhëna me rëndësi*	20	50	100
Përmirësimi i statusit ekologjik dhe i cilësisë kimike për të gjithë llojet e trupave ujorë sipërfaqësore	*Reduktimi i shkarkimit të ujërave të zeza të papërpunuara nga qytetet me > 2,000 ekuivalencë të popullsisë (pikat e burimit)*	10	50	95
	% e popullsisë së lidhur me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	22	40	70
	Ndërtimi i gropave septike për % të popullsisë jo në rrjetin e grumbullimit të ujërave të ndotura	15	25	50
	% reduktim i shkarkimeve të ujërave të zeza të patrajtuara nga instalimet industriale dhe bujqësore (pikat e burimit)	10	50	95
Prezantimi i praktikave të mira bujqësore - vlerësimi, monitorimi dhe menaxhimi	*% e rasteve të përputhshmërisë së treguesve të cilësisë së ujit për lëndët ushqyese (burimet e shpërndara)*	30	50	95
Reduktimi i kontaminimit nga përdorimi i pesticideve në bujqësi	*% e reduktimit të kontaminimit*	-	50	80
Reduktimi i përdorimit të paligjshëm të inerteve dhe zhavorrit të lumenjve	*% reduktim i shoqërive që kryejnë veprimtari të paligjshme në shtretërit e lumenjve*	5	50	100
3. Parandalimi i ndotjes me qëllim shmangien e një përkeqësimi të cilësisë së ujërave nëntokësore dhe arritjen e një statusi të mirë kimik në trupat ujorë sipërfaqësore.				
Eliminimi/zvogëlimi i sasisë së substancave të rrezikshme dhe nitrateve që hyjnë në ujërat nëntokësore	*% e reduktimit të kontaminimit*	-	50	80
Rritja e efikasitetit të trajtimit të ujërave të zeza për të shmangur ndotjen e Ujërave Sipërfaqësore nga burimet e ndotjeve urbane dhe industriale	*Reduktimi i shkarkimit të ujërave të zeza të papërpunuara nga qytetet me > 2,000 ekuivalencë të popullsisë (pikat e burimit)*	10	50	95
4. Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimale "të mirë" për ujin e larjes (të brendshme, bregdetare dhe kalimtare)				
Rritja e numrit të stacioneve monitoruese bregdetare për elementet mikrobiologjike	*Numri i stacioneve monitoruese*	20	30	40
Rritja e numrit të parametrave të monitorimit sipas kërkesave të direktivave europiane	*% e parametrave të monitoruara rregullisht sipas Direktivës së Ujit të BE-së*	50	75	100
5. Reduktimi i rrezikut nga përmbytjet dhe humbjet për jetën, mjetet e jetesës, shëndetin, ekonominë, pasuritë kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve				
Reduktimi i numrit të banorëve të prekur nga përmbytjet	*% e popullsisë së prekur*	10	>5	>1
Reduktimi i tokës bujqësore të prekur nga përmbytjet	*Sipërfaqja e tokës bujqësore të prekur (ha)*	3.000	1,700	1.000
6. Përmirësimi i sigurisë së digave të ujitjes				
Vlerësimi dhe sigurimi i masave për përmirësimin e sigurisë së digave	Numri i digave	25	50	100
7. Ruajtja dhe/ose reduktimi i shkallës së erozionit në lumenj				
Zonat më pak të rrezikuara (20% e territorit)	*ton/ha/vit*	5	4,5	3
Zonat me rrezik të lartë (70% e territorit)	*ton/ha/vit*	15	13	10

11. Analiza ekonomike e përdorimit të ujit

11.1 Qëllimi i karakterizimit fillestar ekonomik

Qëllimi i studimit ekonomik është përdorimi i të dhënave ekzistuese për të ofruar një pasqyrë fillestare të përfitimeve ekonomike dhe kostove që lidhen me shfrytëzimin e burimeve ujore në Rajonin e basenit ujor Drin–Bunë dhe për të vlerësuar tendencat e ardhshme të kërkesës për ujë. Çështjet ekonomike janë përgjithësisht të lidhura me kushtet sociale dhe sugjerojnë, shpesh me anë të përfaqësimit, sjelljet aktuale dhe të ardhshme shoqërore (shih seksionin 4.7 më poshtë).

Karakterizimi fillestar ekonomik për basenin ujor Drin–Bunë:

- Analiza e rëndësisë ekonomike të përdorimit të ujit;
- Tendencat në kërkesën për ujë;
- Vlerësimi i nivelit aktual të rikuperimit të kostos për shërbimet e ujit.

Theksi është vënë në karakterizimin e një gamë të gjerë të përdorimit të ujit, duke përfshirë ato vendore, bujqësore dhe ato industriale. Përveç kësaj dhe në kontekstin e këtij vështrimi fillestar, ky studim gjithashtu ofron një kornizë të planifikimit për implementimin e Direktivës së Ujit, e cila integron kërkesat e mbetura të analizës ekonomike që nuk plotësohen në këtë karakterizim fillestar.

Analiza ekonomike është një pjesë e rëndësishme e zbatimit të Direktivës së Ujit (direktiva 2000/60/KE). Vetë direktiva siguron vetëm një pasqyrë të gjerë të analizës së kërkuar ekonomike. Kjo është një kërkesë e nenit 5 të direktivës, "Karakteristikat e rajonit të basenit ujor, rishikimi i ndikimit mjedisor të aktivitetit njerëzor dhe analizës ekonomike të përdorimit të ujit sipas Direktivës së Ujit", ku thuhet se çdo Shtet Anëtar duhet të sigurojë çdo rajon të basenit ujor ose pjesën e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor që bie në territorin e tij:

- Një analizë të karakteristikave të tij;
- Një rishikim të ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësorë dhe në ujërat nëntokësore; dhe
- Një analizë ekonomike e përdorimit të ujit është ndërmarrë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcat II dhe III dhe se është plotësuar jo më vonë se katër vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj direktive."

Neni 9 i Direktivës Kuadër të Ujit ka të bëjë me rimëkëmbjen e shpenzimeve për shërbimet e ujit, ku Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh parimin e mbulimit të kostove të shërbimeve të ujit, duke përfshirë kostot mjedisore dhe të burimeve, duke marrë parasysh analizën ekonomike të kryer sipas shtojcës III, dhe në përputhje në veçanti me parimin "ndotësi paguan".

Është e nevojshme që shtetet anëtare të sigurojnë që:

- Politikat e çmimit të ujit të ofrojnë stimuj të përshtatshëm për përdoruesit e burimeve ujore, në mënyrë efikase dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në objektivat mjedisorë të kësaj Direktive,
- Një kontribut i përshtatshëm i përdorimeve të ndryshme të ujit, të ndara të paktën në industrinë, familjet dhe bujqësinë, në rimëkëmbjen e kostove të shërbimeve të ujit, bazuar në analizën ekonomike të kryer sipas shtojcës III dhe duke marrë parasysh parimin "ndotësi paguan".

Me qëllim zbatimin e kërkesave të mësipërme të DKU-së, janë lëshuar dy dokumente orientuese nga BE-ja dhe të cilat janë marrë parasysh në këtë raport:

- Dokumenti udhëzues nr. 1: Ekonomia dhe mjedisi - Sfida zbatuese e Direktivës Kuadër të Ujit, prodhuar nga Grupi i Punës 2.6 – WATECO;
- Vlerësimi i Kostove të Mjedisit dhe Burimeve në Direktivën Kuadër të Ujit, Informacioni i përgatitur nga Grupi i Hartimit ECO2, Strategjia e Zbatimit të Përbashkët, Grupi i Punës 2B.

Në përputhje me objektivat e përcaktuar në Direktivën e Ujit dhe më saktë në dokumentet udhëzuese të përmendura më lartë, ky raport siguron:

- Parashikimet e ndikimeve ekonomike dhe vlerave që lidhen me përdorimet kryesore të burimeve ujore në nivelet e Rajoneve të Basenit Ujor, ku "përdorimet" përfshijnë përdorimet abstrakte që lidhen me sektorët bujqësorë, industrialë dhe vendorë;
- Projeksionet e kërkesës për ujë, parashikojnë që do të shërbejnë pjesërisht si bazë për vlerësimet e ardhshme të programeve të mundshme të masave nën skenarë të ndikimeve dhe presioneve të ndryshme; dhe
- Identifikimi i niveleve aktuale të shpenzimeve të shërbimeve të ujit dhe rimëkëmbjes së kostove në QBU, ku "shpenzimet" përfshijnë shpenzimet

për ofrimin e shërbimeve të ujit siç është përcaktuar në Direktivën Kuadër të Ujit:

- "Shërbimet e Ujit" do të thotë të gjitha shërbimet që sigurojnë ujë, për familjet, institucione publike ose ndonjë aktivitet ekonomik:

a) nxjerrja, mbyllja, ruajtja, trajtimi dhe shpërndarja e ujërave sipërfaqësore ose ujërave nëntokësore;

b) objektet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujëra sipërfaqësore.

Analiza ekonomike shqyrtoi ndikimet ekonomike të përdorimit të ujit të sektorit të brendshëm duke përdorur nënsektorët e bujqësisë dhe industrisë dhe kategoritë e tjera të përdorimit të ujit. Nënsektorët kryesorë të ujit janë përcaktuar si ato në të cilat aktivitetet e përdorimit të ujit janë kritike për shkak të vëllimit të ujit të përdorur. Të gjitha të dhënat e paraqitura në seksionet e mëposhtme janë dhënë në shtojcën 4.

11.2 Përdorimi dhe ndikimi i ujit

11.2.1 Nxjerrjet e ujit

Nxjerrjet e Ujit nga Trupat Ujorë ndërmerren për një sërë qëllimesh, duke përfshirë furnizimin me ujë të pijshëm për familjet dhe përdorimin e ujit në proceset bujqësore dhe industriale.

11.2.1.1 Përdorimi bujqësor i ujit

Struktura e fermave bujqësore në Shqipëri dhe në basenet ujore reflekton në masë të madhe rezultatet e procesit të privatizimit. Megjithatë, që nga privatizimi, ka ndodhur fragmentimi i mëtejshëm i tokës, pasi toka e ndarë për secilën familje rurale është fragmentuar në shumë parcela të ndryshme. Sipas regjistrimit të bujqësisë në vitin 2012 (të dhënat e fundit), sipërfaqja bujqësore e përdorur ishte në pronësi të 324,013 fermave dhe madhësia e fermës mesatarisht ishte më pak se 2 ha. Shumica e këtyre fermave janë për nevoja jetësore, pa orientim në treg. Kjo kategori fermash, ose gjysmëfamiljare, kanë tendencë të përqendrohen në zonat malore, ku toka është pak pjellore dhe ku jetojnë rreth 60% e popullsisë rurale.

Që nga regjistrimi i fundit në vitin 2012 numri i fermave më të mëdha se 2 ha nuk është rritur. Sipas studimeve më të fundit, ka të ngjarë që të ndodhë e kundërta, për shkak të fragmentimit të mëtejshëm, kryesisht të shkaktuar nga trashëgimia dhe pa nxitje të qarta nga qeveria për të parandaluar fragmentimin e mëtejshëm ose inkurajimin e një tregu efektiv të tokës.

Të dhënat statistikore në lidhje me numrin e fermave bujqësore dhe të punueshme në rajonet e basenit ujor Drin–Bunë janë paraqitur në tabelat 11.1 deri në 11.4 më poshtë.

Tabela 11.1: Tokë e punueshme me të korra në rajonin e basenit ujor Drin–Bunë, 2015[195]

Rrethi	Totali i Fermave Bujqësore	Tokë e punueshme (000 ha)
Dibër	19,981	29
Korçë	33,685	16
Kukës	10,638	13
Lezhë	17,196	23
Shkodër	28,854	34

Përdorimi i tokave bujqësore ndahet ndërmjet kategorive kryesore të mëposhtme: drithëra, perime, patate, grurë, duhan, luledielli, bishtajore dhe foragjere.

Të dhënat ekzistuese statistikore mbi fermat e kafshëve në basenin ujore përfshijnë kategoritë kryesore të bagëtive: si kafshët e mishit, lopët për prodhim qumështi, delet, delet për prodhim qumështi, dhitë, dhitë për prodhim qumështi, derrat, kuajt dhe shpezët. Të dhënat statistikore gjithashtu përfshijnë kategoritë e mëposhtme: qumështi, mishi, vezët dhe leshi.

Përdorimi bujqësor i ujit për nënsektorin e rritjes së bimëve është përcaktuar duke shumëzuar vlerën për hektar të ujitjes me hektarët total të plantacioneve. Vlera e ujit për hektar u konsiderua në një vëllim mesatar prej 18,338 m^3/ha/për vit (bazuar në të dhënat e vitit 2010). Uji i përdorur për ujitje në basenin ujor Drin–Bunë, sipas rretheve, është paraqitur në Tabelën 11.2.

Tabela 11.2: Uji i përdorur për ujitje në Rajonin e basenit ujor Drin–Bunë, 2015

Rrethi	Tokë e punueshme (000 ha)	Volumi i ujit për ujitje (000 m^3)
Dibër	29	531,802
Korçë	16	293,408
Kukës	13	238,394
Lezhë	23	421,774
Shkodër	34	623,492

[195] INSTAT: Vjetari Statistikor i Bujqësisë 2015, Censusi në Bujqësi, 2012.

Shumëzimi për njësitë e përdorura i vlerësuar nga numri i kafshëve, nxjerr vlerat e përdorimit të ujit të fermës së kafshëve. Për qëllime të analizës ekonomike, përdorimi i ujit për njësi, ashtu siç tregohet në Tabelën 11.3 është konsideruar si:

Tabela 11.3: Përdorimi i përditshëm i ujit për kafshët

Kafshët	Përdorimi i ujit (l/ditë)
Bagëti	60
Lopë	40
Dele/dhi	5
Dele/dhi që japin qumësht	10
Derra	5
Kuaj	35
Shpendë	0.25

Bazuar në vlerat e lartpërmendura të njësisë, kërkesa e ujit të fermave ekzistuese të kafshëve është siç tregohet në Tabelën 11.4 më poshtë:

Tabela 11.4: Përdorimi i ujit në fermat e kafshëve në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

Kafshë	Nr. (000 krerë)	L/ditë	Totali m^3/ditë	Përdorimi i ujit (m^3/vit)
Bagëti	208	60	12,480	4,555,200
Lopë	145	40	5,800	2,117,000
Dele	452	5	2,260	824,900
Dele që japin qumësht	350	10	3,500	1,277,500
Dhi	306	5	1,530	558,450
Dhi që japin qumësht	228	10	2,280	832,200
Derra	123	5	615	224,475
Njëthundrrakë	30	35	1,050	383,250
Shpendë	1,887	0.25	472	172,189

11.2.1.2 Përdorimi industrial i ujit

Uji i përdorur në sektorin industrial/komercial/institucional (IKI) është gjithashtu për qëllime teknologjike dhe higjienike. Mund të jetë ujë industrial jo i pijshëm ose ujë i pijshëm dhe mund të furnizohet nga ndërmarrjet e shërbimeve të ujit ose i prodhuar në bazë të vetëshërbimit.

Ekzistojnë të dhëna shumë të kufizuara për të vlerësuar ndikimin ekonomik të këtij uji në lidhje me qarkullimin vjetor, të ardhurat dhe punësimin e sektorit IKI. Në këtë rast të dhënat e vetme në dispozicion për të vlerësuar ndikimin janë referimi i numrit të kompanive të regjistruara dhe sasisë vjetore të ujit të furnizuar nga shërbimet e ujësjellësit. Shifrat janë paraqitur në Tabelën 11.5 më poshtë:

Tabela 11.5: Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe formave ligjore në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

Qarku	Fermerë	Kompani
Dibër	75	545
Korçë	1,177	316
Kukës	88	368
Lezhë	378	824
Shkodër	2,275	1,571

Vëllimi i ujit industrial, komercial dhe institucional (IKI) u vlerësua duke marrë parasysh të dhënat e ofruara nga ndërmarrjet lokale/rajonale të ujësjellësit dhe duke iu referuar furnizimit me ujë të pijshëm. Nuk kishte të dhëna të besueshme për përdorimin e ujit të pijshëm dhe për ujin e vetë-shërbyer.

Sipas këtyre të dhënave, në Basenin Ujor Drin–Bunë konsumi vjetor i ujit IKI në vitin 2015 ishte 705,000 m^3 për sektorin industrial dhe komercial, 842,000 m^3 për institucionet dhe gjithsej 1,547,000 m^3.

11.2.1.3 Përdorimi shtëpiak i ujit

Uji për përdorim shtëpiak është furnizuar nga kompanitë ekzistuese të shërbimeve të ujit ose është marrë nga burimet e veta (vetë-shërbimi).

Vlerësimet e përdorimit shtëpiak të ujit u llogaritën duke përdorur një normë konsumimi për frymë si për burimet e centralizuara dhe ato të vetë-shërbimit. Të dhënat e popullsisë të Censusit 2011 janë përdorur si shumëzues për njësi për vlerësimin e përdorimit shtëpiak të ujit.

Të dhënat e popullsisë së Censusit 2011 për qytetet kryesore në basenin ujor janë paraqitur në Tabelën 11.6 më poshtë.

Tabela 11.6: Të dhënat e popullsinë sipas Censusit 2011 në Basenin Ujor Drin–Bunë

Qarku	Popullsia (Numri i banorëve)
Shkodër	237,696
Kukës	63,338
Dibër	46,895
Lezhë	35,000
Korçë	59,680

Bazuar në të dhënat e Censusit 2011 dhe në shkallën e mbulimit të shërbimeve të ujit dhe konsumit për frymë të raportuar nga ndërmarrjet e ujësjellësit, konsumi vjetor shtëpiak nga burimet e centralizuara është 13,593,424 m^3 në Basenin Ujor Drin–Bunë.

Popullsia që nuk furnizohet me ujë nga burime të centralizuara ka qasje në burimet ujore në organizimet vetë-shërbim.

Të dhënat mbi vetëshërbimet, të tilla si furnizimi privat me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura (që përdorin gropa septike) janë të vështira për t'u identifikuar pasi nuk ekziston një grup të dhënash gjithëpërfshirëse në dispozicion për numrin e shërbimeve, vendndodhjen, vëllimeve etj. Vlerësime janë bërë në bazë të popullsisë pa furnizim të centralizuar të ujit dhe konsumin mesatar të ujit (l/f/d) në qarkun e Basenit Ujor.

Në Basenin Ujor Drin–Bunë, konsumi mesatar i ujit për frymë konsiderohet 96.65 l/c/d, dhe duke përdorur këtë vlerë, konsumi vjetor i ujit shtëpiak është llogaritur në 2,694,694 m^3.

Duke marrë parasysh të dhënat e mësipërme, struktura e përdorimit të ujit shtëpiak (SH) IKI mund të përfaqësohen siç tregohet në Figurën 11.1. Për shkak të aktivitetit të ulët industrial/komercial në basenin ujor, konsumi i ujit IKI është shumë më i vogël se konsumi shtëpiak. Ky fakt zvogëlon ndikimin ekonomik të ujit në rajon.



Figura 11.1: Struktura e përdorimit të ujit (m^3/vit) në Basenin Ujor Drin–Bunë

11.2.2 Përdorimi ujit sipërfaqësor

Hidrocentralet

Shqipëria ka një potencial të lartë hidroenergjetik me më pak se 40% të përdorur deri më sot (Ministria përgjegjëse për energjinë). Vendi ka një kapacitet total të instaluar prej 1,466 mw dhe shënon një prodhim mesatar të hidrocentraleve prej 5,283 gwh. Rezervat totale hidroenergjetike mundësojnë instalimin e rrjetit elektrik 4.500 mw dhe prodhimi i tij vjetor i energjisë elektrike mund të arrijë deri në 16 twh. Sipas AKBN-së, në përfundim të tre-mujorit të parë të vitit 2018, në Shqipëri ka pasur 197 kontrata koncesioni të lidhura për ndërtimin e 555 hidrocentraleve të vogla, nga të cilat 180 kontrata janë aktive, këto parashikojnë ndërtimin e 486 HEC-ve (17 kontrata u ndërprenë). Furnizimi potencial kombëtar i hidrocentraleve të HEC-ve "të lëshuara me koncesion" është rreth 1,820 mw dhe prodhimi vjetor prej rreth 7,540 gwh. Për 119 HEC-et të cilat nuk janë subjekt i koncesionit, kapaciteti i përgjithshëm i potencialit shkon deri në 230 mw dhe prodhimi vjetor do të jetë rreth 40 gwh.

Në lumin Drin janë tri hidrocentrale të mëdhenj operacionale me një kapacitet total të instaluar prej 1350 mw, HEC "Vau i Dejës", HEC "Fierza" dhe HEC "Koman". Një kontratë koncesioni është lidhur për hidrocentralin "Ashta" në lumin Drin midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kompanisë austriake "Österreichische Elektrizitätsëirtschafts - Aktiengesellschaft", me një kapacitet të instaluar prej 48.2 mw.

Ndikimi ekonomik i operimit të këtyre hidrocentraleve shprehet në vlerën monetare të energjisë së prodhuar. Çmimi njësi i energjisë është 9.5 Lek/kwh, pa TVSH. Në këtë rast vlera mesatare vjetore e energjisë është 47,021,988,500 Lek (€343,263,777), siç tregohet në Tabelën 11.7.

Tabela 11.7: Të ardhurat mesatare vjetore nga hidrocentralet në Basenin Ujor Drin–Bunë[196]

Hidrocentralet	Prodhimi mesatar vjetor (mwh)	Të ardhurat mesatare vjetore nga energjia (lek/vit)	Të ardhurat mesatare vjetore nga energjia (euro/vit)
"KESH" sha HEC "Fierze"	1,636,522	15,546,959,000	113,493,879
"KESH" sha HEC "Koman"	1,882,721	17,885,849,500	130,567,942
"KESH" sha HEC "V. i Dejës"	932,732	8,860,954,000	64,685,579

[196] HEC-e funksionale në vitin 2016.

Hidrocentralet	Prodhimi mesatar vjetor (mwh)	Të ardhurat mesatare vjetore nga energjia (lek/vit)	Të ardhurat mesatare vjetore nga energjia (euro/vit)
"Energji Ashta" sh.p.k. HEC "Ashta"	235,604	2,238,238,000	16,339,293
HEC "Bulqize" (Dibër)	1,363	12,948,500	94,525
HEC "Homesh" (Dibër)	400	3,800,000	27,740
HEC "Zerqan" (Dibër)	1,035	9,832,500	71,778
HEC "Arras" (Dibër)	15,648	148,656,000	1,085,199
HEC "Orgjost" (Kukës)	4,257	40,441,500	295,226
HEC "Lekbibaj" (Tropojë)	4,970	47,215,000	344,673
HEC "Dukagjin" (Shkodër)	2,414	22,933,000	167,412
HEC "Muhur" (Dibër)	863	8,198,500	59,850
HEC "Lure" (Dibër)	692	6,574,000	47,991
HEC "Cernaleve"	15,263	144,998,500	1,058,499
HEC "Pobreg"	36,373	345,543,500	2,522,492
HEC "Ostren i Vogël"	790	7,505,000	54,787
HEC "Lura 1"	3,961	37,629,500	274,698
HEC "Trebisht"	1,264	12,008,000	87,659
HEC "Tucep"	982	9,329,000	68,102
HEC "Shales"	1,570	14,915,000	108,881
HEC "Bicaj"	51	484,500	3,537
HEC "Orenjë"	1,115	10,592,500	77,326
HEC "Tamarë"	745	7,077,500	51,666
HEC "Sasaj"	25,000	237,500,000	1,733,766
HEC "Perrollaj"	214	2,033,000	14,841
HEC "Peshqesh"	28,711	272,754,500	1,991,127
HEC "Bele 1"	114,423	1,087,018,500	7,935,310
Total	**4,949,683.00**	**47,021,988,500**	**343,263,777**

11.3 Vlera e ujit

Vlera e ujit të konsumuar nga përdoruesit shtëpiakë, bujqësorë dhe industrialë është vlerësuar duke marrë parasysh sasinë e konsumit të ujit dhe tarifat përkatëse të aplikuara nga ofruesit e shërbimeve.

Shifrat e përdorura në këtë seksion pasqyrojnë përpjekjet e furnitorëve për të ofruar ujë sesa vlerën reale e ujit të nxjerrë nga burimet natyrore. Megjithatë, ne konsiderojmë një mjet të mirë për të vlerësuar ndikimin monetar të konsumit.

11.3.1 Përdorimi shtëpiak i ujit

Vlera vjetore e ujit për përdorim shtëpiak në rastin e furnizimit me ujë të centralizuar është vlerësuar duke marrë parasysh tarifat ekzistuese të ujit në rajonet e ndryshme të qarkut të Basenit Ujor. Siç është përmendur edhe më lartë, vlera e ujit të vetë-shërbyer nuk përfshihet pasi nuk ka të dhëna të sakta për konsumin real dhe nuk ka metoda adekuate për të vlerësuar këtë ujë.

Shifrat për vlerën e ujit shtëpiak në çdo qark që i përket basenit ujor janë paraqitur në tabelën 11.8 më poshtë.

Tabela 11.8: Vlera e ujit për përdorim shtëpiak në Basenin Ujor Drin–Bunë[197]

Qarku	Konsumi i ujit (m^3/vit)	Vlera e ujit shtëpiak (lek/vit)	Vlera e ujit shtëpiak (euro/vit)
Shkodër	7,856,801	339,714,645	2,479,940
Kukës	1,440,413	33,655,421	245,687
Dibër	1,395,322	30,932,654	225,810
Lezhë	1,164,238	67,525,804	492,943
Korçë	1,223,061	75,829,782	553,563

11.3.2 Përdorimi industrial, komercial dhe institucional i ujit

Vlera vjetore (2015) e ujit për përdorim industrial, komercial dhe institucional (IKI) në rastin e furnizimit me ujë të centralizuar është vlerësuar, duke marrë parasysh tarifat ekzistuese të ujit në rajonet e ndryshme të Basenit Ujor (tab ela 11.9). Vlera e ujit të vetë-shërbyer nuk është përfshirë, pasi nuk ka të dhëna të besueshme për këtë çështje.

Tabela 11.9: Vlera vjetore e ujit industrial, komercial dhe institucional (IKI) në Basenin Ujor Drin–Bunë[198]

Emri i Ndërmarrjes	Sasia totale e ujit të shitur (000 m^3)	Tarifa e ujit (lek/m^3)	Sasia totale e ujit të shitur (000 m^3)	Tarifa e ujit (lek/m^3)	Vlera e ujit IKI (lek/vit)	Vlera e ujit IKI (euro/vit)
	Komercial dhe institucional		Industrial			
Bashkia Pukë UK	9	140	18	130	3,563,700	26,015
Vau i Dejës U sh.a.	6	80	14	80	1,580,000	11,534
Tropojë U sh.a.	24	80	32	60	3,840,000	28,032
Lezhë UK sh.a.	143	145	75	135	30,860,000	225,280
Pogradec UK sh.a.	122	111	32	111	17,077,350	124,666
Shkodër UK sh.a.	187	110	335	110	57,399,100	419,017
Pukë fshat	2	80	5	60	469,400	3,427
Shkodër (F) U sh.a.	19	120	20	120	4,750,800	34,681

[197] Vlerat e deklaruara në euro u llogaritën me një kurs këmbimi prej 136.985 lekësh/eurosh.
[198] Vlerat e deklaruara në euro u llogaritën me një kurs këmbimi prej 136.985 lekësh/eurosh.

Fushë-Arrëz UK sh.a.	7	80	9	80	1,313,600	9,589
Librazhd UK sh.a.	55	100	39	100	9,436,000	68,883
Peshkopi U sh.a.	47	85	74	65	8,807,000	64,292
Bulqizë U sh.a.	26	75	90	55	6,857,100	50,057
Has U sh.a.	17	80	23	60	2,756,200	20,120
Kukës UK sh.a.	40	80	77	60	7,840,000	57,233
Total					**156,550,250**	**1,142,828**

Duke marrë parasysh të dhënat e mësipërme për përdorimin e ujit shtëpiak dhe IKI, figura 11.2 ilustron strukturën e vlerës së ujit SH dhe IKI në Basenin Ujor Drin–Bunë.

1.



Figura 11.2: Struktura e vlerave të përdorimit të ujit për Shtëpitë dhe IKI në Basenin Ujor Drin–Bunë

11.3.3 Përdorimi bujqësor i ujit

Uji bujqësor, si një shërbim i ofruar, është kryesisht për qëllime të ujitjes. Shërbimi ofrohet me çmim prej 2.000 lekë/ha për ujitje të parë, 1.500 lekë/ha për ujitje të dytë dhe 1.500 lek/ha për ujitje të tretë, duke e barazuar me një total prej 5,000 Lek/ha (36.5 €/ha). Duke marrë parasysh çmimet e mësipërme, vlera e ujitjes mund të vlerësohet siç tregohet në tabelën 11.10.

Tabela 11.10: Vlera e ujit për ujitje në Basenin Ujor Drin–Bunë

Qarku	Tokë arë (000 ha)	Vlera e ujitjes (lek/vit)	Vlera e ujitjes (euro/vit)
Dibër	29	145,000,000	1,058,510
Korçë	16	80,000,000	584,006
Kukës	13	65,000,000	474,505
Lezhë	23	115,000,000	839,508
Shkodër	34	170,000,000	1,241,012

11.4 Parashikimet e tendencave

Në këtë seksion bëhen vlerësime në lidhje me shpenzimet e ardhshme të ujit si një bazë për projeksionet e kërkesës së nxjerrjes së ujit. Tendencat e ardhshme vlerësohen për ujin e përdorur për furnizimin me ujë të pijshëm. Llojet e tjera të ujit (uji industrial jo i pijshëm, uji i ujitjes) aktualisht nuk konsiderohen, pasi nuk kishte në disponim të dhëna të besueshme për qëllime parashikuese.

Procesi i parashikimit përfshinte hapat kryesorë në vijim të paraqitura në Figurën 11.3. Supozime janë bërë në çdo hap, të cilat shpjegohen në nënseksionet përkatëse. Nëse kishte të dhëna zyrtare për tendenca të ndryshme, këto të dhëna janë përdorur për të kryer projeksionet. Në raste të tjera, supozimet më të mira ndërkombëtare janë marrë në konsideratë. Rezultatet e procesit të parashikimit janë paraqitur në nënseksionet më poshtë.



Figura 11.3: Hapat kryesorë në procesin e parashikimit

11.4.1 Parashikimet demografike

Parashikimet në lidhje me zhvillimin demografik në QBU u bazuan në "SHQIPËRIA: Projeksionet e Popullsisë 2011 - 2031" të lëshuar nga INSTAT - Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë në vitin 2014, skenar me rritje të lartë. Të dhënat e disponueshme të popullsisë nga censusi i vitit 2011, janë projektuar për çdo Qark në basenin ujor sipas trendit kombëtar të parashikuar në dokumentin e mësipërm. Rezultatet tregohen në figurën 11.4 më poshtë.



Figura 11.4: Parashikimet demografike në Basenin Ujor Drin–Bunë

Trendi demografik në tabelën 11.4 tregon një rritje të numrit të banorëve brenda 15 viteve të ardhshme. Rritja është rreth 4.4%, e cila nuk do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sasinë totale të ujit (të organizuar dhe vetë-shërbyer) të ujit të përdorur nga popullsia.

11.4.2 Tendencat e konsumit shtëpiak dhe IKI

Tendencat e konsumit shtëpiak të ujit u konsideruan në raport me rritjen e numrit të banorëve në rajon siç ishte parashikuar në pjesën e mëparshme. Faktorë të tjerë ndikues të marrë në konsideratë ishin shkalla e mbulimit të shërbimeve të ujit dhe konsumi i ujit për frymë.

Tendencat e konsumit të ujit IKI ndikohen nga ndryshimet në aktivitetin ekonomik (industri të reja, teknologji të reja, vëllim të prodhimit, punësim etj.). Duke qenë se nuk kishte të dhëna të rëndësishme dhe të besueshme lidhur me këto ndryshime në rajon, aktiviteti ekonomik konsiderohej statik në periudhën e ardhshme.

Konsumi shtëpiak dhe IKI (industrial, komercial dhe institucional) nga burimet e centralizuara në vitet e ardhshme është parashikuar duke marrë parasysh supozimet e mëposhtme:

- Viti bazë për projeksionet u konsiderua të jetë viti 2015;
- Rritja demografike u konsiderua të jetë siç e parashikuar në kapitullin paraprak;
- Supozohet se shkalla e mbulimit të shërbimeve të ujit do të jetë 100% në fund të vitit 2031;
- Konsumi për kokë do të jetë rreth 100 l/f/d në vitin 2031;
- Kërkesa e ujit IKI do të konsiderohet konstante deri në vitin 2031, pasi nuk ka të dhëna për ndryshimet në këtë fushë.

Bazuar në supozimet e mësipërme, në basenin ujor Drin–Bunë janë identifikuar tendencat e mëposhtme në konsumin shtëpiak dhe IKI (figura 11.5).



Figura 11.5: Tendencat në konsumin shtëpiak dhe IKI të ujit në basenin Drin–Bunë

Tendenca është një rritje kryesisht për shkak të konsumit shtëpiak, pasi konsumi i IKI konsiderohej konstant në periudhën 15-vjeçare. Meqë ky supozim është marrë në mungesën e të dhënave më të mira në dispozicion, nëse ndonjë zhvillim i IKI-t do të regjistrohet në basenin ujor, projeksionet duhet të rishikohen siç duhet.

Rritja e konsumit është rreth 64%, e cila do të ketë një ndikim të rëndësishëm në anën e ofertës. Nëse nuk do të ndërmerren veprime për të reduktuar rrënjësisht humbjet e ujit (shih më poshtë në Seksionin 11.4.3), shërbimet e ujësjellësit në basenin ujor do të detyrohen të zgjerojnë kapacitetin e tyre të trajtimit dhe furnizimit. Si skenari më i keq, kjo do të ketë gjithashtu një ndikim te burimet e ujit.

11.4.3 Humbjet e Ujit

Çdo ndërmarrje uji në basenin ujor po përballet me probleme serioze në lidhje me humbjet e ujit në sistemin e furnizimit. Niveli mesatar i ujit të pafaturuar (UPF)[199] në basen po arrin vlerën 63%, që do të thotë një dëmtim jo vetëm për ujësjellësin, por edhe për burimet ujore. Niveli i UPF në secilën ndërmarrje është siç tregohet në Tabelën 11.11.

Tabela 11.11: Humbjet aktuale të ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

Emri i ndërmarrjes:	Vëllimi neto i inputit në sistem (000 m³)	Totali i ujit të shitur (000m³)	UPA (000m³)	UPA (% e inputit në sistem)
Bashkia Pukë UK	347	138	209	60%
Vau i Dejës U sh.a.	695	161	534	77%
Tropojë U sh.a.	1,488	421	1,067	72%

[199] Uji i pafaturuar (UPF) është uji që është prodhuar dhe është "i humbur" përpara se të arrijë konsumatorin. Humbjet mund të jenë humbje reale (përmes rrjedhjeve, nganjëherë edhe të referuara si humbje fizike) ose humbjeve të dukshme (për shembull nëpërmjet vjedhjeve ose pasaktësive të matjes).

Lezhë UK sh.a.	2,182	1,193	989	45%
Pogradec UK sh.a.	2,424	1,293	1,131	47%
Shkodër UK sh.a.	12,908	3,491	9,417	73%
Pukë fshat	420	127	293	70%
Shkodër (F) U sh.a.	1,699	1,137	562	33%
Fushë-Arrëz UK sh.a.	461	115	346	75%
Librazhd UK sh.a.	720	554	167	23%
Mallakastër UK sh.a.	1,176	513	663	56%
Peshkopi U sh.a.	1,859	722	1,137	61%
Bulqizë U sh.a.	1,592	605	987	62%
Has U sh.a.	629	276	353	56%
Kukës UK sh.a.	986	856	130	13%

Humbjet e ujit në vitet e ardhshme u parashikuan duke marrë parasysh supozimet e mëposhtme:

- Viti bazë për projeksionet u konsiderua të jetë viti 2015;
- Në fund të periudhës (viti 2031) humbjet do të jenë në nivelin 35% të inputeve të sistemit. Ky supozim konsideron se ndërmarrjet e ujësjellësit do të bëjnë disa investime dhe do të zbatojnë një strategji reduktimi të UPA për të rritur performancën e tyre operacionale dhe financiare;
- Raportimi UPA (2015) konsiderohet i barabartë me humbjet fizike të ujit në sistemin e furnizimit me ujë. Ky supozim u bë pasi nuk kishte të dhëna të besueshme mbi komponentët e pallogaritur të ujit për të nxjerrë vlerën e saktë të humbjeve fizike;
- Humbjet totale të ujit në basenin ujor konsideroheshin si shuma e humbjeve të regjistruara nga secila ndërmarrje uji në rajon.

Bazuar në supozimet e mësipërme, u identifikuan tendencat e mëposhtme në humbjet e ujit në basenin ujor (Figura 11.6).



Figura 11.6: Parashikimet e ardhshme të ujit të pafaturuar (UPF) në Basenin Ujor Drin–Bunë

11.4.4 Tendencat totale të kërkesës për ujë në basenin ujor

Kërkesa totale e ujit supozohet të jetë shuma e konsumit të ujit (shtëpiak dhe IKI) dhe humbjet e ujit në sistemin e furnizimit. Për shkak të tendencave të kundërta të konsumit (në rritje) dhe humbjeve të ujit (në ulje), nuk janë identifikuar ndryshime të mëdha në kërkesën totale të ujit në basenin ujor. Ky fakt është i vërtetë vetëm në rastin e supozimeve të përshtatura, kryesisht:

- Nuk do të ketë investime të mëdha në industritë që konsumojnë ujë në rajon.
- Konsumi shtëpiak do të ketë një vlerë mesatare prej 100 l/c/d.
- Ndërmarrjet e ujit do të përvetësojnë dhe zbatojnë masat e duhura për të kontrolluar dhe për të zvogëluar humbjet fizike të ujit.

Shifrat e tendencës të kërkesës për ujë janë ilustruar në figurën 11.7.



Figura 11.7: Trendi i kërkesës për ujë në Basenin Ujor Drin–Bunë

11.5 Rikuperimi i kostos së shërbimeve të ujit

Qasja e propozuar këtu për analizimin dhe raportimin e mbulimit të kostos është siç thuhet në Dokumentin Udhëzues Nr. 1: Ekonomia dhe Mjedisi – Sfida e Zbatimit të Direktivës Kuadër të Ujit[200].

Shërbimet e identifikuara të ujit në Qarkun e Basenit Ujor (QBU)

Shërbimet e ujit përcaktohen në nenin 2 të DKU si: "të gjitha shërbimet që ofrojnë për ujë të pijshëm, institucione publike ose ndonjë aktivitet ekonomik*: a) Nxjerrjen, mbylljen, magazinimin, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor; b) Objektet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, të cilat më pas shkarkohen në ujë sipërfaqësor.*"

Shërbimet e ujit shihen si ndërmjetës midis mjedisit natyror dhe përdorimit aktual të ujit. Në Basenin Ujor Drin–Bunë shërbimet e mëposhtme të ujit u identifikuan si më poshtë:

- Furnizimi me ujë të pijshëm për familjet, kompanitë dhe institucionet, që përfshin:
- nxjerrjen;
- ruajtjen;
- trajtimin;
- shpërndarjen.
- Shërbimet e kanalizimeve për familjet, kompanitë dhe institucionet, të cilat përfshijnë:
- mbledhjen e ujërave të ndotura;
- objektet e trajtimit të ujërave të ndotura.

[200] http://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/facts_Figuras/guidance_docs_en.htm.

11.5.2 Ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura

Ofruesit janë subjektet që furnizojnë shërbimet e ujit dhe kanalizimeve. Për furnizimin publik me ujë dhe grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ekziston një ndërmarrje e vetme që siguron të gjitha fazat e shërbimeve (p.sh., nxjerrje, ruajtje, trajtim dhe shpërndarje të ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore). Lista e identifikuar e ndërmarrjes (ndërmarrjeve) të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (trajtimit të ujërave të ndotura, në rast se trajtohen) janë paraqitur në tabelën 11.12.

Të dhënat mbi vetë-shërbimet, të tilla si nxjerrja bujqësore dhe furnizimi privat me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura (që përdorin gropa septike ose gropa të grumbulluara) janë të vështira për t'u identifikuar, pasi nuk ka një grup të dhënash gjithëpërfshirëse në numrin e shërbimeve, vendndodhjeve, vëllimeve etj.

Tabela 11.12: Ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në Basenin Ujor Drin–Bunë

Vendi	Lokaliteti	Urban/Rural	Ndërmarrja e furnizimit me ujë	Ndërmarrja e kanalizimeve
Shkodër	Pukë, Gjegjan, Rrapë, Qelez, Qerret	U	Bashkia Pukë UK	Bashkia Pukë UK
		R	Fshati Pukë UK	Fshati Pukë UK
Shkodër	Fushë-Arrëz , Fierze, Blerim, Qafe Mali, Iballë	U	Fushë-Arrëz sh.a.	Fushë-Arrëz sh.a.
		R	Fushë-Arrëz sh.a.	N/A
Shkodër	Vau i Dejës , Bushat, Vig Mnele, Hajmel, Temal, Shllak	U+R	Vau i Dejës U sh.a	N/A
Shkodër	Koplik, Gruemire, Kastrat, Kelmend, Qender, Shkrel	U+R	Shkodër Fshat U sh.a dhe Malësi e Madhe UK sh.a.	N/A
Shkodër	Shkodër, Ana e Malit, Berdicë, Dajc, Guri i Zi, Postribe, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipoje	U+R	Shkodër UK sh.a.	Shkodër UK sh.a.
Kukës	Has, Krumë, Fajza, Gjinaj, Golaj	U+R	Has U sh.a.	N/A
Kukës	Kukës, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Terthore, Shtiqen, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Gryk Caje, Kalis, Surroj, Arren, Kolsh	U	Kukës UK sh.a.	Kukës UK sh.a.
		R	Kukës UK sh.a.	N/A
Kukës	Tropojë, Bajram Curri, Fierzë, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyc,	U+R	Tropojë U sh.a.	N/A
Dibër	Peshkopi/Dibër, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishte, Sllove, Kala e Dodës, Zall Dardhe, Zall Rec, Fushë Cidhen, Arras	U	Peshkopi U sh.a.	Peshkopi U sh.a.
		R	Peshkopi U sh.a.	N/A
Dibër	Peshkopi/Diber, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishte, Sllove, Kala e Dodës, Zall Dardhe, Zall Rec, Fushë Cidhen, Arras	U	Peshkopi U sh.a.	Peshkopi U sh.a.
Lezhë	Lezhe, Shenkoll, Shengjin, Zejmen, Balldren, Kallmet, Blinisht, Dajc, Ungrej, Kolsh	R	Peshkopi U sh.a.	N/A
Korçë	Pogradec, Udenisht, Bucimas, Cerrave, Dardhas, Trebinje, Proptisht, Velcan	U+R	Pogradec UK sh.a.	Pogradec UK sh.a.

11.5.3 Përdoruesit e ujit

Përdorimi i ujit është përcaktuar në nenin 2 si: "shërbimet e ujit së bashku me çdo aktivitet tjetër të identifikuar sipas nenit 5 dhe shtojcës II me ndikim të rëndësishëm në statusin e ujit. Ky koncept zbatohet për qëllimet e NENIT 1 dhe të analizës ekonomike të kryer sipas nenit 5 dhe shtojcës III, pika "b". Neni 9 i Direktivës specifikon se përdorimi i ujit duhet të përfshijë të paktën familjet, bujqësinë dhe industrinë.

Të dhënat kryesore që mund të mblidhen:

- Popullsia e mbuluar nga shërbimi i ujit, duke përfshirë nivelin (shkallën) e mbulimit dhe numrin e lidhjeve të ujit (tabela 11.13).
- Numri i lidhjeve industriale, komerciale dhe institucionale të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (tabela 11.14).

Tabela 11.13: Popullsia e mbuluar nga shërbimet e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

	Popullsia e shërbyer	Mbulimi	Numri i Lidhjeve
Bashkia Pukë UK	2,778	52%	902
Vau i Dejës U sh.a.	5,646	45%	860
Tropojë U sh.a.	7,328	74%	1,330
Lezhë UK sh.a.	33,920	97%	7,996
Pogradec UK sh.a.	58,652	98%	13,310
Shkodër UK sh.a.	89,267	74%	25,156
Pukë fshat	2,347	20%	500
Shkodër (F) U sh.a.	23,364	29%	5,705
Fushë-Arrëz UK sh.a.	1,882	39%	529
Librazhd UK sh.a.	18,370	96%	4,314
Peshkopi U sh.a.	30,963	100%	2,952
Bulqizë U sh.a.	12,104	76%	2,477
Has U sh.a.	8,606	64%	1,215
Kukës UK sh.a.	39,952	100%	4,588

Tabela 11.14: Përdoruesit industrial, komercialë dhe institucionalë të ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë 2015

	Lidhjet Industriale dhe Komerciale të Ujit	Lidhjet Institucionale të Ujit	Lidhjet Industriale dhe Komerciale të Kanalizimeve	Lidhjet Institucionale të Kanalizimeve
Bashkia Pukë UK	163	40	163	40
Vau i Dejës U sh.a.	76	7		
Tropojë U sh.a.	147	19		
Lezhë UK sh.a.	755	35	755	35
Pogradec UK sh.a.	959	76	762	66
Shkodër UK sh.a.	2,397	155	2,292	143
Puke fshat	15	8	16	8
Shkodër (F) U sh.a.	94	42	22	1

	Lidhjet Industriale dhe Komerciale të Ujit	Lidhjet Institucionale të Ujit	Lidhjet Industriale dhe Komerciale të Kanalizimeve	Lidhjet Institucionale të Kanalizimeve
Fushë-Arrëz UK sh.a.	62	13	59	8
Librazhd UK sh.a.	810	67	798	66
Peshkopi U sh.a.	481	56	414	55
Bulqizë U sh.a.	227	43		
Has U sh.a.	125	12		
Kukës UK sh.a.	369	70	369	70

11.6 Kostot financiare të shërbimeve të ujit

Të dhënat financiare në lidhje me shpenzimet e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit u mblodhën nga kompanitë e shërbimeve të ujit që veprojnë në basenin e lumit. Të dhënat e mëposhtme të kostove financiare arritën të mblidheshin:

- Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Këto kosto janë ato që lidhen me ofrimin e shërbimit dhe përfshijnë, ndër të tjera, kostot e punësimit, kostot e energjisë, kostot materiale dhe kostot e punësimit të palëve të treta. Shpenzimet e mirëmbajtjes kanë të bëjnë me mbajtjen e aseteve në kushte të përdorshme gjatë gjithë jetës së tyre ekonomike.
- Shpenzimet kapitale. Këto janë kostot e pagesës së principalit dhe të interesave (dhe kostos së kapitalit sipas rastit) që lidhen me shpenzimet për aktivet që financohet nga jashtë nëpërmjet kredive, obligacioneve, kapitalit dhe gjithashtu mekanizmave të tjerë financiarë. Këto kosto gjithashtu përfshijnë zhvlerësimin vjetor të aseteve fikse ekzistuese të operuara nga ndërmarrjet e ujësjellësit.
- Shpenzimet administrative. Këto lidhen me interesat dhe shpenzimet e tjera financiare të paguara nga kompanitë e shërbimeve për të drejtuar biznesin e tyre të ujit.

Taksa dhe subvencione: Këto përfshijnë taksat e përgjithshme dhe të tjera specifike të paguara nga kompanitë e ujit. Analiza e mëvonshme e rikuperimit të kostos bazuar në kostot ekonomike dhe jo në ato financiare do të duhej të hiqte taksat e përgjithshme dhe transferimet e tjera.

Kostot financiare për shërbimet e ujit dhe kanalizimit për vitin 2015 janë siç tregohet në tabelën 11.15.

Tabela 11.15: Kostot financiare për shërbimet e ujit dhe kanalizimit në Basenin Ujor Drin–Bunë (2015)

Shërbimet e Ujit	000 Lek	000 Euro
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes		
Kostoja e punës	273,464	1,996
Kostot materiale (përfshirë lëndët kimike)	11,464	84
Kostot e energjisë	246,095	1,797
Kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes	35,000	256
Kostoja e shërbimeve të kontraktuara	33,110	242
Kosto të tjera	22,673	166
Kostot kapitale		
Amortizimi	198,952	1,452
Shlyerja e borxhit (principal)	2,520	18
Shpenzimet administrative		

Interesi	3,264	24
Shpenzime të tjera financiare	12,196	89
Tatimet dhe subvencionet		
Taksat dhe detyrimet	2,060	15
Kostot totale financiare për ujin	**840,799**	**6,138**
Shërbimet e Ujërave të ndotura	**000 Lek**	**000 Euro**
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes		
Kostoja e punës	84,019	613
Kostot materiale (përfshirë lëndët kimike)	2,482	18
Kostot e energjisë	12,069	88
Kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes	9,682	71
Kostoja e shërbimeve të kontraktuara	2,435	18
Kosto të tjera	5,937	43
Kostot kapitale		
Amortizimi	87,281	637
Shpenzimet administrative		
Interesi	4	0
Shpenzime të tjera financiare	5,332	39
Tatimet dhe subvencionet		
Taksat dhe detyrimet	914	7
Kostot totale financiare për ujërat e zeza	**210,155**	**1,534**
Shpenzimet totale financiare për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura	**1,050,954**	**7,672**

11.6.1 Kostot e mjedisit dhe burimeve

Shpenzimet e burimeve, përcaktohen si kosto e mundësisë për përdorimin e ujit si një burim i pakët në një mënyrë të veçantë (p.sh. nëpërmjet nxjerrjes ose shkarkimit të ujërave të ndotura) në kohë dhe hapësirë. Ato janë të barabarta me diferencën midis vlerës ekonomike në aspektin e përfitimeve neto të përdorimit të ujit aktual ose të ardhshëm (p.sh. alokimi i lejeve të emetimit ose nxjerrjes së ujit) dhe vlerës ekonomike në aspektin e përfitimeve neto të përdorimit alternativ më të mirë të ujit (tani ose në të ardhmen). Shpenzimet e burimeve lindin vetëm nëse përdorimi alternativ i ujit gjeneron një vlerë më të lartë ekonomike sesa përdorimi aktual ose i parashikuar i ujit në të ardhmen.

Për shkak të aktivitetit relativisht të ulët industrial dhe bujqësor në zonën e basenit ujor dhe disponueshmërisë së burimeve ujore, në këtë analizë nuk janë identifikuar kostot e burimeve.

Kostot mjedisore përbëhen nga kostot e dëmit mjedisor të degradimit të ekosistemit ujor dhe shterimit të shkaktuar nga një përdorim i veçantë i ujit (p.sh. nxjerrja e ujit ose shkarkimi i ndotësve). Mund të bëhet një dallim midis kostove të dëmtimit në mjedisin e ujit dhe atyre që përdorin mjedisin e ujit. Interpretuar në terma të konceptit të vlerës totale ekonomike, mund të argumentohet se kostot e dëmit mjedisor i referohen vlerave të mos përdorimit të përshtatshëm të një ekosistemi ujor funksional, ndërsa shpenzimet për ata që përdorin mjedisin e ujit i referohen vlerave përkatëse të përdorimit.

Në basenin e lumit ka disa raste të ndotjes së ujit për shkak të shkarkimeve të ujërave të ndotura të patrajtuara në lumë. Për fat të keq, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme,

vlera e këtyre kostove të dëmit nuk mund të vlerësohej. Në analizën e rikuperimit së kostos, këto kosto nuk u morën në konsideratë. Nëse dhe kur do të jenë të disponueshme të dhënat e besueshme, kostot mjedisore do të vlerësohen dhe përfshihen në analizën e rikuperimit të kostos ekonomike.

11.6.2 Mekanizmi i rikuperimit të kostos

Rregullimi synon të sigurojë që çmimi të ujit dhe ujërave të ndotura të përshtatshëm në lidhje me cilësinë e shërbimit. Rregullimi i tarifave sipas Udhëzuesit për vendosjen e tarifave nga ana e Entit Rregullator të Ujit të Shqipërisë përbëhet nga:

- Shqyrtimi i kostove;
- Dhënia e stimujve për kompanitë që të përmirësohen shërbimi;
- Strukturimi i procesit të përcaktimit të tarifave; dhe
- Miratimi i tarifave.

Në pajtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", dhe ndryshimet e tij, Enti Rregullator i Ujit është duke kryer këto funksione të rëndësishme rregullative në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri.

Objektivat e Entit Rregullator të Ujit në miratimin e tarifave dhe tarifave të tjera të shërbimit janë si më poshtë:

- Të mbrojë konsumatorët kundër çmimeve të monopolit; dhe
- Të lejojë të licencuarit të mbulojnë shpenzimet e arsyeshme të shkaktuara për të ofruar shërbime efektive, duke përfshirë mundësinë për të arritur një kthim të investimit të tyre, që do të ishte i mjaftueshëm për përmirësime dhe punë të tjera ndërtimore.

Objektivi i dytë është veçanërisht i rëndësishëm pasi shumica e ofruesve të shërbimeve të ujit në Shqipëri ende nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot e tyre aktuale për shkak të niveleve të ulëta tarifore. Prandaj ky është një objektiv i menjëhershëm i rregullimit të tarifave për të arritur së pari mbulimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes dhe më vonë të kostove totale. Autoriteti Rregullator i Ujit, pra, synon të mbështesë arritjen graduale të rikuperimit së plotë të kostos në përputhje me Direktivat e BE-së për Ujërat.

Udhëzuesi për përcaktimin e tarifave specifikon mekanizmat e mëposhtme të përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujit dhe kanalizimit:

11.6.3 Tarifat për shërbimet e ujit

Aty ku ekziston matja (konsumatorët me matës), ERRU do të kërkojë **tarifat me dy pjesë**, prej të cilave:

- Një pjesë është një pagesë që mbulon kostot fikse. Kjo do të mbulohet nga konsumatorët përmes një komponenti tarifor fiks mujor;
- Pjesa tjetër është një pagesë e lidhur me shpenzimet volumetrike (të përdorimit). Një tarifë me dy pjesë ndihmon për të siguruar që një ofrues i shërbimeve nuk i tejkalon ose nuk mbulon shpenzimet fikse nëse vëllimet e shitjeve ose lidhjet e konsumatorëve përfundojnë duke qenë të ndryshme nga ato të parashikuara. Është politika e qeverisë që të gjithë konsumatorët duhet të maten. Aty ku ofruesit e shërbimeve nuk e kanë arritur ende këtë objektiv, ata duhet të propozojnë një tarifë fikse mujore për konsumatorët pa matës (konsumatorë pa matës) dhe një plan për të kaluar në matjen 100%.

Për konsumatorët pa matës, duhet të aplikohet tarifa e sheshtë (konsumatori paguan një çmim të paracaktuar pa një specifikim volumetrik). Kjo tarifë duhet të vendoset në një nivel që nxit konsumatorët të kalojnë në furnizimin me matje.

11.6.4 Tarifat për shërbimet e ujërave të ndotura

- Shpenzimet për shërbimet e ujërave të ndotura përcaktohen nga sasia e ujërave të ndotura të gjeneruara nga secili konsumator. Sasia e ujërave të ndotura do të jetë 100% e sasisë së ujit të konsumuar.
- Vetëm në rastet kur konsumatorët marrin ujë nga një pus ose burime të tjera nevojitet matje shtesë. Është i mundur një përbërës fiks i kanalizimit përveç komponentit volumetrik.
- Një ofrues shërbimi mund të vendosë shpenzime të veçanta për ndotësit e rëndë. Përveç kësaj, mund të kërkohen tarifa të veçanta për shembull sanitizimi në vend. Ata duhet të mbulojnë kostot reale.

Nivelet aktuale të tarifave që zbatohen nga Shërbimet e Ujësjellësit në Basenin Ujor Drin–Bunë janë paraqitur në Tabelën 11.16.

Shërbimet e ujit/ujërave të ndotura marrin të ardhurat e tyre operacionale duke përdorur strukturën e mësipërme tarifore të aplikuar në sasitë e shërbimeve të ofruara. Për më tepër, krahas mekanizmit të mbulimit të kostos së mësipërme, disa nga ofruesit e shërbimeve të ujit përfitojnë nga subvencionet për operacione. Këto subvencione plotësojnë të ardhurat financiare të ndërmarrjeve të ujit që kontribuojnë në rimëkëmbjen e kostos financiare.

Duke marrë parasysh burimet e mësipërme financiare, të ardhurat financiare në vijim janë marrë nga shërbimet e ujësjellësit në basenin e lumit në vitin 2015 (Tabela 11.17).

Tabela 11.16: Tarifat aktuale të aplikuara nga ndërmarrjet e ujësjellësit në Basenin Ujor Drin–Bunë[201]

Ujësjellësi	Ujë i pijshëm (lek/m³)			Tarifa e Shërbimit (lek/muaj)			Ujërat e ndotura (lek/m³)		
	Familje	Institucione	Private	Familje	Institucione	Private	Familje	Institucione	Private
Bulqizë	17	55	75	100	100	100			
Fushë-Arrëz									
Has	25	60	80						
Kukës	25	60	80				7	15	20
Lezhë	58	135	145	200	200	200	18	22	27
Librazhd	38	100	100				13	22	23
Peshkopi (Dibër)	27	65	85				10	15	18
Pogradec	22/62	37/111	37/111	200+ 100	400+ 100	400+ 150	11/33	12/36	12/36
Pukë	35	130	140	100	100	100	8	16	16
Pukë Fshat									
Shkodër	40	110	110	100	100	100	15	20	20
Shkodër Fshat	50	120	120						
Tropojë	19	60	80						

Tabela 11.17: Të hyrat nga shërbimet e ujit në basenin ujor Drin–Bunë 2015

Të ardhurat nga shërbimet e ujit (000 lek)	Të ardhurat nga shërbimet e ujërave të zeza (000 lek)	Të ardhurat totale operative (000 lek)	Subvencionet (000 lek)	Totali i të ardhurave financiare (000 lek)	Totali i të ardhurave financiare (000 euro)
581,721	119,979	701,700	81,710	783,410	5,719

11.6.5 Shkalla e rikuperimit të kostos

Kthimi i përgjithshëm i kostove është shkalla në të cilën kostot e sigurimit të shërbimit të ujit mbulohen nga tarifat për përdoruesit e ujit dhe mekanizmat e tjerë të rikuperimit së kostos.

Shkalla e rikuperimit të kostos vlerësohet në këtë raport si:

Norma e rikuperimit të kostos = të ardhurat totale/kostot totale x 100 [%]

Shkallët e rikuperimit të kostos vlerësohen si për kostot financiare ashtu edhe për ato ekonomike për ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura në basenin ujor. Vlerësimet bazohen në të dhënat e

[201] Burimi: Enti Rregullator Shqiptar i Sektorit të Shpërndarjes dhe Përpunimit të Ujit dhe Ujërave të Ndotura.

vitit 2015 nga kompanitë e shërbimeve të ujësjellësit që ofrojnë shërbime ujësjellës-kanalizime në zonën e Basenit Ujor.

11.6.6 Rikuperimi i kostove financiare

Shkalla e rikuperimit të kostove financiare merr në konsideratë të gjitha kostot financiare të kryera nga ofruesit e shërbimeve dhe të gjitha të ardhurat, duke përfshirë subvencionet.

Çdo ndërmarrje ujësjellësi në basenet ujore, me të dhëna të ndryshme financiare, raporton një normë të ndryshme të rikuperimit së kostos financiare. Në nivelin e basenit ujor, shifrat janë siç tregohet në tabelën 11.18 më poshtë.

Tabela 11.18: Rikuperimi i kostove financiare në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

Kostot financiare	(000 Lek)
Shërbimet e Ujit	
Kostot totale financiare - Uji	840,799
Shërbimet e ujërave të ndotura	
Kostot totale financiare - Ujërat e ndotura	210,155
Totali i kostove financiare - uji dhe ujërat ndotura	**1,050,954**
Të ardhurat financiare	
Shërbimet e ujit	
Shuma totale e faturave të ujit - totali	581,721
Shërbimet e ujërave të ndotura	
Shuma totale e faturave të Kanalizimeve - totali	119,979
Subvencioni për Operacion	81,710
Të ardhurat totale financiare - Ujërat dhe ujërat e ndotura	**783,410**
Shkalla e rikuperimit të kostos financiare (%)	**75%**

11.6.7 Kthimi i kostove të kostove ekonomike

Analiza e rikuperimit të kostove ekonomike për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura u krye në bazë të kostove financiare të mësipërme, por u zbatuan korrigjimet e mëposhtme:

- Kostot materiale dhe të energjisë konsideroheshin neto nga 20% të TVSH-së
- Kostoja e punës u konsiderua neto nga kontributet në vijim:
  - Kontributet e kujdesit shëndetësor të punonjësve: 1.7%
  - Kontributet e sigurimeve shoqërore të punonjësve: 9.5%
  - Kontributet e kujdesit shëndetësor të punëdhënësit: 1.7%
  - Kontributet e sigurimeve shoqërore të punëdhënësit: 15%
- Taksat dhe subvencionet e ndryshme nuk u morën në konsideratë në rikuperimin e kostos ekonomike.
- Të ardhurat financiare u ulën në nivelin neto 20% të TVSH-së
- Subvencionet nuk u morën në konsideratë
- Kostot e resurseve (burimeve) dhe mjedisit u konsideruan me vlera 0.

Rezultatet e analizës së rikuperimit së kostove ekonomike janë paraqitur në Tabelën 11.19 më poshtë.

Tabela 11.19: Rikuperimi i kostos ekonomike në Basenin Ujor Drin–Bunë, 2015

Kostot Ekonomike	(000 lek)
Shërbimet e Ujit	
Totali i kostove ekonomike - Uji	730,434
Shërbimet e ujërave të ndotura	
Totali i kostove ekonomike - Ujërat e ndotura	186,729
Të ardhurat ekonomike	
Shërbimet e ujit	
Shuma totale e faturave të ujit	484,768
Shërbimet e ujërave të ndotura	
Shuma totale e faturave të kanalizimeve	99,982
Shkalla (norma) e rikuperimit të kostos ekonomike - uji	66%
Shkalla (norma) e rikuperimit të kostos ekonomike - ujërat e ndotura	54%
Shkalla (norma) e rikuperimit të kostos ekonomike - uji dhe ujërat e ndotura	64%

11.7 Përfundime

Duke marrë parasysh të dhënat e vlerësuara më lart (normat e rikuperimit të kostos financiare dhe ekonomike), mund të shënohet një mbulim i pakënaqshëm i kostove. Shkalla e rikuperimit të kostos financiare është 75%, ndërsa norma ekonomike është më e ulët (64%) në kontekstin e kostove të humbura të burimeve dhe të mjedisit.

Normat e rikuperimit të kostos për ofruesit lokal të shërbimeve të ujit janë shumë të ndryshme. Në disa raste, normat e rikuperimit të kostos së ndërmarrjeve individuale të ujit janë shumë më poshtë se vlera mesatare në basenin ujor Drin–Bunë (Vau i Dejës U sh.a. – 25%, Has U sh.a. – 34%), në raste të tjera këto norma arrijnë në vlera afër 100% (Peshkopi U sh.a. – 87%, Librazhd UK sh.a. – 83%). Zakonisht ndërmarrjet më të mëdha të shërbimeve të ujit kanë norma më të mëdha të rikuperimit të kostos.

Norma e rikuperimit të kostove financiare është nën 100% në secilin ofrues të shërbimeve përkundër subvencioneve operacionale që ata marrin. Një nga arsyet për këtë humbje është se ka hendek midis konsumit të faturuar të ujit dhe inputit të sistemit, duke nënkuptuar që ekziston një sasi e caktuar e humbjeve.

Niveli i ulët i normës së rikuperimit së kostos mesatare të basenit të lumit tregon dobësi në mekanizmin e rikuperimit së kostove (kryesisht në procedurat e vendosjes së tarifave, por jo vetëm), i cili nuk është i orientuar në parimin e pagimit të ndotësve, por më shumë në përballueshmërinë e tarifave dhe në performancën operacionale të ofruesve të shërbimeve të ujit.

Enti Rregullator Shqiptar i Furnizimit me Ujë: *"Metodologjia e përcaktimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe trajtimin dhe largimin e ujërave të ndotura bazohet në katër objektiva të politikës tarifore:*

- Mbulimi i kostove: së pari mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes hap pas hapi deri në mbulimin e kostos totale të kompanisë lidhur me kryerjen e veprimtarisë së saj në ofrimin e shërbimeve përkatëse.
- Efikasiteti i menaxhimit
- Përballueshmëria nga konsumatorët në nevojë, dhe
- Efikasiteti mjedisor"

Megjithatë, rikuperimi i kostove mjedisore dhe burimeve si shpenzime të brendshme nuk aplikohet në tarifa.

Si përfundim, ekziston nevoja për të ndryshuar politikat aktuale të çmimeve për të përmbushur kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit. Marrëveshjet e tanishme paraqesin detyrime nga sipërmarrësit e ujit dhe kanalizimeve që nuk mbulojnë shpenzimet e këtyre shërbimeve. Ky sistem nuk merr parasysh parimet dhe objektivat e Direktivës dhe dispozitat e nenit 9 të Direktivës Kuadër të Ujit në veçanti.

Një çështje tjetër që lidhet me tarifat është përshtatja e tyre gjatë kohës kur kostot në rritje duhet të ndiqen nga ndryshimet e duhura në tarifa. Enti Rregullator deklaron se: "*Asnjë tarifë ose pjesë e saj nuk mund të ndryshohet më shpesh se një herë në vit "por, në praktikë, shërbimet e ujësjellësit nuk aplikojnë çdo*

vit për rregullime tarifore. Në këtë rast, tarifat e miratuara në të kaluarën nuk mund të mbulojnë kostot aktuale, të rritura.

Në rastin e normës së rikuperimit të kostos ekonomike, vlerësimet nuk përfshijnë kostot e burimeve dhe mjedisit. Kjo është për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme për këto lloje shpenzimesh. Në zhvillimin e PMBU-ve (Planet e menaxhimit të baseneve ujore), duhet të bëhen sugjerime mbi një sistem të përshtatshëm për grumbullimin dhe regjistrimin e të dhënave (nivel kombëtar/rajonal), pasi analiza e rikuperimit të kostos në të ardhmen nuk do të konsiderojë çështjen e mungesës së të dhënave.

Kostot e rikuperimit të shërbimeve të ujitjes nuk janë analizuar. Kjo është për shkak të mungesës së të dhënave financiare të ofruesve të shërbimeve. Nëse do të jenë në dispozicion të dhëna të besueshme, vlerësimi i normave të rikuperimit mund të shtrihet në këto shërbime në analizat e ardhshme.

12. Programi masave

12.1 Hyrje

DKU-ja e BE-së kërkon ngritjen e një Programi Masash (PoM) për çdo basen ujor, ose për një pjesë të një baseni ujor brenda territorit të tij, ku të merren parasysh të gjitha rezultatet e analizave të kërkuara në nenin 5[202] për të arritur objektivat mjedisorë të përcaktuar në nenin 4 (shihni seksionin 10). Neni 11 i DKU-së së BE-së përcakton se çdo program masash duhet të përfshijë "masat bazë" dhe kur është e nevojshme, edhe "masa plotësuese". Tabela 12 më poshtë, paraqet listën e përgjithshme të këtyre masave.

Tabela 12.1: Renditja e masave "bazë" dhe "plotësuese" të përcaktuara në nenin 11 të DKU-së së BE-së

Masat bazë	
a)	Masat e kërkuara për të zbatuar legjislacionin e Komunitetit Evropian për mbrojtjen e ujit, duke përfshirë masat e nevojshme të përcaktuara në legjislacion në nenin 10 (qasja e kombinuar për përcaktimin dhe shpërndarjen e burimeve) dhe masat e kërkuara nga Direktivat "bija" të DKU-së (të përcaktuara në pjesën A të shtojcës VI dhe në DKU-në e BE-së).
b)	Masat e konsideruara si të përshtatshme për qëllimet e rikuperimit të kostove për shërbimet e ujit (neni 9)
c)	Masat për promovimin e përdorimit eficient dhe të qëndrueshëm, për të shmangur kompromentimin e arritjes së objektivave të përcaktuara mjedisore (neni 4)
d)	Masat për të përmbushur kërkesat e ujërave që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm, duke përfshirë masat për ruajtjen e cilësisë së ujit për të reduktuar nivelin e trajtimit nëpërmjet filtrimit për prodhimin e ujit të pijshëm (neni 7).
e)	Kontrollet e nxjerrjes së ujit të ujërave të ëmbël sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, dhe rrethimi i ujërave të ëmbël sipërfaqësorë në formë rezervuari.
f)	Kontrollet, duke përfshirë kërkesën për autorizim paraprak për mbushjen ose shtimin artificial të trupave ujorë nëntokësorë.
g)	Masat për rregullimin e pikave të shkarkimit që mund të shkaktojnë ndotje (nenet 10 dhe 16).
h)	Masat për të parandaluar ose kontrolluar futjen e ndotësve të burimeve.
i)	Masat për çdo ndikim tjetër të pafavorshëm dhe të rëndësishëm për statusin e ujit të identifikuar në nenin 5 në shtojcën II, veçanërisht masat për sigurimin e përputhshmërisë së kushteve hidromorfologjike të trupave ujorë me arritjen e statusit të kërkuar ekologjik ose kushteve të mundshme ekologjike për trupat ujorë të përcaktuar si artificialë ose tepër të modifikuar.
j)	Ndalimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta të ndotësve në ujërat nëntokësorë.
k)	Masat për eliminimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë nga substancat e specifikuara në listën e substancave prioritare (neni 116)
l)	Masat e kërkuara për parandalimin e humbjeve domethënëse të ndotësve nga instalimet teknike, dhe për parandalimin dhe/ose reduktimin e incidenteve të ndotjes aksidentale si rezultat i përmbytjeve për shembull.
Masat Plotësuese [203]	
Këto masa përfshijnë: i. instrumente legjislative; ii. instrumente administrative; iii. instrumente ekonomike dhe fiskalë; iv. marrëveshjet e negociuara mjedisore; (v) kontrollet e emetimeve; (vi) kodet e praktikës së mirë; (vii) rikrijimi dhe restaurimi i ligatinave; viii. kontrollet e nxjerrjeve; ix. masat për menaxhimin e kërkesave, ndër të tjera, nxitjen e prodhimit të përshtatur bujqësor si të mbjellat që kërkojnë pak ujë në zonat e thata; x. eficienca dhe ripërdorimi; xi. projektet ndërtimore; xii. impiantet e shkripëzimit; xiii. projektet rehabilituese; xiv. mbushja artificiale e akuiferëve; xv. projektet edukuese; xvi. projektet kërkimore, zhvillimore dhe demonstruese.	

Me qëllim realizimin e vizionit për një periudhë 10-vjeçare e në vazhdim për sektorin e ujit, janë identifikuar qëllime të cilat janë shprehur në

[202] Neni 5 përfshin analizën e karakteristikave të baseneve ujore, një vlerësim të ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe një analizë ekonomike për përdorimin e ujit.

[203] Lista joekskluzive e masave plotësuese që shtetet anëtare brenda çdo rrethi të basenit ujor mund të zgjedhin të miratojnë si pjesë të programit të masave të kërkuara sipas nenit 11 (4) të DKU-së të BE-së.

funksion të tri shtyllave të sektorit të ujit: **përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji**. Këto tri shtylla dhe qëllimet e tyre përkatëse përfshihen në Objektivat e Cilësisë së Mjedisit për Basenin Ujor, siç përshkruhet në Seksionin 10.

Për arritjen e objektivave për sektorin e ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë, gjatë dekadës së ardhshme dhe në vazhdim, janë propozuar një sërë masash të nevojshme në përputhje me DKU-në e BE-së, e cila pasqyron edhe Planin Kombëtar për Sektorin e Ujit (PKSU)[204].

Këto masa për Basenin Ujor Drin–Bunë, ndahen në dy kategori:

- Masat bazë, të cilat mund të përfshijnë studime konkrete, dhe që mund të bashkëfinancohen ose mbështeten nga buxheti i shtetit, donatorët dhe fondet vendore.

- Masat plotësuese, të cilat mund të përfshijnë studimet e nevojshme bazë ose të fizibilitetit, të cilat mund të mbështeten nga buxheti i Shtetit, donatorët ose fondet vendore.

- Masat janë hartuar në përputhje me objektivat mjedisorë (seksioni 10) duke pasqyruar shtatë kategoritë e ndryshme të OM-ve, ku secila prej tyre përfshin masa bazë dhe plotësuese.

1. Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjes së drejtë, maksimizimit të përfitimeve ekonomike duke respektuar kushtet mjedisore dhe parimet e menaxhimit të qëndrueshëm, që përfshijnë masa për:

a) Përmirësimin e furnizimit me ujë;

b) Përmirësimin e grumbullimit të ujërave të ndotur;

c) Ujitjen e tokave bujqësore;

d) Përmirësimin e rrjetit të kullimit për tokat e ujitura bujqësore;

e) Zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor në zonat e përcaktuara;

f) Përdorimin e energjisë hidrike potenciale;

g) Përmbushjen e kërkesave industriale për ujë.

2. Ruajtja dhe arritja e statusit kimik dhe ekologjik minimal "i mirë" për trupat ujorë sipërfaqësorë që kanë statusin "mesatar", "i keq" ose "shumë i keq". (lumenj, liqene, ujëra kalimtare, bregdetare, artificiale, dhe tejet të modifikuar). Masat specifike do të kenë rezultatet e mëposhtme:

a) Përmirësimi i monitorimit të të gjithë trupave ujorë;

b) Përmirësimi i statusit ekologjik dhe cilësisë kimike për të gjitha llojet e trupave ujorë;

c) Prezantimi i praktikave të mira bujqësore, monitorimi dhe vlerësimi;

d) Reduktimi i përdorimit të paligjshëm të inerteve dhe zhavorr lumor;

e) Reduktimi i ndotjes nga përdorimi i pesticideve në bujqësi.

3. Parandalimi i ndotjes për të shmangur uljen e cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe për arritjen e një statusi të mirë kimik të TUN-eve, në mbështetje të OM-ve, që kanë dy nën aktivitete:

a) Eliminimi/reduktimi i sasisë së substancave dhe nitrateve të rrezikshme që hyjnë në trupat ujorë;

b) Rritja e efikasitetit të trajtimit të ujërave të ndotura për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësorë nga burimet urbane dhe industrial të ndotjes.

4. Ruajta dhe arritja e cilësisë minimale të mirë për ujërat e larjes (të brendshme, bregdetare dhe kalimtare), e cila kërkon:

a) Rritja e numrit të stacioneve monitoruese bregdetare për elemente mikrobiologjike;

b) Rritja e numrit të parametrave monitorues sipas kërkesave të Direktivave Evropiane.

5. Ulja e rrezikut të përmbytjeve dhe humbjeve për jetën, mjetet e jetesës, shëndetin, ekonominë, asetet kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve, i cili ka dy nënaktivitete:

a) Ulja e numrit të banorëve të prekur nga përmbytjet;

b) Reduktimi i tokës bujqësore të prekur nga përmbytjet.

6. Përmirësimi i sigurisë së digave të ujitjes.

7. Ruajtja dhe/ose ulja e nivelit të erozionit në lumenj, e nevojshme për:

a) zona më pak vulnerabël (20% e territorit);

b) zona tepër të rrezikuara (70% e territorit).

[204] Plani Kombëtar për Sektorin e Ujit (PKSU) përcakton vizionin, qëllimet dhe objektivat e sektorit në vitin 2030, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (agjenda 2030) dhe cikli i hartimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore, që i referohen Direktivës Kuadër të Ujit.

Programi i Masave është zhvilluar duke marrë parasysh integrimin gjinor[205] në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9970/2007 për barazinë gjinore në shoqëri. Për të siguruar një qasje që merr parasysh çështjet gjinore për sa i përket menaxhimit të ujërave në Basenin Ujor Drin–Bunë, përfshihen tregues kyç dhe objektiva për të gjitha masat, me qëllim vlerësimin e shkallës në të cilën gratë dhe burrat marrin pjesë në ekonomi dhe në vendimmarrje në sektorin publik dhe në shoqërinë civile për sa i përket menaxhimit të ujërave.

Tabela 12.2: Treguesit kyç të Integrimit Gjinor në Programin e Masave[206]

Lloji i masave	Treguesi kyç	Zbatimi i PM-ve
Plotësuese	Përfaqësimi në studimet e fizibilitetit	>30% e të dyja gjinive
	Përfaqësimi në pozicione vendimmarrëse në sektorin publik	>30% e të dyja gjinive[207]
	Përfaqësimi në pozicione vendimmarrëse në shoqërinë civile	
Bazë	Përfaqësimi në zhvillimin e infrastrukturës	>30% e të dyja gjinive

12.2 Plan veprimi

Institucionet kryesore dhe mbështetëse kanë nevojë për një plan të qartë për të bashkëpunuar, dhe për t'i koordinuar burimet me qëllim arritjen e menaxhimit efikas të ujit në Basenin Ujor Drin–Bunë në të ardhmen.

Në mënyrë që të zgjidhen problemet aktuale dhe ato në të ardhmen në Basenin Ujor, plani i veprimit duhet të përfshijë një përshkrim të aktiviteteve prioritare, afatin, kostot, dhe detyrimet dhe/ose përgjegjësitë në nivel kombëtar, rajonale dhe vendore. Është i nevojshëm treguesi i burimit financiar, megjithëse emrat e donatorëve ose IFN-ve nuk dihen në këtë fazë. Financimi do të vijë si hua e bashkëfinancuar me donatorët ose nga fondet vendore.

Tabela 12.3 më poshtë paraqet afatin, kostot e llogaritura dhe përgjegjësinë institucionale për zbatimin e Programit të Masave në Basenin Ujor Drin–Bunë gjatë periudhës 2021-2033 të ndarë në masa "bazë" dhe "plotësuese" për një periudhë afatshkurtër, afatmesme, dhe afatgjatë.

Diskutim mbi Planin e përkohshëm të Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë, në 12 dhjetor 2016, në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë (konsultimi i përbashkët në nivel të lartë dhe nivel rajonal).

- Takimi në Prefekturën e Shkodrës në kuadër të Basenit Ujor mbi Planin e përkohshëm të Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë, në datën 12 shkurt 2017 në ambientet e Prefekturës së Shkodrës (konsultimi në nivel rajonal).
- Takime me përfaqësues të OJQ-ve, në 20 dhe 24 mars 2017.

13.3.1.1 Takimi 1: Diskutim mbi draftplanin e Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë

Takimi u organizua nga konsorciumi më 12 dhjetor 2016, në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë. Objektivat e takimit ishin:

- Të prezantojë dhe diskutojë me palët e interesit në nivel kombëtar mbi konceptin themelor të MIBU (Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore) dhe PMBU (Plani i Menaxhimit të Baseneve Ujore) si procese që promovojnë zhvillimin e koordinuar dhe menaxhimin e ujit në mënyrë që të maksimizohet mirëqenia ekonomike dhe sociale në një mënyrë të arsyeshme pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore, të cilat duhet absolutisht të merren në konsideratë,

- Të paraqesë gjetjet paraprake dhe konkluzionet e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë.

- Për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga aktorët pjesëmarrës dhe për të mbledhur pikëpamjet e tyre në lidhje me aspektet e paraqitura.

- Gjatë takimit u ngritën pyetje dhe komente lidhur me temat e sipërpërmendura. Më poshtë do të jepen disa nga përgjigjet, si dhe komentet e vëzhgimet e marra:

- Shpjegimet e elementeve dhe i komponentëve kryesorë që janë marrë në konsideratë për hartimin e Raportit

- Të gjitha direktivat ndërkombëtare dhe kombëtare ishin duke u studiuar dhe matur gjatë fazës përgatitore të Raportit.

- Analiza ekonomike përfshihet në raport, për shkak se rezultatet janë të nevojshme për të kuptuar kostot aktuale të shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve dhe nivelin e shërbimit të ofruar.

- Erozioni përmendet në raport. Ka të dhëna të mbledhura për këtë aspekt që do të përpunohen në të ardhmen.

- Humbjet e shkaktuara të ujit janë marrë parasysh dhe është hartuar një raport i detajuar e i konsoliduar mbi çështjet problematike të ujit dhe menaxhimit të tyre. Gjithashtu, përmendet se studimet/projektet e financuara nga BE duhet të mbulojnë financiarisht këtë aspekt të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.

- Statusi ekologjik i ujërave sipërfaqësorë aktualisht nuk matet për shkak të mungesës së përvojës në vend në qasjen metodologjike. Rëndësia e "vlerësimit biologjik" të shpejtë u dha në mënyrë që audienca të kuptojë se ky është një hap paraprak i kërkuar për të identifikuar ujërat sipërfaqësore të ndotur.

- Gjatë konsultimit u vërejt se ekziston pakënaqësi ndërmjet opinionit të qeverisë qendrore dhe realiteteve lokale në lidhje me nivelin administrimit të basenit ujor. Disa nga vështirësitë e përshkruara mund t'i përkasin krijimit së fundmi (tremujori i fundit i vitit 2015) të strukturave institucionale të përshkruara më sipër. Raporti mashkull - femër në takim ishte 66%/34%.

13.3.1.2 Takimi 2: Takimi në Prefekturën e Shkodrës në kuadër të Planit të Përkohshëm të Menaxhimit të Basenit Ujor të Drin–Bunës

Takimi u zhvillua më 12 shkurt 2017 në ambientet e Prefekturës së Shkodrës. Objektivat e takimit ishin:

- Të prezantojë dhe diskutojë me aktorët vendorë konceptin bazë të MIBU (Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore) dhe PMBU (Plani i Menaxhimit të Baseneve Ujore), si procese që promovojnë zhvillimin e koordinuar dhe menaxhimin e ujit në mënyrë që të maksimizojë mirëqenien ekonomike dhe sociale në një mënyrë të arsyeshme, pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore, të cilat duhet absolutisht të merren në konsideratë,

- Të prezantojë përfundimet dhe konkluzionet paraprake të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë, si dhe t'iu përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga palët e interesuara pjesëmarrëse.



- Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e ekipit të projektit mbajtën një prezantim lidhur me planin e përkohshëm të menaxhimit të basenit Drin–Bunë dhe integrimin e tij në konceptin më të gjerë të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore. Gjatë prezantimit u ngritën disa pyetje dhe komente, të cilat u përgjigjën dhe/ose u theksuan si më poshtë:

- Gjatë fazës përgatitore për draft PMBU-në, a ka ndonjë udhëzues të aktiviteteve të biznesit dhe private/lokale përgjatë basenit të lumit? Përgjigja: Plani i menaxhimit bazohet në: Konsiderata të hotspoteve të ndërmarrjeve aktive dhe jo aktive private, aktiviteteve përfshirë zonën industriale dhe urbane dhe rezultatin e tyre në ndotjen urbane, si dhe në një tregues të aktivitetit privat ku përdoren burime ujore natyrale të cilat përfundojnë duke e ndotur mjedisin (gjë e gjallë, përpunim lëkure etj.).

13.3.1.3 Angazhimi i OJQ-ve

Para takimeve me OJQ-të u organizua një listë me të gjitha OJQ-të përkatëse me fushëveprime të ndryshme që mund të jenë të dobishme për zhvillimin e PMBU-së. Disa nga OJQ-të u janë përgjigjur kërkesave për organizime takimi.

Takimet u organizuan më 20 dhe 24 mars 2017 në zyrat e tyre përkatëse. Përfaqësuesit e ekipit bënë një prezantim të shkurtër të planit të menaxhimit të basenit ujor, me një fokus kryesor në objektivin dhe qëllimin e projektit. Në përgjithësi, ata mbështetin planin e menaxhimit të ujit dhe pajtohen me qasjen, por ata gjithashtu bënë disa sugjerime, siç tregohet në tabelën 13.3 më poshtë.

Tabela 13.3: Pyetjet dhe përgjigjet e OJQ-ve

Pyetje/sugjerime	Përgjigje
Meqë uji është një aset i pazëvendësueshëm, a mund të eksportohet? Kjo mund të rrisë të ardhurat dhe gjithashtu mund të ndihmojë vendet e tjera që kanë nevojë për ujë.	Kjo është një çështje që plani i menaxhimit të ujit nuk mund të japë një përgjigje të saktë për shkak se, së pari ne duhet të përcaktojmë nëse uji është produkt apo burim. Ky është një vendim që duhet të merret nga qeveria dhe komuniteti i Shqipërisë.
Pyetja e ngritur është se përpara se ne të përcaktojmë vizionin a është vlerësuar statusi aktual dhe i vërtetë i basenit?	Është bërë një inventar i përgjithshëm i baseneve dhe kjo strategji është si një çadër dhe më pas, do të hartohen plane individuale të menaxhimit.
Si do të menaxhohet uji?	Menaxhimi i ujit është paraqitur në strategjinë e finalizuar në bazë të: - uji për njerëzit; - uji për ushqimin; - uji për mjedisin; - uji për industrinë. Problemet individuale me të cilat përballet çdo basen duhet të jenë
Përveç studimit, nevojitet edhe një demonstrim në praktikë dhe monitorim.	
Si prioritet, duhet të ketë ujë të pijshëm për njerëzit, siç tregohet në strategjinë tuaj.	

Pyetje/sugjerime	Përgjigje
A është amortizuar sistemi i ujitjes?	pjesë e planit të menaxhimit të çdo baseni.
Ka shumë mungesa të ujit të pijshëm në shumë zona.	Uji duhet të jetë një burim natyror dhe një shërbim komuniteti.

13.3.2 Konsultimet e fazës 3 dhe fazës 4 (informatorët kryesorë dhe grupet e fokusit)

Procesi i angazhimit të palëve të interesit përfshinte intervistimin e një numri grupesh të fokusit dhe informatorëve kryesorë për çështjet e ujit. Veçanërisht gratë, i përkasin një grupi që ndikohet direkt nga menaxhimi i ujit. Grupet e tjera që ishin në qendër të këtij procesi të angazhimit të palëve të interesuara janë minoritetet të tilla si pakicat rome ose egjiptiane, të moshuarit dhe informatorë të tjerë të rëndësishëm si fermerët, të cilët përdorin dhe menaxhojnë ujin dhe punonjësit e shëndetësisë, të cilët gjithashtu kanë nevojë thelbësore të përdorimit të ujit në procesin e tyre të përditshëm të punës.

Qëllimi i intervistave të informatorëve kryesorë ishte mbledhja e informacionit cilësor nga një individ i cili ka njohuri të thellë për një lëndë apo fushë të caktuar në fjalë. Intervistat me informatorin kryesor do të kryhen në secilën komunë; Megjithatë, çështjet specifike me të cilat përballen fushat e ndryshme të projektit do të diktojnë vendndodhjen dhe numrin e saktë të intervistave. Intervistat e informatorëve kryesorë u zhvilluan kryesisht në nivel rajonal dhe lokal për të arritur informacionin më të mirë.

Janë organizuar një sërë takimesh të grupeve të fokusit me qëllim të targetimit të audiencave të ndryshme në fusha të ndryshme të projektit. Grupet e ndryshme të fokusit u zgjodhën në bazë të nivelit të tyre të pozicionit të interesit, margjinalizimit, specialistëve të informacionit ose aftësisë për të ndikuar në procesin e planifikimit të projektit.

Grupet e margjinalizuara në nevojë janë individë ose komunitete të cilët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj margjinalizimit për shkak të gjinisë, moshës, racës, fesë, paaftësisë së jetesës, ose vendndodhjes. Me këto grupe u organizua një takim për anëtarët e shoqërisë, u dëgjuan dhe u lejuan diskutime të hapura rreth projektit, qëllimit dhe sugjerimeve të tij. Në çdo komunë të zonës së studimit të gjitha grupet e margjinalizuara si gratë, të moshuarit, prodhuesit, të moshuarit dhe grupet bujqësore të subvencionuara u konsultuan për mendimet e tyre. Në çdo komunë të madhe u kryen diskutime në grupet e grave dhe të moshuarve dhe grupeve të tjera vulnerabël si me prodhuesit bujqësorë në vende të caktuara në fshat u identifikuan grupe specifike të margjinalizuara.

Ekipi i projektit i udhëhoqi pjesëmarrësit për të hapur një sërë pyetjesh që kanë të bëjnë me këtë temë. Të gjitha informatat janë regjistruar dhe gjetjet kryesore janë përmbledhur në këtë kapitull. Numri i përgjithshëm i personave të kontaktuar në të dyja basenet e lumenjve është 67, nga të cilat 30 janë gra. Në basenin e lumit Drin–Bunë, nga 24 persona të kontaktuar, 12 ishin gra. Numri i përgjithshëm i intervistave është i ndarë në tabelën 13.4

Tabela 13.4: Grupet e fokusit dhe informuesit kryesorë në basenin ujor Drin–Bunë

Baseni	Qyteti	Njësia Administrative	Fokus Grupi ose informatorët kryesorë	Numri i të intervistuarve
Drin–Bunë	Shkodër	Shirq	Komuniteti rom	
			Të moshuarit	3
			Gratë	3
			Fermerët	2
			Punonjësit e shëndetësisë	2 (2 gra)
		Dajç	Komuniteti Rom	1
			Të moshuarit	2
			Gratë	3
			Fermerët	3 (1 grua)
			Punonjësit e shëndetësisë	1 (1 grua)
	Lezhë	Gjadër	Komuniteti Rom	
			Të moshuarit	1

Baseni	Qyteti	Njësia Administrative	Fokus Grupi ose informatorët kryesorë	Numri i të intervistuarve
			Gratë	2
			Fermerët	1
			Punonjësit e shëndetësisë	

Shpërndarja e grave në numrin e intervistave të bëra është 45% e totalit, me një përfaqësim të mirë në secilin basen. Për basenin ujor Drin–Bunë, përfaqësimi i femrave ishte 50%. Siç shihet në tabelën e mësipërme, gratë kanë marrë pjesë në këtë proces jo vetëm për të diskutuar çështjet gjinore, por edhe si punonjës shëndetësie dhe fermerë.



Figura 13.2: Pjesëmarrja e grave në fokus grupet ose si informatorë kryesorë në basenin ujor Drin–Bunë

13.3.3 Rezultatet dhe çështjet kryesore

Në përgjithësi, shumica e qyteteve të kontaktuara në këtë proces të palëve të interesuara kanë qasje të kufizuar në ujë. Orari i furnizimit me ujë në shtëpi varion nga 2–12 orë në ditë dhe është edhe më i kufizuar gjatë periudhës së verës, që është një sezon i thatë në Shqipëri.

Table 13.5: Problemet kryesore

Baseni	Qyteti	Njësia Administrative	Furnizimi me ujë në shtëpi (Orët mesatare)	Problemet me furnizimin me ujë
Drin–Bunë	Shkodër	Shirq	0 orë	Banorët përmes përdorimit të puseve zgjidhin personalisht mungesën e furnizimit me ujë, ujë i cili, megjithatë, nuk është i pijshëm.
		Dajç	0 orë	Nuk ka shërbim të furnizimit me ujë. Popullsia ka ndërmarrë hapa për këtë problem duke hapur puse personale në shtëpinë e tyre. Nga analizat e kryera ky ujë nuk është i pijshëm sepse është i pasur me nitrate. Nga një studim eksperimental i kryer nga qendra shëndetësore mbi banorët, përdorimi i këtij uji lidhet drejtpërdrejt me probleme të ndryshme shëndetësore.
	Lezhë	Gjadër	6 orë	Furnizimi me ujë ndodh dy herë në ditë, për rreth 3 orë

				secila. Kjo mungesë është një shqetësim serioz për fermerët lokalë, të cilët kanë investuar personalisht me hapjen e puseve private në vendin e tyre. Në të njëjtën kohë, ata gjithashtu përmendin mungesën e funksionimit të kanaleve të ujitjes.

Në Tabelën 13.6 më poshtë identifikohen çështjet në bazë të grupeve të veçanta, me fokus të veçantë te gratë dhe fermerët, por gjithashtu identifikohen edhe grupe të tjera.

Tabela 13.6: Çështjet kryesore të grupeve të veçanta

Baseni	Qyteti	Njësia Administrative	Grupi i fokusit ose informatorët kryesorë	Çështjet kryesore
Drin–Bunë	Shkodër	Shirq	Të moshuarit	Numri i të moshuarve në vitet e fundit ka ndryshuar që kur fëmijët e tyre duan të jetojnë me ta. Ata marrin pensione pleqërie nga qeveria, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e nevojshme. Disa prej tyre ndihmohen ekonomikisht nga fëmijët që punojnë në vende të tjera. Problemi është shërbimi i kujdesit shëndetësor deri në orën 2, në vend që të ishte 24 orësh. Shërbimi për këtë zonë mbulohet nga qendra shëndetësore Dajç 16/24
			Gratë	Roli i grave konsiderohet të jetë i njëjtë me atë të burrave, madje edhe që gratë bëjnë më shumë aktivitete shtëpiake. Pozicioni shoqëror i grave është përmirësuar në vitet e fundit, ka më shumë të drejtë për të folur, arsim dhe më shumë liri. Zakonisht mundësitë e punës janë të drejta, pasi ato zakonisht merren me bujqësinë. Gratë dhe burrat përfundojnë shkollën e mesme. Gratë kanë njëfarë kontrolli në vendimin ekonomik të familjes, por kanë më pak rol në marrjen e vendimeve në familje dhe në komunitet.
			Fermerët	Fermerët po punojnë për më shumë se 15 vjet. Kanë probleme me ujin e ujitjes por ata e kanë zgjidhur atë me puse private. Kanalet ekzistuese të ujitjes janë prishur. Ata përdorin pesticide dhe këshillojnë specialistë për këtë
			Punonjësit e shëndetësisë	Çështjet shëndetësore që trajtohen në këtë qendër shëndetësore janë të llojeve të ndryshme. Ato ndryshojnë për shkak të moshës, zonave gjeografike, etj., por jo komuniteteve të ndryshme. Qendra shëndetësore ka disa probleme higjienike dhe vuan mungesën e ujit. Vdekshmëria foshnjore dhe amtare rezulton të jetë zero. Disa njerëz ende përdorin ilaçe popullore si çaji etj.
		Dajç	Të moshuarit	Numri i të moshuarve në këtë qytet është rritur kohët e fundit për shkak të imigrimit të disa familjeve që vijnë nga zonat malore. Njerëzit e moshuar që kanë punuar kur kanë qenë të rinj marrin pension pleqërie. Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria janë papunësia dhe problemet ekonomike.
			Gratë	Gratë në zonë janë kryesisht amvise nëse nuk punojnë në njësinë e administratës, arsim ose qendrat shëndetësore. Ato do të punonin sezonalisht në industrinë e hoteleve duke lënë shtëpitë e tyre me qira për turistët e pushimeve verore. Në varësi të familjes gratë mund të sjellin shumicën e të ardhurave të familjes ose më pak se 20% nëse nuk punojnë. Ata zakonisht ndjehen pothuajse të barabarta me burrat e tyre dhe bashkëpunojnë në vendimmarrje, por të tjerë mendojnë se janë më pak të fuqishme se burrat dhe kanë një zë më të vogël në vendimmarrjen e familjes ose të komunitetit. Megjithatë, gratë kalojnë nëpër

Baseni	Qyteti	Njësia Administrative	Grupi i fokusit ose informatorët kryesorë	Çështjet kryesore
				nivele më të larta të arsimit. Problemet kryesore me të cilat përballen gratë janë problemet ekonomike, papunësia, dhuna në familje në disa raste dhe divorci, si dhe mentaliteti i ngurtë.
	Lezhë		Fermerët	Fermerët në zonë po punojnë për një kohë të gjatë. Kanë një problem të madh me ujitje për shkak të mungesës së kanaleve. Probleme të tjera që lidhen me ujin janë cilësia e ujit, e cila nuk është filtruar, por vjen direkt nga pompat dhe nganjëherë nuk ka furnizim me ujë në varësi të zonës gjeografike. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në zonë për shumicën e familjeve. Gratë ndihmojnë gjithashtu në punët bujqësore në pjesën më të madhe të detyrave. Pesticidet janë duke u përdorur dhe konsultuar me një specialist.
			Punonjësit e shëndetësisë	Çështjet shëndetësore që trajtohen në këtë qendër shëndetësore janë të llojeve të ndryshme. Ato ndryshojnë për shkak të moshës, zonave gjeografike, etj., por jo komuniteteve të ndryshme. Qendra shëndetësore ka disa probleme higjienike dhe vuan mungesën e ujit. Vdekshmëria foshnjore dhe amtare rezulton të jetë zero. Disa njerëz ende përdorin disa ilaçe popullore si çaji etj.
		Gjadër	Të moshuarit	Ka një problem të madh me ujitjen për shkak të mungesës së kanaleve. Probleme të tjera që lidhen me ujin janë cilësia e ujit, e cila nuk është filtruar, por vjen direkt nga pompat dhe nganjëherë nuk ka furnizim me ujë në varësi të zonës gjeografike.
			Gratë	Gratë në zonë janë kryesisht amvise. Jo shumë ka ndryshuar në vitet e fundit. Disa gra mendojnë se kanë rol të njëjtë në familje ndërsa të tjerët mendojnë se burrat janë më të favorshëm. Vetëm disa nga të ardhurat e familjeve gjenerohen nga gratë. Ato nuk kanë një llogari bankare dhe kanë qasje në vendimet financiare të familjes vetëm nëse janë në punë. Gratë kalojnë nëpër një nivel arsimi më të lartë sesa burrat. Shumica e problemeve me të cilat përballen gratë në ditët e sotme janë papunësia dhe ekonomia e dobët.
			Fermerët	Për një numër familjesh bujqësia është aktiviteti kryesor i të ardhurave. Gratë janë të përfshira pothuajse në çdo aktivitet bujqësor njësoj me burrat.

13.4 Specifikat e Vendit mbi Aspektet Gjinore

Përcaktuar si barazia midis burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës, si në sferën publike ashtu edhe në atë private, barazia gjinore nënkupton qasje dhe kontroll të barabartë në burimet dhe përfitimet, pjesëmarrjen e barabartë në vendimmarrjen politike dhe barazinë sipas ligjit për gratë dhe burrat.

Qeveria e Shqipërisë e ka vendosur çështjen e barazisë gjinore në qendër të agjendës së saj prioritare, duke marrë parasysh të drejtat e grave si pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër miratohen ligje dhe politika të rëndësishme që synojnë eliminimin e diskriminimit gjinor.

13.4.1 Kuadri ligjor i aspektit gjinor

Parimi i barazisë së grave dhe burrave zë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin kombëtar. Kushtetuta [në nenin 18, pika 2] formulon parimin e mosdiskriminimit në këtë mënyrë "Askush nuk mund të diskriminohet për arsye të tilla si gjinia, raca dhe feja...".

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në Shqipëri janë ndër çështjet kryesore kombëtare. Ratifikimi i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), si dhe miratimi i ligjeve për barazinë gjinore, antidiskriminimi dhe antidhuna janë dëshmi për këtë vullnet, së bashku me miratimin e strategjisë kombëtare mbi barazinë gjinore. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit gjenden edhe në Kodin e Punës, Kodin Civil, Kodin Penal, Kodin e Familjes dhe pjesë të tjera të legjislacionit shqiptar.

Gjatë dy dekadave të fundit janë miratuar shumë ligje, të cilët janë gjithashtu mjete të rëndësishëm në ndryshimin e balancës së barazisë gjinore në Shqipëri.

- Ligji nr. 7961/12.7.1995, amendament specifik i "Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë"
- Ligji nr. 7995/20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji nr. 8876/4.4.2002, "Për të drejtat riprodhuese".
- Ligji nr. 9398/12.5.2005, "Për disa ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Avokatin e Popullit".
- Ligji Nr. 9669/18.12.2006, "Për disa masa për dhunën në familje" - Strategjia e Parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje.
- Ligji nr. 9914/12.5.2008, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 19.2.2006, "Për disa masa për dhunën në familje".
- Ligji nr. 9970/24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" (GEL)
- Ligji nr. 10039/22.12.2008, "Për vlerësimin ligjor".
- Ligji Nr. 10221/04.2.2010, "Për mbrojtjen kundër diskriminimit",

Qeveria Shqiptare ka krijuar një Strategji Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 733, më 20.10.2016, një dokument i rëndësishëm që bashkon shumë sektorë dhe partnerë që do të kontribuojnë për më tej në zhvillimin e këtyre çështjeve. Qeveria e Shqipërisë ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm e të ngushtë me të gjithë aktorët që besojnë se promovimi i barazisë gjinore dhe misioni i saj për tolerancë zero ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është një kontribut kyç për një shoqëri demokratike dhe të emancipuar.

Parimet kryesore që udhëheqin strategjinë e cila duhet të njihet nga donatorët me qëllim që të gjitha projektet të çojnë në një ndikim maksimal në barazinë gjinore janë:

- Barazia gjinore, një parakusht për një shoqëri të drejtë dhe socio-ekonomike
- Ndjeshmëria dhe trajtimi i barabartë ndaj: grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, romëve, egjiptianëve, të moshuarve, grave emigrante, nënave të fëmijëve, personave me nevoja të veçanta të të dyja gjinive.
- Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit - midis vajzave dhe grave, djemve dhe burrave, në lidhje me moshën, aftësitë, orientimin seksual, identitetin gjinor, prejardhjen etnike dhe sociale, praktikat fetare dhe zgjedhjet e jetës.
- Toleranca zero ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - mbrojtja e jetës, dinjitetit njerëzor dhe integritetit është parakusht për zhvillimin e një vendi.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërkulturor - derivues nga karakteristikat dhe natyra e çështjeve që përbëjnë shtyllat e kësaj strategjie, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, si dhe të gjithë aktorët e interesuar dhe partnerët, të cilët duhet të punojnë së bashku duke koordinuar veprimet e tyre me qëllim trajtimin më efektivisht

të pabarazive dhe padrejtësive në bazë gjinore për vajzat/gratë dhe djemtë/burrat.

Një ndër parimet që synon integrimin gjinor është rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje nëpërmjet:

- Marrjes së masave të cilat sigurojnë qasje të plotë të grave në politikë;
- Rritjes së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në 30% në të gjitha nivelet përmes masave të përkohshme të posaçme;
- Rritjes së pjesëmarrjes së grave në strukturat paqeruajtëse dhe policore; dhe
- Rritjes së aftësive të grave si qytetare për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe udhëheqje.

13.4.2 Të dhënat statistikore gjinore në përputhje me masat legjislative[214]

Pas zbatimit të kuotave gjinore dhe masave të ndërgjegjësimit, zhvillimi i situatës në zgjedhjet e përgjithshme është sipas statistikave në vijim:

- Zgjedhjet Parlamentare 2005: përfaqësimi i grave ishte vetëm 10 nga 140. Në kabinetin qeveritar, nga zgjedhjet e vitit 2005 përfaqësimi i grave ishte 2 ministra nga 14 në total ose 14% dhe 7 gra zëvendësministre nga 21 në total. Në nivel prefekture, kishte një grua në 12 rrethe të emëruar si perfekte.

- Zgjedhjet Parlamentare 2009: si rezultat i zbatimit të kuotës së parashikuar në Kodin Zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, listat e kandidatëve përfshinin 30% të grave deputete. Vlerat e kandidateve gra dhe vajza u promovuan përmes takimeve, shfaqjeve televizive etj. Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë, gratë mbajnë 23 vende nga gjithsej 140, ose 16.4% të vendeve ose dyfishin e grave krahasuar me numrin e mëparshëm të tyre në zgjedhjet parlamentare. Në kabinetin qeveritar, kishte një post të një ministreje grua ose 7.1% e kabinetit qeveritar. Zëvendësministrat janë gjithsej 35, nga të cilët 8 gra ose 23%. Një grua në 12 rrethe ishte perfekte.

- Zgjedhjet Parlamentare 2013: në të vërtetë, janë 33 gra nga gjithsej 140 anëtarë të parlamentit. Kjo paraqet një normë prej 24% të përfshirjes së grave. Ligji, "Për barazinë gjinore në shoqëri" (miratuar në vitin 2008) paraqiti një pritje prej 30% të kuotës së përfaqësimit të grave në listat e kandidatëve për zgjedhje, e cila akoma nuk është plotësuar[215]216. Qeveria e krijuar pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 kishte një rritje të konsiderueshme në përfaqësimin e grave, me 8 (tetë) ministra femra (ose 42%) dhe 10 (dhjetë) zëvendësministra (ose 34.4%). Roli i grave u forcua me krijimin e Aleancës së Grave Deputete (AWMP) në vitin 2013, një grup që inkurajon integrimin gjinor të ligjeve dhe promovimin e barazisë gjinore. Në vitin 2011, gratë dhe vajzat zinin 64.9% të pozicioneve në nivel specialistësh dhe 39.2% të pozicioneve të menaxhimit të mesëm. Gjatë viteve 2007-2012 u organizuan një sërë fushatash ndërgjegjësimi për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje. Ekziston një strehimore kombëtare për viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, është plotësisht funksional një mekanizëm koordinimi për referimin e rasteve të dhunës në familje.

Sa i përket zgjedhjeve lokale, evoluimi i situatës është si më poshtë:

- Zgjedhjet Lokale 2007: Në qeverinë lokale duke iu referuar zgjedhjeve të fundit të vitit 2007, rezultatet ishin: Një grua, kryebashkiake e komunës nga 65 komuna ose 1.5%, 9 gra janë kryetarë të këshillave bashkiake ose 16%, anëtare gra të këshillave bashkiake janë 157 nga gjithsej 1178 ose 13.3%, Nga 11 minibashkitë e Tiranës 3 kryetare bashkie janë gra, ose 27.3%, janë 6 kryetare të komunave nga 309 në total, ose 1.9%.

- Zgjedhjet Lokale 2011: Nga 65 komuna - 3 gra ishin kryetare Bashkie ose 7.7% (Burrel, Konispol, Patos) nga 11 minibashkitë e Tiranës - 2 janë kryetare minibashkie ose 18% (Njësia bashkiake 1 dhe 5), Anëtare të Këshillit Bashkiak janë 760 nga një total prej 6152 ose 12%.

Për më tepër, gratë mbajnë pozitat e Kryetarit të Parlamentit, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm Gjithashtu, gratë mbajnë disa pozita udhëheqëse të institucioneve të tjera qendrore të rëndësishme. Bazuar në statistikat e DAP, në administratat publike ka një pjesëmarrje të lartë të grave dhe vajzave në nivel ekspertësh, ky raport ishte 2008 ose 58.8% dhe është rritur në 64% në vitin 2010.

Në nivelin e menaxhimit të mesëm, pjesëmarrja ishte 42% gra për vitin 2010. Në nivelin e menaxhimit të lartë përfaqësimi i grave dhe vajzave është 25%. Në Universitete, 43.6% gra krahasuar

[214] INSTAT.

[215] INSTAT të dhëna draft.

me 56.4% meshkuj përbëjnë fakultetin akademik. Ndërkohë gratë me gradë shkencore janë 38% (viti 2008). Nga 10 rektorë asnjë nuk është një grua, nga 10 zëvendësrektorë, 3 janë femra ose 23%. Në gradën e dekanëve, gratë janë 11 ose 27% krahasuar me 29 burra që përbëjnë 72%.

Megjithëse prania e grave në administratën publike është inkurajuese, burrat mbizotërojnë në pozita udhëheqëse Analiza e punësimit sipas grupeve të profesioneve (bazuar në klasifikimin ndërkombëtar të profesioneve, ISCO 88) dhe e gjinisë tregon se për disa grupe të profesioneve ka dallime të dukshme në shkallën e punësimit të meshkujve dhe femrave Në grupin e ligjvënësve, zyrtarëve të lartë dhe udhëheqësve, 23.7 për qind e të punësuarve janë femra dhe 76.3 për qind meshkuj

Niveli i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për popullsinë meshkuj dhe femra të moshës 15-64 vjeç është përkatësisht 72.2% dhe 51.3% [217]. Ekziston një hendek prej 20.9% ndërmjet meshkujve dhe femrave në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore. Sipas INSTAT-it kjo do të thotë se meshkujt janë më aktivë në tregun e punës sesa femrat. Objektiva e rritjes së pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore në 65% nuk është arritur siç pritej. Struktura e punësimit në përputhje me statusin e punësimit tregon se 42.6% e të punësuarve janë punëmarrës, 31.8% janë punonjës që kontribuojnë në familjet e tyre dhe 25.6% janë të vetëpunësuar. Meshkujt dominojnë ndërmjet të vetëpunësuarve dhe femrat janë 1.3 herë më shumë se meshkujt punonjëse që kontribuojnë në familjet e tyre, një situatë që i vë ato në varësi ekonomike dhe pengon fuqizimin e tyre ekonomik.

13.4.3 Barazia gjinore në institucionet në nivel qendror

Struktura institucionale për Barazinë Gjinore përbëhet nga një numër i strukturave shtetërore të projektuara për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe për të siguruar gëzimin e të drejtave të njeriut të grave. Ky mekanizëm u krijua në zbatimin e rekomandimit të CEDAW, Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) dhe GEL. Funksioni i tij kryesor është të monitorojë dhe të sigurojë zbatimin e ligjeve, zbatimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë midis burrave dhe grave.

Strukturat dhe përgjegjësitë që zbatohen janë:

- Në nivel parlamentar, Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale ndjek dhe trajton çështjet e barazisë gjinore. Ky Komision shqyrton projektligjet, ndërmerr iniciativa ligjore në fushat e ekspertizës së tij dhe krijon bashkëpunim me autoritetin përkatës për çështjet e barazisë gjinore.

- GEL specifikon që Ministria e mëparshme e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si autoriteti përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, pas zhvillimit të konsultimeve me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që po punojnë për të arritur barazinë gjinore dhe për të reduktuar çështjet më bazë gjinore në Shqipëri, SKBGJ (aktualisht çështjet sociale janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale)

- Ministritë e linjës dhe Institucionet Filiale - Ministritë (dhe institucionet e tyre përkatëse) monitorojnë dhe implementojnë angazhimin e Qeverisë ndaj çështjes së barazisë gjinore.

- Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ) është themeluar me urdhër të Kryeministrit nr. 3, datë 8.1.2009 mbikëqyr reformat lidhur me fuqizimin e grave.

13.4.4 Barazia gjinore në institucionet në nivel lokal

Njësitë e qeverisjes vendore në prefektura, bashki dhe komuna zbatojnë Strategjinë (SKBGJ) në nivel lokal. Koordinimi ndodh përmes GEE në nivelin e Qeverisjes Vendore.

Qeverisja lokale përgjegjëse për çështjet gjinore gjithashtu siguron që të gjitha proceset, procedurat dhe sistemet e qeverisjes lokale të zhvillohen dhe zbatohen në mënyra që marrin parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave. Pra, nuk ka të bëjë vetëm me përfshirjen e më shumë grave në proceset e qeverisjes lokale - edhe pse arritja e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes lokale është një hap i rëndësishëm. Kjo ka të bëjë me sigurimin që në të gjitha aktivitetet e tyre, qeveritë lokale të marrin në konsideratë pabarazitë gjinore dhe të adresojnë, si dhe t'i reduktojnë këto përmes politikave, programeve dhe aktiviteteve të tyre.

Në Shqipëri, procesi i decentralizimit i ka vendosur Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) në një pozicion të fuqishëm për të ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e grave dhe burrave,

[217] Meshkuj dhe femra në vitin 2015, INSTAT.

vajzave dhe djemve. NJQV-të luajnë një rol kyç në hartimin e politikave lokale, ngritjen dhe alokimin e burimeve buxhetore dhe ofrimin e shërbimeve publike për komunitetet. Kur NJQV-të i japin përparësi barazisë gjinore si një objektiv politike dhe kur NJQV-të përfshijnë drejtpërsëdrejti gratë dhe burrat në proceset e qeverisjes lokale, komunitetet dhe qytetarët - si gratë dhe burrat - përfitojnë në mënyrë të qartë.

Mekanizmi i Barazisë Gjinore është krijuar përmes Punonjësve të Barazisë Gjinore (PBGJ) në nivel të njësive të qeverisjes vendore, të cilët janë të mandatuar nga Këshilli Bashkiak për të udhëhequr përpjekjet e integrimit gjinor dhe janë paraparë të marrin rolin e promotorëve dhe monitoruesve të zbatimit të politikës kombëtare gjinore.

Neni 13/3 i Ligjit për Barazinë Gjinore përcakton caktimin e Punonjësve të Barazisë Gjinore (PBGJ) në çdo ministri të linjës dhe Neni 14 detyron emërimin e PBGJ-ve në të gjitha organet drejtuese vendore. Në parim, kjo përfshin bashkitë, komunat, prefekturat dhe rrethet.

Pikat fokale të Gjinisë nuk janë përcaktuar, por roli i tyre është përcaktuar mirë përmes PBGJ të cilët janë parashikuar për të mbështetur përfshirjen e çështjeve të barazisë gjinore në politikat, programet dhe planet dhe për të monitoruar zbatimin e angazhimeve të barazisë gjinore të qeverisë qendrore dhe vendore. PBGJ-të parashihen gjithashtu të luajnë një rol kyç në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, veçanërisht të dhënave të ndara sipas gjinisë, kryerjen e analizave gjinore për të informuar zhvillimin e politikave lokale dhe zhvillimin e partneriteteve me aktorët e tjerë gjinorë.

Para zgjedhjeve vendore të muajit maj 2011, vetëm 14 komuna kishin caktuar PBGJ (nga 65 komuna) Duke pasur parasysh përqindjen e ulët të PBGJ-ve, këto dy pozicione - PBGJ dhe eksperti i dhunës në familje - shpesh janë bashkuar dhe plotësuar nga i njëjti individ - për shembull, në komunat pilot të mbështetura përmes aktorëve të tillë si projekti "Ekuiteti në Qeverisje" dhe subjektet e OKB-së.

13.4.5 Niveli i organizimit të shoqërisë civile dhe i OJQ-ve

Organizatat e shoqërisë civile, sidomos OJQ-të e specializuara në ofrimin e shërbimeve kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve ata jo vetëm përmbushin detyrimet që i përkasin shtetit, por edhe parandalojnë disa prej tyre duke pilotuar shërbime të ndryshme ose duke organizuar aktivitete informuese, ndërgjegjësuese dhe trajnimi. Sa i përket arritjes së barazisë gjinore, përvoja e bashkëpunimit me OJQ-të dhe modelet zbatuese të propozuara prej tyre ka lehtësuar vazhdimisht ndërhyrjen e shtetit, veçanërisht në rastin e njësive të qeverisjes vendore.

Shërbimet e ofruara nga OJQ-të e specializuara në menaxhimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe rastet e dhunës në familje janë shpesh alternativa e vetme për viktimat. Shërbimet e strehimit, këshillimit, ndihmës juridike falas etj., vazhdojnë të ofrohen kryesisht nga këto organizata. Ekziston një bashkëpunim shumë i mirë me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat janë gjithashtu burimi kryesor i financimit të shumë aktiviteteve të ndërgjegjësimit të organizuara jo vetëm nga OJQ-të por edhe nga institucionet publike.

Ka OJQ, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e SKBGJ-së. OJQ-të, veçanërisht organizata e grave, kanë qenë në ballë të përpjekjeve dhe mobilizimit për të realizuar të drejtat e grave dhe vendosjen e rendit të ditës për barazinë gjinore. Disa nga më të rëndësishmet, janë:

- "Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale", Tiranë
- Shoqata "Zëri i fëmijës që na thërret",
- Shoqata, "Për gratë dhe fëmijët", Tiranë
- Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat në Tiranë
- Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)
- Qendra kulturore "Horizonti i ri", Tiranë
- ARSIS, Tiranë
- Shoqata "Të dobishme për gratë shqiptare", Tiranë 49
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
- Qendra "Të ndryshëm dhe të barabartë", Tiranë
- Qendra "Të drejtat e njeriut në demokraci", Tiranë
- "Forumi i gruas Elbasan", Elbasan
- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të Shqipërisë (CRCA)

Disa nga këto OJQ ishin pjesë e angazhimit të palëve dhe konsultimeve në projektin e PMBU.

13.4.6 Aplikimi i gjinisë në menaxhimin e burimeve ujore dhe zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Procesi i hartimit të Planit të Integruar të Menaxhimit të Burimeve Ujore për Shqipërinë është hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojë një kornizë për menaxhimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, ku të gjitha palët e përfshira, përfshirë sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdorues të luajnë një rol aktiv pavarësisht nga gjinia e tyre. Konventat e OKB-së dhe dokumentet e tjera lidhur me barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës, gjithashtu i japin rëndësi të madhe çështjes së menaxhimit të ujërave. Në të gjitha situatat e jetës përmendet rëndësia e perspektivës së integruar gjinore në menaxhimin e burimeve ujore. Gjatë dekadave të fundit, është konstatuar se vetëm zgjidhjet teknike nuk janë të mjaftueshme që popullsia e botës të ketë një përdorim të barabartë dhe të sigurt të burimeve ujore.

Politikat qeverisëse dhe kombëtare mbi barazinë gjinore synojnë të aktivizojnë gratë në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe ekonomike. Planit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore i kushtohet shumë vëmendje për faktin se gratë janë një grup i madh i konsumatorëve të ujit dhe për këtë arsye kërkon zgjidhje afatgjata.

Janë bërë përpjekje për përfshirjen e grave në vendimmarrje dhe pjesëmarrje të zgjeruar në të gjithë sektorët, për t'iu përgjigjur kërkesës në rritje për ujë dhe menaxhimit të burimeve. Angazhimi dhe konsultimi i palëve të interesit i jep rëndësi perspektivës gjinore dhe synon të zbatojë barazinë gjinore në çështjet e menaxhimit të burimeve ujore, projekteve, analizave dhe statistikave të ujit. Megjithatë, në Shqipëri ende mbetet real plani për përfshirjen e grave si burrat në të gjitha çështjet dhe përvojat në përpunimin, zbatimin e monitorimit dhe vlerësimit të të gjitha sferave politike, ekonomike dhe sociale, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe jo në mënyrë të pabarabartë.

Sidoqoftë, duhet të theksohet se tradicionalisht gratë në Shqipëri kanë rol vendimtar dhe të rëndësishëm në familje (që nga pikëpamja e PMBU-ve është veçanërisht e lidhur me përdorimin e ujit), por burrat janë ata që përgjithësisht marrin vendimet jashtë familjes tradicionale, duke vepruar si zëdhënës. Kjo është më shumë një ndarje e roleve ndërmjet burrave dhe grave sesa diskriminimit të qartë dhe/ose përjashtimit të grave nga vendimmarrja, që do të thotë se gratë nuk kanë nevojë vetëm për mbështetje ligjore për të marrë një rol më aktiv në shoqërinë shqiptare.

13.5 Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzionet kryesore të mëposhtme mund të nxirren nga procesi i konsultimit të palëve të interesuara:

- Të informuar mbi projektin, të gjitha grupet e synuara u ndjenë pozitivë se shumica e problemeve të ujit me të cilat përballen sot mund të adresohen. Sugjerimi kryesor në studimin e projektit, kryesisht në çdo rreth me rrezik të lartë nga përmbytjet, është që të ketë specialistë dhe inxhinierë për shpërndarjen e ujit dhe kanalet e ujitjes dhe kullimit.

- Fermerët shpresojnë për përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe të kullimit. Ata besojnë se projekti mund të sjellë shumë fitim për bujqësinë.

- Familjet, gratë dhe të moshuarit shpresojnë se do të sigurojnë furnizim me ujë të vazhdueshëm gjatë gjithë ditës.

- Edhe pse baza themelore ligjore dhe institucionale për barazinë gjinore është ngritur në Shqipëri, gratë pretendojnë se nuk kanë barazi me burrat në përgjithësi në shoqëri, por kanë qasje të barabartë ndaj ujit.

- Procesi i angazhimit të aktorëve ishte përshtatur për të dhënë një pamje të përgjithshme mbi aspektet lokale pavarësisht nga përfshirja e gjinive të ndryshme ose grupeve sociale, por një konsideratë e veçantë i është kushtuar faktit se gratë janë një grup i madh konsumatorësh

- Përfshirja gjinore dhe barazia gjinore janë gjithashtu pjesë e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Ndërthurur të Ujërave dhe është përshtatur me specifikat e kontekstit për të gjithë çështjen e menaxhimit të ujit. Kjo është marrë në konsideratë edhe në hartimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Sipas të gjitha pyetësorëve dhe takimeve ballë për ballë, pyetjet kryesore që u ngritën ishin si më poshtë:

- A e përfshin plani menaxhimin të ujërave përmbytjen?

- A e minimizon plani mungesën e furnizimit me ujë?

- A pritet që plani të ndikojë në rritjen ekonomike dhe punësimin?

- A do të përmirësojë plani keqpërdorimin e burimeve ujore?

- A do të zgjerojë plani infrastrukturën e ujit dhe përmirësimin e cilësisë së tij?

- A përfshin plani i menaxhimit të ujit edhe sistemet e ujitjes?

Siç mund të shihet nga kapitulli 12, masat e propozuara, megjithëse janë fokusuar si prioritet i vendit në përmbushjen e objektivave mjedisore të lidhura me pranimin e Shqipërisë në BE, japin një përgjigje "po" për të gjitha pyetjet e ngritura.

Lidhur me procesin e PMBU-ve, mund të formulohen rekomandimet e mëposhtme, për ciklet e programit në vijim:

Një kornizë për menaxhimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilat duhet të sigurohen të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdorues, pavarësisht nga gjinia;

Fuqizimi i rëndësisë së perspektivës së integruar gjinore në menaxhimin e burimeve ujore në të gjitha situatat e jetës dhe përfshirja aktive e grave në procesin e vendimmarrjes përtej ndarjes tradicionale të rolit gjinor;

Të bëhet e qartë (në mbarë vendin) se barazia gjinore në institucionet në të gjitha nivelet e shoqërisë (në familje, organizatat e komunitetit, shoqatat e përdorimit të ujit, qeverisja vendore, shërbimet kombëtare nacionale etj.), Për aspektet e përmirësimit social në përgjithësi dhe për menaxhimin e pasurive ujore në veçanti.

14. Objektiva dhe rekomandime

Ky dokument përfaqëson Planin e parë të Menaxhimit të Baseneve Ujore (PMBU) për basenin ujor Drin–Bunë. Me qëllim vazhdimin me zhvillimin e një PMBU-je më të plotë, raporti identifikon fusha të veçanta dhe ofron rekomandime ku përmirësime janë jo vetëm të domosdoshme, por konsiderohen thelbësore për planifikimin efektiv të basenit ujor në të ardhmen në basenin ujor Drin–Bunë, në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së (2000/60/EC).

Ky seksion ka të bëjë me objektivat strategjikë të paraqitur në strategjinë e fundit të ujit (Tabela 14.1), e cila përmban objektiva specifike ekonomike, mjedisore, institucionale dhe sociale, për çështjet me rëndësi për sasinë e ujit, cilësinë e ujit, rreziqet e ujit, dhe menaxhimit të ujit në basenin ujor Drin–Bunë (Tabelat 14.2 - 14.6).

- Sasia e ujit: Sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, duke i shërbyer të gjitha interesave;

- Cilësia e ujit: Sigurimi i cilësisë së të gjitha burimeve ujore, duke arritur status të mirë deri në vitin 2030;

- Rreziqet e ujit: Përmbytjet dhe thatësirat janë të përfshira përmes menaxhimit dhe investimeve;

- Informacioni i ujit: Të dhënat dhe modelet e besueshme të ujit dhe klimës në përgjithësi janë të siguruara për të gjithë palët e interesuara dhe këshilla të përshtatshme e politika të bazuara në këto të dhëna dhe modele sigurohen nga qeveria nga zotëruesit përkatës të të dhënave institucionale;

- Menaxhimi i ujit: Uji menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i shërbyer të gjitha interesave.

- Rekomandimet për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit të baseneve ujore do të ndërmerren nga Autoritetet Kompetente gjatë gjashtë viteve të ardhshme, të cilat janë në përputhje me PMBU-të dhe objektivat strategjikë për ujin në basenin ujor Drin–Bunë, dhe paraqiten në tabelën 14.7.

Tabela 14.1: Objektivat strategjikë për basenin ujor Drin–Bunë[218]

		Rezultatet kryesore	Mënyrat e verifikimit	Supozimet	Treguesit OZHQ[219]
Vizioni	**Deri në vitin 2030 Shqipëria do të bëhet një vend me efikasitet ujor, me një menaxhim të integruar funksional të burimeve ujore, përfshirë edhe një sistem të konsoliduar monitorimi përfshirë rrezikun nga përmbytjet dhe mungesa e ujit. Përdorimi i ujit bazohet në parimet e barazisë dhe qëndrueshmërisë për përfitime të barabarta ekonomike, shoqërore dhe gjinore dhe drejtësi mjedisore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.**				
Misioni	**Krijimi i të gjitha kuadrove të nevojshme ligjore, ekonomike, institucionale, teknike dhe shoqërore, bazuar në legjislacionin mjedisor të BE-së dhe parimet e MIBU-së për menaxhim të integruar e të drejtë, me përfshirje gjinore të arsyeshme në të gjitha burimet ujore në vend.**				
Objektivat strategjikë (1-5)	**Sasia e ujit**: Sigurohet përdorimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, duke i shërbyer të gjitha interesave	Shpërndarje efikase dhe e njëjtë e ujit dhe rritje domethënëse e efikasitetit në përdorimin e ujit në të gjithë sektorët dhe sigurimi i thithjes, riciklimit dhe ripërdorimit të qëndrueshëm	Baza e të dhënave e kadastrës së ujit Raporte në lidhje me sektorin e ujit Regjistra zyrtarë qeveritarë	Zbatimi i direktivave të BE-së funksionimi i kadastrës së ujit	6.1, 15.6,
	Cilësia e ujit: është siguruar cilësia e të gjitha burimeve të ujit, duke arritur një gjendje të mirë deri në vitin 2027	Ulja e ndotjes, eliminimi i derdhjeve dhe zvogëlimi i hedhjes së materialeve dhe kimikateve të rrezikshme	Raportim AKM Kadastra e Ujit Raportet e Institutit të Shëndetit Publik Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore (DKU)	Zbatimi i direktivave të BE-së monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ujit sipas standardit	6.3, 6.6, 14.1, 14.2, 14.5, 15.1
	Rreziqet e ujit: Rreziqet që vijnë nga uji (përmbytje dhe thatësira) përballohen përmes menaxhimit dhe investimeve	Përforcohet mbrojtja dhe kapaciteti për përshtatjen me zhvillimet klimatike, rreziqet dhe katastrofat natyrore	Plane të Menaxhimit të Katastrofave Plane të Menaxhimit të Përmbytjeve Plane të Menaxhimit të Thatësirave Komunikimi shqiptar PNNK	Zbatimi i direktivave të BE-së Zhvillimi i kapaciteteve dhe sigurimi i financimeve për të pasur aftësinë të hartohen dhe zbatohen planet	3.9, 13.1, 13.2, 15.3
	Informacioni mbi ujin: Të dhëna dhe modele të besueshme për ujin dhe klimën, të siguruara për të gjitha palët e interesit dhe këshillat adekuate të politikave të bazuara në këto të dhëna dhe modele sigurohen nga qeveria nga institucionet përkatëse të të dhënave institucionale	Njohuri më të mira mbi të gjitha burimet ujore si një bazë e njohurive publike për menaxhimin e integruar të ujit për politikat vendimmarrëse	Kadastra e ujit Raportet e AKM-së Raportet e BE-së (AEM, DKU)	Zbatimi i direktivave të BE-së monitorim dhe vlerësim i cilësisë së ujit sipas standardeve	6.a, 12.8
	Menaxhimi i ujit: Uji menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i shërbyer të gjitha interesave, duke ofruar përfitime të barabarta socio-ekonomike dhe përfshirje në vendimmarrje për gjeneratat e ardhshme	Politika të qarta MIBU dhe zbatim i PMBU-ve të cilat synojnë qëllime të matshme në afatet kohore të para caktuara dhe shkallën e përshtatshme, përcaktim i qartë i detyrave për autoritetet përgjegjëse, bazuar në monitorim dhe vlerësim të drejtë	Legjislacioni, urdhra ministrorë, vendime të KKU-së dhe akte nënligjore Shkalla e harmonizimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore	Zbatim i parimeve të OECD-së dhe BE-së; parimet mjedisore të kujdesit, plotësueshmërisë, proporcionalitetit dhe solidaritetit dhe legjislacioni i harmonizuar	5.5, 5.a, 5.c, 6.4, 6.5, 16.7

[218] Objektivat strategjikë janë prezantuar në Strategjinë e Ujit, Shqipëri (2018).
[219] OZHQ: 17 Qëllime zhvillimore të qëndrueshme: siç përcaktohet nga UN: https://sustainabledevelopment.un.org/sdgs.

Tabela 14.2. Sasia e ujit

Objektivat e politikave[220]	Rezultatet kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rekomandimet për Planifikimin e Menaxhimit të Basenit Ujor
